



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 546 Akti

Nr. 659 Vendimi
Tiranë, më 12.5.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko	Kryesuese
Brunilda Bektoshi	Relatore
Roland Iia	Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Albana Plaka, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në datën 10.5.2023, ora 10:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Sokol Malaj**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, paragrafi 5, neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisioneren Brunilda Bektoshi, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Malaj, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, referuar pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).

2. Referuar neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK); dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të shkronjës “b” të pikës 7 të nenit 3 dhe pikës 9 të nenit 3 të rregullores “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni ka zhvilluar shortin në datën 15.6.2020, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Malaj, do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Brunilda Bekteshi dhe Roland Ilia. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionerja Brunilda Bekteshi.

4. Trupi gjykues, pasi kishte administruar të tria raportet e përcjella nga organet ndihmëse, sipas parashikimeve të neneve 31 - 44 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 1, në datën 19.6.2020, kishte vendosur: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të po këtij ligji; (ii) me mirëkuptim të caktojë kryesuese të trupit gjykues komisioneren Pamela Qirko. Gjithashtu, në këtë mbledhje, anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesave me subjektin e rivlerësimit, z. Sokol Malaj, i cili deklaroi¹ gjithashtu se nuk është në kushtet e konfliktit të interesave me asnjë prej anëtarëve të trupit gjykues.

5. Në datën 11.4.2023, Komisioni, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Sokol Malaj, për të tria kriteret e rivlerësimit: kriterin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht të paraqesë pretendimet e saj brenda 14 ditëve nga marrja e njoftimit me postë elektronike, si dhe për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

6. Në datën 11.4.2023, subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën. Brenda afatit të caktuar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit, në datën 18.4.2023, u njoh e disponoi kopje të materialeve të dosjes së tij dhe në datën 25.4.2023, dërgoi shpjegimet dhe provat mbi rezultatet e hetimit administrativ në rrugë elektronike dhe zyrtare.

7. Trupi gjykues, pas administrimit të dokumentacionit të depozituar nga subjekti në qëndrimin e tij, në datën 26.4.2023, me vendimin nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Sokol Malaj, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, duke e njoftuar me anë të postës elektronike se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 28.4.2023, në orën 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë. Në datën 27.4.2023, subjekti kërkoi shtyrjen e seancës për arsye objektive, kërkesë që u pranua nga

¹ Referojuni *email*-it datë 24.7.2020.

Komisioni. Subjekti, në datën 5.5.2023, u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 10.5.2023, në orën 10:30.

II. SEANCA DËGJIMORE

8. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Sokol Malaj, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

9. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Sokol Malaj. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 10.5.2023 për të rifilluar në datën 12.5.2023 për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

10. Subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Malaj, ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas afatit të përcaktuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj tij.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

11. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” sipas krerëve IV, V dhe VI të këtij ligji. ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror. DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit. KLP-ja është organi ndihmës i ngarkuar me ligj për të paraqitur një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar në lidhje me vlerësimin profesional. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese² dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

² Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5 të nenit 179/b të Kushtetutës “Rivlerësimi kryhet nga Komisioni”, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016, “Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore, që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016 parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë.” Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

12. ILDKPKI-ja, me raportin nr. *** prot., datë 7.12.2018, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Sokol Malaj, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, dhe në datën 24.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, si për subjektin e rivlerësimit, ashtu edhe për personat e lidhur me të, për vlerësimin e pasurisë ky institucion ka konstatuar se:

- deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin;
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

13. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të bëra me anë të komunikimit elektronik; (ç) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas mbylljes së hetimit administrativ; si dhe (d) shpjegimet e dhëna në seancë dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

14. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijuarit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; si dhe (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

15. Mbi pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting*, sipas formularit (shtojca nr. 2) dorëzuar në datën 24.1.2017 nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë deklaruar në deklaratën *Vetting* pasuritë si vijon:

16. Tokë bujqësore në bashkëpronësi, me sipërfaqe 15.000 m² dhe 600 rrënjë ullinj (fshati D, Bashkia Mallakastër), marrë sipas ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 (zonë e pamanaxhuar), pjesa takuese 1/3. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës vërtetimin datë 18.1.2017³, dhënë nga ZVRPP-ja Mallakastër, e cila konfirmon se *shtetasi J.M ka përfituar tokë bujqësore nga ligji nr. 7501, datë 19.7.1991, në fshatin D, si banor i këtij fshati. Në kushtet që fshati D, Bashkia Mallakastër, nuk ka kaluar në sistemin e*

³ Referojuni aneksit nr. 4/1 në dosjen e ILDKPKI-së.

regjistrimit fillestar të pasurive, ZVRPP-ja Mallakastër nuk disponon asnjë informacion teknik dhe ligjor.

Hetimi i Komisionit

16.1 Nga verifikimi i DPV-së së vitit 2003 rezultoi se subjekti e ka deklaruar këtë pasuri me të njëjtën sipërfaqe dhe pjesë takuese 1/6, në ndryshim nga deklarimi në deklaratën *Vetting*, ku ka deklaruar 1/3 pjesë.

16.2 Nga verifikimi i DPV-së së vitit 2005, rezultoi se subjekti ka deklaruar pjesën e tij takuese 5.000 m² nga kjo bashkëpronësi dhe 120 rrënjë ullinj nga ligji nr. 7501.

16.3 Komisioni mbi këto deklarime konstatoi se subjekti ka mospërputhje në deklarimin e pjesës takuese të pasurisë tokë bujqësore, si dhe nuk ka deklaruar kronologjikisht ullinjtë.

16.3.i Subjekti në lidhje me këtë konstatim ka sqaruar⁴ se: “Në deklaratën fillestare të vitit 2003, deklarimi është bërë për 1/6 pjesë të tokës bujqësore, në kushtet e përbërjes familjare prej 6 (gjashtë) personash.

Në deklaratën periodike të vitit 2005 është deklaruar pjesa takuese prej 1/3, sepse në atë kohë kjo pasuri është ndarë faktikisht nga im atë si kryefamiljar, midis 3 djemve të tij, duke marrë secili nga 1/3 pjesë të sipërfaqes totale prej 15.000 m², ku pjesa ime takuese ishte 5.000 m², ashtu siç dhe është deklaruar. Ndërsa ullinjtë në vitin 2005 kanë qenë mbjellë vetëm pjesërisht nga im atë, vëllezërit dhe unë, duke më takuar si pjesë sasia prej 120 rrënjësh (ullinj të mbjellë rishtazi “ullinj të rinj”), ashtu si edhe vëllezërit e mi. Ndërsa në deklaratën *Vetting*, e depozituar në vitin 2017, numri i ullinjve ishte shtuar në 600 rrënjë në total, aq sa janë edhe sot, për të gjithë bashkëpronarët. Rrjedhimisht, në deklaratën *Vetting*, kam deklaruar sërish si pjesë takuese 1/3 e 15.000 m² tokë dhe 1/3 e 600 rrënjëve ullinj.”

16.3.ii Subjekti ka depozituar aktin e marrjes së tokës në pronësi (AMTP-në nr. regjistrimi të aktit ***)⁵, nga ku rezultoi se në emër të shtetasit J.M.M nga fshati D figuron 13.900 m² sipërfaqe tokë arë dhe truall.

16.3.iii Gjithashtu, subjekti depozitoi certifikatën e përbërjes familjare të muajit gusht 1991⁶, nga ku vërehet se në përbërjen familjare të shtetasit J.M kanë qenë 8 anëtarë.

16.4 ZVRPP-ja Mallakastër, me *email*-in e datës 27.11.2018, ka bashkëlidhur shkresën nr. *** prot., datë 26.11.2018⁷, në të cilën konfirmon se nuk ka pasuri të paluajtshme të regjistruara në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të.

16.5 Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, rezultoi se Zyra Vendore e ASHK-së Mallakastër⁸ nuk konfirmon pasuri në emër të subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve të tij, duke sqaruar se kjo zonë është e pamenaxhuar dhe se kjo zyrë nuk disponon dokumentacion tekniko-ligjor.

16.6 Komisioni, për këtë pasuri, në rezultatet e hetimit, i kërkoi subjektit të jepte shpjegime bindëse, pasi nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar, në raport me shpjegimet e tij, gjatë hetimit konstatoi: (i) mospërputhje në deklarimin e subjektit se ai zotëron 1/3 pjesë takuese, ndërkohë që përbërja familjare ka qenë me 8 anëtarë, si dhe mungonte dokumentacion justifikues për të provuar këtë fakt; (ii)

⁴ Me pyetësin nr. 3, datë 20.2.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁵ Depozituar nga subjekti me pyetësin nr. 3, datë 20.2.2023.

⁶ Lëshuar nga Njësia Administrative K, datë 22.2.2023.

⁷ Referojuni aneksit nr. 31 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 7.6.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

mospërputhje në deklarimin e subjektit se sipërfaqja është 15.000 m², ndërkohë që sipas AMTP-së ajo rezulton të jetë 13.900 m² dhe, njëkohësisht, në akt nuk identifikohen rrënjë të ullinjve.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

16.7 Subjekti i rivlerësimit, në qëndrimin e tij, ka parashtuar se kjo tokë bujqësore nuk është një pasuri e menaxhuar dhe e regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme, siç është vërtetuar edhe nga Komisioni në komunikimin me ASHK-në Mallakastër. Pasuria është deklaruar për herë të parë, duke synuar gjithmonë deklarimin sa më korrekt dhe të plotë, në deklaratën fillestare pranë ILDKPKI-së të vitit 2003. Për shkak të përbërjes familjare prej 6 anëtarësh në atë moment, është deklaruar si pjesë takuese 1/6 tokës arë, e cila në dijeninë e tij dhe të familjes ishte 15.000 m². Në vitin 2005, babai i tij e ka ndarë në atë kohë këtë tokë bujqësore midis 3 djemve të tij dhe, rrjedhimisht, deklarimi është bërë për 1/3 pjesë, ku pjesa e tij takuese ishte 5.000 m². Mospërputhja midis deklaramit për posedimin e sipërfaqes prej 15.000 m² dhe AMTP-së së depozituar prej 13.900 m² vjen për shkak të mosposedimit ndonjëherë të kësaj AMTP-je dhe mosmenaxhimit në tërësi të kësaj zone nga ana e ZVRPP-së Mallakastër deri më sot. Në deklarimin e bërë për herë të parë për ullinjtë, sikurse ka deklaruar edhe gjatë hetimit, ata rezultonin të mbjellë në atë kohë vetëm pjesërisht nga babai, vëllezërit dhe subjekti, duke i takuar si pjesë sasia prej 120 rrënjësh (ullinj të mbjellë rishtazi “ullinj të rinj”), ashtu si edhe vëllezërit e tij. Në vitin 2017, numri i ullinjve ishte shtuar në 600 rrënjë në total, aq sa janë edhe sot, për të gjithë bashkëpronarët, rrjedhimisht në deklaratën *Vetting* ka deklaruar si pjesë takuese 1/3 e 15.000 m² tokë dhe 1/3 e 600 rrënjëve ullinj.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

16.8 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit, si dhe të dokumentacionit të depozituar, arsyeton se referuar ligjit nr. 7501/1991 “Për tokën”, subjekti në deklaram duhej t’i ishte referuar Aktit të Marrjes së Pronës në Pronësi (AMPT), si dokumenti ligjor i përfutur nga zbatimi i ligjit nr. 7501, bazuar në numrin e anëtarëve të familjes në vitin 1991, kohë kur ka hyrë në fuqi ky ligj. Në këtë drejtim, trupi gjykues ka konstatuar se certifikata familjare e depozituar nga vetë subjekti ka në përbërje 8 anëtarë në këtë vit, për rrjedhojë çmon se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, sa i takon pjesës takuese dhe sipërfaqes së kësaj pasurie. Ndërsa, lidhur me deklarimin e ullinjve, trupi gjykues, duke konstatuar se subjekti i ka deklaruar ato në deklaratën periodike dhe atë *Vetting*, në mungesë të ndonjë të dhëne tjetër të dalë përgjatë hetimit, i vlerëson bindëse shpjegimet e tij.

Në përfundim, trupi gjykues, nisur nga vlerësimi i fakteve dhe rrethanave se: (i) prej institucionit të ASHK-së Mallakastër konfirmohet fakti që kjo pasuri është në një zonë të pamenaxhuar; (ii) është pasuri e krijuar në kohën kur subjekti ka qenë 14 vjeç dhe jo në detyrë; (iii) ligjshmëria e saj nuk rezulton e cenuar, pasi përfitimi i saj rrjedh nga ligji “Për tokën” – konkludon se kjo pasaktësi nuk cenon procesin e rivlerësimit në përmbushje të qëllimit të ligjit nr. 84/2016.

17. Banesë private prindërore (fshati D, Bashkia Mallakastër) (zonë e pamenaxhuar). Pjesa takuese: 1/3.

Hetimi i Komisionit

17.1 Nga verifikimi i DPV-së së vitit 2005, konstatohet se subjekti ka deklaruar 1/3 e një shtëpie banimi private të trashëguar nga babai i tij, ndërtuar para vitit 1990.

17.2 Nga hetimi i kryer, rezultoi se ASHK, Zyra Vendore Mallakastër⁹, nuk konfirmon pasuri në emër të subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve të tij, duke sqaruar se kjo zonë është e pamenaxhuar dhe se kjo zyrë nuk disponon dokumentacion tekniko-ligjor.

17.3 Subjekti, pasi është pyetur¹⁰ nga Komisioni lidhur me ekzistencën e kësaj pasurie, origjinën e përfitimit të saj, si dhe burimin e krijimit, ka sqaruar: “Ajo është ndërtuar nga im atë shumë kohë më parë, në vitet 1970, dhe deri më sot ekziston si objekt i pamenaxhuar dhe i paregjistruar. Shtëpia është ndërtuar me kursimet dhe kontribut vullnetar të tim eti dhe vëllezërve të tij në ato vite. Për shkak të kohës së largët dhe faktit se unë që prej vitit 1994 nuk banoj më në atë banesë, e kam të pamundur të siguroj dokumentacion për burimin e krijimit të saj. Aq më tepër, në kushtet kur ai ishte dhe mbetet një objekt informal, i paregjistruar dhe i cili asnjëherë nuk është bërë pjesë e qarkullimit civil”.

17.4 Komisioni, për këtë pasuri, në gjendjen që ndodheshin aktet në rezultatet e hetimit, i kërkoi subjektit të provonte me dokumentacion justifikues: (a) ndërtimin e kësaj shtëpie përpara viteve 1990; (b) mënyrën e përfitimit të pjesës suaj takuese, deklaruar 1/3; si dhe (c) të provonte me dokumentacion të periudhës aktuale (foto etj.) ekzistencën dhe gjendjen në të cilën ndodhet kjo pasuri.

17.5 Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e tij, ka dhënë të njëjtat shpjegime sikurse gjatë hetimit, pasqyruar në pikën 17.3, si dhe ka depozituar fotografi aktuale të saj.

17.6 Trupi gjykues, lidhur me çështjen objekt vlerësimi, në konsideratë të deklarimeve konsistente të subjektit, fotove të depozituara, ku nuk konstatohen investime të kohës, krijon bindjen se pasuria është ndërtuar përpara viteve 1990 dhe, për pasojë, nuk identifikon ndonjë lidhje të mundshme investimi nga subjekti dhe as krijon dyshime lidhur me ekzistencën e saj.

18. Tokë (kullotë) me sipërfaqe 1.000 m² (zonë e pamenaxhuar), në DH., Vlorë, në bashkëpronësi me vëllain A.M, blerë me kontratën nr. 2499/1241, datë 20.6.2011, në vlerën 200.000 lekë. Burimi i krijimit: të ardhurat e realizuara nga aktiviteti “****”. Pjesa takuese: 1/2. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacionin mbështetës.

Hetimi i Komisionit

18.1 Nga verifikimi i DPV-së së vitit 2011, konstatohet se subjekti e ka deklaruar këtë pasuri me të njëjtin përshkrim, por nuk ka deklaruar burimin e krijimit të saj. Lidhur me këtë konstatim, subjekti ka deklaruar¹¹ se në DPV-në e vitit 2011 ky fakt përbën një harresë nga ana e tij, ndërsa ka sqaruar se deklarimi është i saktë, burimi i të ardhurave është i mjaftueshëm dhe se gjithashtu në deklaratën *Vetting* ka deklaruar sërish me saktësi detajet për këtë pasuri dhe njëkohësisht burimin e të ardhurave. Subjekti ka sqaruar se burimi i krijimit të kësaj pasurie janë kursimet familjare, të ardhurat nga aktiviteti tregtar i bashkëshortes, ***, për të cilën ka depozituar dokumentacionin përkatës.

18.2 Komisioni hetoi lidhur me origjinën e kësaj pasurie, si dhe lidhur me burimin e krijimit të saj.

18.3 Nga dokumentacioni i administruar¹², rezultoi se kjo pasuri është fituar nëpërmjet kontratës së shitjes nr. ***, datë 20.6.2011, nënshkruar ndërmjet palës shitëse L.V dhe palës blerëse A.M e Sokol Malaj, për tokë kullotë, me sip. 1.000 m², me vendndodhje në Dh, Palasë, kundrejt shumës totale 200.000 lekë.

18.4 Sipas kontratës, rezultoi se kjo shumë është likuiduar nga blerësit tërësisht, jashtë zyrës noteriale.

⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 7.6.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

¹⁰ Me pyetësin nr. 3, datë 20.2.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

¹¹ Me pyetësin nr. 3, datë 20.2.2023.

¹² Referojuni aneksit nr. 28 në dosjen e ILDKPKI-së.

18.5 Sipas vërtetimit nga dokumentet hipotekore të ZVRPP-së Vlorë, konkretisht sipas regjistrimit nr. ***, datë 3.6.2011, figuron e regjistruar në pronësi të shtetasës L.V pasuria tokë kullotë, me sip. 1.000 m² në vendin e quajtur Dh., Palasë. Vërtetimi¹³ është bashkëshoqëruar me planin e rilevimit të pasurisë.

18.6 Nga hetimi i kryer, Komisionit i rezultoi se për këtë pasuri, ZQRPP-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 30.10.2017, ka bashkëlidhur përgjigjen e ZVRPP-së Vlorë¹⁴, e cila nuk konfirmon pasuri¹⁵ në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të.

18.7 ZVRPP-ja Vlorë, me *email*-in e datës 22.11.2018, konfirmon bashkëpronësinë e shtetasve A.M dhe Sokol Malaj në një sipërfaqe trualli kullotë prej 1.000 m², në Dh., Palasë (zonë e pamenuar). Praktika ka të bashkëlidhur pasqyrën llogaritëse të tatimit për kalimin e të drejtës së pronësisë, mandatet e veprimeve bankare, kryer në “Raiffeisen Bank” në datën 29.6.2011, nga shtetasi E.L në favor të Degës së Tatimeve, për likuidim detyrime ndaj ZVRPP-së Vlorë.

18.8 Sipas vërtetimit nga dokumentet hipotekore të ZVRPP-së Vlorë¹⁶, konkretisht sipas regjistrimit nr. ***, datë 4.7.2011, figuron e regjistruar në pronësi të shtetasve A.M dhe Sokol Malaj pasuria tokë kullotë, me sip. 1.000 m², në vendin e quajtur Dh., Palasë.

18.9 Për sa është parashtruar më sipër, Komisioni konstatoi se subjekti ka deklaruar me vërtetësi dhe saktësi origjinën e kësaj pasurie¹⁷.

18.10 Në lidhje me gjendjen e ndonjë konflikti të mundshëm mes palëve në këtë shitblerje, për shkak të ushtrimit të funksionit të subjektit të rivlerësimit nëse subjekti ka hetuar, mosfilluar, pushuar apo dërguar për gjykim ndonjë çështje penale në ngarkim apo nisur nga shtetasja L.V, institucionet punëdhënëse¹⁸ të subjektit të rivlerësimit kanë konfirmuar se në asnjë rast ai nuk ka kryer ndonjë veprim hetimor, deri edhe në përfaqësimin në gjykim për këtë shtetase. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni konstatoi se nuk konfirmohen të dhëna për të konkluduar në ndonjë konflikt të mundshëm interes midis subjektit dhe shitësit të pasurisë.

18.11 Komisioni hetoi në lidhje me burimin e krijimit të shumës së investuar për këtë pasuri.

18.11.1 Duke qenë se subjekti ka deklaruar si burim krijimi për pjesën e tij takuese të ardhurat e siguruar nga ushtrimi i aktivitetit të bashkëshortes së tij në profesionin e stomatologes, Komisionit i ka rezultuar se të ardhurat e realizuara nga ky aktivitet¹⁹ për vitin 2011 janë në vlerën 3.217.920 lekë. Kjo shumë është më se e mjaftueshme për të përballuar investimin prej 100.000 lekësh.

18.11.2 Komisioni kreu analizën financiare vjetore, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare në shumën 533.677 lekë që të investonte në këtë pasuri, të kursente, si dhe të përballonte shpenzimet e tjera familjare, duke i kaluar barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit konstatues.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

¹³ Referojuni aneksit nr. 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁴ Nr. *** prot., datë 7.8.2017, në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁵ Referojuni aneksit nr. 27 në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁶ Referojuni aneksit nr. 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁷ Sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.12.2020, toka është vendosur në dispozicion të shoqërisë “****” sh.p.k., me qëllim ndërtimin e projektit “****”. Kontrata është administruar nga noteri publik A.M me shkresën nr. *** prot., datë 18.11.2022.

¹⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 7.3.2023, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; shkresë nr. *** prot., datë 6.3.2023, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; shkresë nr. *** prot., datë 6.3.2023, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

¹⁹ Sipas shkresës nr. *** prot., datë 19.1.2017, nga DPT-ja, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, në aneksin nr. *** , në dosjen e ILDKPKI-së.

18.12 Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e tij, ka shpjeguar se pamundësia financiare prej -533.677 lekësh nuk është e bazuar, pasi kjo pamundësi, referuar hetimit të Komisionit, rezulton nga shpenzimet e udhëtimeve të përlllogaritura nga Komisioni për vitin 2011, të cilat duhet të zbriten. Sipas subjektit, shpenzimet për dy udhëtimet e kryera në këtë vit, në një total prej 1.805 euro, janë mbuluar nga të afërm të bashkëshortes që kanë pagëzuar dy fëmijët e tij. Subjekti ka depozituar deklaratë noteriale, datë 19.4.2023, hartuar dhe nënshkruar përpara noterit publik në Athinë, Republika e Greqisë, me të cilën këta shtetas deklarojnë dhe konfirmojnë këto fakte.

18.12.1 Gjithashtu, subjekti ka kërkuar të zbriten si shpenzime edhe ato që lidhen me udhëtimin e qëndrimin zyrtar nga Tirana drejt Madridit, Spanjë, nga data 29.11.2011 deri më 2.12.2011, në vlerën 330 euro, duke përfshirë në këtë shumë vlerat prej 180 euro për biletat e avionit dhe 50 euro për çdo ditë qëndrimi (150 euro për të tria ditët). Sipas subjektit, ky udhëtim ka qenë me qëllim pjesëmarrjen në një seminar të organizuar nga Qendra Rajonale për Ambientin për Evropën Qendrore dhe Lindore, me temë “Suport për sistemin juridik shqiptar për krimin mjedisor”, ku shpenzimet janë mbuluar nga organizatorët. Lidhur me këtë deklaram, subjekti ka depozituar praktikën e komunikimit të kolegut prokuror O.D me organizatorët e këtij seminari, komunikimin me *email*, draft-marrëveshjen e dërguar prej tyre dhe biletën e avionit, marrëveshje nga e cila provohet se të gjitha shpenzimet e pjesëmarrësve në vizitën studimore do të përballoheshin nga REC (Qendra Rajonale për Ambientin për Evropën Qendrore dhe Lindore), përfshirë biletat e udhëtimit me avion, akomodimin në Madrid dhe pagesën *per diem* (ditore).

18.12.2 Subjekti në vijim ka kontestuar përlllogaritjet financiare, pasi, sipas tij, Komisioni ka përfshirë në likuiditetet në fund të vitit edhe vlerën prej 385.142 lekësh si gjendje në fund të vitit në bankë. Përfshirja e kësaj vlere (385.142 lekë) në këto likuiditete, sipas subjektit, ka passjellë ndikim në pamundësinë financiare prej -533.677 lekësh.

18.12.3 Në përfundim, subjekti ka parashtruar se me përfshirjen e shumave 1.805 euro + 330 euro dhe 385.142 lekë, si vlera të cilat duhet t'i zbriten vlerës negative të pamundësisë për vitin 2011 (prej -533.677 lekësh), atëherë balanca shndërrohet qartazi në pozitive.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

18.13 Trupi gjykues, në analizë të pretendimeve të subjektit për rishikimin e përlllogaritjeve financiare sipas shpjegimeve të dhëna dhe dokumentacionit të depozituar, në raport me faktet e konstatuara, ka marrë në analizë nivelin e provueshmërinë së tyre, duke çmuar kështu efektet e rivlerësimit, për sa arsyetohet:

18.14 Lidhur me pretendimin e subjektit për zbritjen e shpenzimeve për udhëtimet e kryera në vitin 2011, trupi gjykues konstaton se për dy udhëtimet e kryera drejt shtetit grek subjekti ka depozituar deklaratë nga pritësi dhe, për pasojë, ky pretendim duhet të merret në konsideratë. Për këto dy udhëtime, Njësia e Shërbimit Ligjor përfshiu në rilllogaritjet financiare vetëm vlerën e biletës së udhëtimit, si dhe shpenzime qëndrimi nga 5 euro/dita për secilin familjar.

18.14.1 Lidhur me shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimin zyrtar nga Tirana drejt Madridit, trupi gjykues konstaton se subjekti ka depozituar të njëjtin dokumentacion si edhe në pyetësorin standard, por në dokumentacionin e depozituar nuk identifikohet emri apo pjesëmarrja e subjektit. Po ashtu, konstatohet se marrëveshja e depozituar për këtë vizitë studimore referon si përfitues vetëm shtetasin O.D dhe konfirmon vetëm biletën e udhëtimit të këtij të fundit. Në këto rrethana, trupi gjykues çmon se dokumentacioni i paraqitur nga subjekti nuk provon pjesëmarrjen e tij në këtë trajnim dhe, për pasojë, ky pretendim nuk çmohet të merret në konsideratë.

18.14.2 Lidhur me pretendimin e subjektit për gjendjen e likuiditeteve (bankë + *cash*) për vitin 2011, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim i subjektit nuk qëndron, pasi përgjatë hetimit, me pyetësorin nr. 3, subjekti lidhur me kursimet e tij *cash* ka rikonfirmuar deklarinimet e tij në deklaratat periodike, ku kursimet *cash* për vitin 2011 kanë qenë në vlerën 4.200.000 lekë (ku 1.200.000 lekë nga pagat e tij si drejtues i Prokurorisë dhe 3.000.000 lekë nga aktiviteti privat i bashkëshortes) dhe se në asnjë rast nuk ka deklaruar se në këtë shumë përfshihen edhe likuiditetet në sistemin bankar. Trupi gjykues konstaton se edhe nëse merret në konsideratë ky pretendim i subjektit, atëherë gjendja *cash* e akumuluar nuk do të përputhet me: (i) deklarinimet periodike të subjektit; (ii) deklarinimin e tij në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI; (iii) deklarinimin e tij gjatë hetimit administrative; si dhe (iv) shumën e përdorur në vitet në vijim si burim krijimi për huan apo investimet e kryera. Ky ndryshim i deklarinimit nga ana e subjektit për kursimet e tij *cash* duket se pretendohet vetëm për të përmirësuar situatën financiare pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

18.14.3 Bazuar në vlerësimet e kryera, arsyetuar më sipër, pas marrjes në konsideratë vetëm të pretendimit për uljen e shpenzimeve për dy udhëtimet e kryera drejt shtetit grek, trupi gjykues konstaton se balanca negative nga 533.677 lekë rezulton në shumën 427.878 lekë.

19. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare në shumën 427.878 lekë të investonte në këtë pasuri, të kursente, si dhe të përballonte shpenzimet e tjera familjare për vitin 2011, duke u gjendur në kushtet e parashikuara në shkronjën “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, që është vlerësuar në tërësi me rrethanat e çështjes që janë përcaktuese për vlerësimin e kriterit të pasurisë.

20. Apartament banimi me sipërfaqe 109.7 m² (zonë e pamenaxhuar), me adresë: pallatet “****”, rruga “****”, porositur në datën 18.7.2006, blerë me kontratë nr. ****, datë 18.7.2006, në shumën 60.000 euro. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: kredia bankare në “Raiffeisen Bank”, në shumat 5.000.000 lekë dhe 2.300.000 lekë, financuar nga nëna (B.M) me të ardhurat që ka përfituar si pasojë e trashëgimisë nga vdekja e vëllait A.M (të ardhurat e këtij të fundit nga emigracioni në Greqi). Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacionin mbështetës.

Hetimi i Komisionit

20.1 Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar për herë të parë pasurinë apartament në DPV-në e vitit 2006. Në këtë deklaratë, subjekti ka përshkruar pasurinë e blerë, burimin e krijimit, si dhe detyrimet financiare për këtë kontratë pasurie të paluajtshme. Më konkretisht, subjekti ka deklaruar: “*Prenotim apartament banimi, me sipërfaqe 114 m², pallatet “****”, S, Tiranë, në shumën 60.000 euro, në pjesë takuese 100%*”. Ndërsa në rubrikën e detyrimeve financiare ka deklaruar kredinë bankare në vlerën 5.000.000 lekë, afati 300 muaj, kësti mujor 23.710,57 lekë, muaji gusht 2006, kontratë bankare datë 6.8.2006, me “Raiffeisen Bank” për blerje banese, si dhe detyrim ndaj firmës ndërtuese për blerjen e apartamentit në vlerën 2.300.000 lekë.

20.2 Në DPV-në e vitit 2007, subjekti ka deklaruar shlyerjen e detyrimit ndaj firmës ndërtuese “****” sh.p.k. në datën 26.2.2007, në vlerën 2.300.000 lekë. Ai ka sqaruar se në datën 26.2.2007 prindërit e tij (nëna) i kanë dhuruar shumën 2.300.000 lekë për shlyerjen e detyrimit ndaj firmës ndërtuese “****” sh.p.k. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se këto të ardhura janë të trashëguara nga prindërit e tij, nga vdekja aksidentale e vëllait A.M në vlerën 9.300.000 lekë, të cilat kanë qenë të depozituara përkatësisht në “Raiffeisen Bank” rreth 6.300.000 lekë, në Bankën e Shqipërisë rreth 2.100.000 lekë, si dhe 900.000 lekë huadhënie personave të tretë.

20.3 Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar²⁰, në lidhje me këtë pasuri, konstatohet se ajo nuk konfirmohet e regjistruar në ASHK. Gjithashtu, edhe ZQRPP²¹-ja ka bashkëlidhur përgjigjen e ZVRPP-së Tiranë, e cila nuk e konfirmon pasurinë e mësipërme në emër të z. Sokol Malaj.

20.4 Nga korrespondenca e Komisionit me noterin publik²², rezultoi se kjo pasuri fillimisht është porositur me kontratën e sipërmarrjes datë 17.7.2006, shoqëruar me vërtetim nënshkrimi nr. ***, datë 18.7.2006, për blerje apartamenti 109.7 m², së bashku me sipërfaqen e përbashkët të shkallëve. Vlera e pasurisë: 60.000 euro ose 7.350.000 lekë. Më pas është nënshkruar kontratë shitblerjeje e pasurisë së paluajtshme (apartament) ***, datë 31.5.2018. Vihet re se në kontratën e shitjes pasuria apartament pasqyrohet me sip. 80 m² dhe 13 m² verandë.

Aktualisht kjo pasuri, me nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, nuk është më në pronësi të subjektit të rivlerësimit, pasi më 29.12.2020 është shitur në vlerën 71.000 euro.

20.5 Për sa më sipër, duket se ka mospërputhje në deklaratimet e subjektit dhe dokumentacionin e administruar lidhur me sipërfaqen e kësaj pasurie, pasi në DPV-në e vitit 2006 subjekti ka deklaruar apartament me sip. 114 m², në deklaratën *Vetting* ka deklaruar sipërfaqe 109.7 m², ndërsa në kontratën e shitjes sipërfaqja e apartamentit është 80 m² dhe 13 m² verandë.

20.6 Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë apartament

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se si burim krijimi për këtë pasuri ka shërbyer kredia bankare në “Raiffeisen Bank” në vlerën 5.000.000 lekë, si dhe shuma e financuar prej nënës së tij në vlerën 2.300.000 lekë.

20.7 Lidhur me burimin e krijimit të shumës 5.000.000 lekë, kredi bankare

20.7.1 Nga dokumentacioni i administruar²³, rezultoi se me kontratën e kredisë bankare dhe të hipotekës nr. ***, datë 3.8.2006, e nënshkruar ndërmjet kredidhënësit “Raiffeisen Bank”, kredimarrësit Sokol Malaj, hipotekuesit K.S dhe N.S, është miratuar kredia në vlerën 5.000.000 lekë, me qëllim për blerje apartamenti. Kontrata e kredisë ka parashikuar si afat shlyerje periudhën 300 muaj. Sipas parashikimeve kontraktore, më konkretisht referuar nenit 3/2 si dhe 3/3 të saj, duket se subjekti ka përfutur kredi me kushte lehtësuese si funksionar i lartë i shtetit. Nga verifikimi i deklaratës për vitin 2006 dhe në vijim, deri edhe në deklaratën për *Vetting*, duket se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar kredinë të përfutur nën kushte lehtësuese.

20.7.2 Ndërkohë, “Raiffeisen Bank”, në korrespondencën e mbajtur me Komisionin, ka konfirmuar²⁴ kredinë nr. ***, datë 3.8.2006, si dhe ka depozituar dokumentacionin e plotë që disponon. Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar, rezultoi se në formularin e aplikimit subjekti ka deklaruar se jeton me qira dhe si adresë banimi ka deklaruar *rruga “***”, shtëpi private*, e njëjta adresë e deklaruar me atë në deklaratat periodike, si dhe gjatë hetimit.

20.7.3 Komisioni mbajti korrespondencë edhe me organin e Prokurorisë së Përgjithshme, për të konfirmuar ndjekjen e procedurës nga subjekti i rivlerësimit për përfitim të kësaj kredie dhe reciprokisht miratimin e saj nga titullari i institucionit. Në përgjigjen e dhënë, SPAK-u²⁵ nuk konfirmon

²⁰ Referuar informacionit të dhënë nga ASHK/Drejtoria Vendore Tirana Jug, me shkresën nr. *** prot., datë 31.5.2021, informacionit të dhënë nga ASHK/Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2, me shkresën nr. *** prot., datë 10.6.2021, nga informacioni i dhënë nga ASHK/Drejtoria Vendore Tiranë Veri, me shkresën nr. *** prot., datë 29.6.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

²¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 30.10.2017, administruar në dosjen e ILDKPKI-së. Referojuni aneksit nr. 27.

²² Kthim përgjigje nr. *** prot., datë 27.2.2023, nga noterin publik E.H.

²³ Aneks nr. 4/3 në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 3.3.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

²⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 20.3.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

ndonjë shkresë në lidhje me praktikën e miratuar për përfitim kredie, në favor të subjektit të rivlerësimit Sokol Malaj.

20.7.4 Subjekti, pasi është pyetur, ka deklaruar²⁶ se ka përfituar kredi me kushte lehtësuese, duke cituar gjithashtu të njëjtën kontratë kredie, objekt hetimi administrativ. Ai ka shpjeguar se në vitin 2006, kur është bërë aplikimi, mbante detyrën e prokurorit në Prokurorinë e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë dhe se në atë kohë jetonte prej 2 vitesh me qira në një banesë private në rrugën “****” dhe se blerjen e një banese e kishte pasur të domosdoshme, në kushtet kur po krijonte familje dhe nuk kishte në pronësi ndonjë banesë. Subjekti ka deklaruar se ka aplikuar së bashku me kolegë të tjerë në të njëjtat kushte sikurse kanë qenë edhe ata, por edhe gjyqtarë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Subjekti ka sqaruar se, me sa i kujtohet, ka aplikuar pranë Prokurorisë së Përgjithshme për t’u bërë pjesë e skemës së përfitimit nga këto kredi me kushte lehtësuese dhe se pas ardhjes së përgjigjes dhe miratimit nga Prokuroria e Përgjithshme është vijuar me lidhjen e kontratës së kredisë së sipërcituar me bankën, e cila, pasi ka ndjekur procedurat e saj, ka financuar rreth 75% të vlerës së apartamentit.

Subjekti ka depozituar praktikën e kredisë në CD, marrë nga “Raiffeisen Bank”.

20.7.5 Në lidhje me kriteret ligjore për përfitimin e kredisë (në këtë rast, nisur nga koha e përfitimit të kredisë, vepron VKM-ja Nr. 102/1999, e ndryshuar, “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore”²⁷)

20.7.6 Deri aktualisht, nga praktika e bankës ku edhe është përfituar kredia, por edhe nga dokumentacioni i administruar në dosjen e hetimit administrativ, Komisioni konstatoi se rezultojnë rrethanat faktiko-ligjore, konkretisht: (i) subjekti rezultoi me funksion në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë dhe, për rrjedhojë, ka përfituar kredi në vendin e ushtrimit të detyrës; subjekti ka deklaruar se është bashkëpronar në një shtëpi të ndërtuar përpara viteve 1990 në Mallakastër/fshati D, si dhe në 1/3 e tokës së përfituar me ligjin nr. 7501/1991, “Për tokën”, me kryefamiljar të atin e tij, z. J.M; (ii) subjekti rezultoi anëtar i vetëm në trung familjar, sipas certifikatës përkatëse; (iii) subjekti ka deklaruar se ka jetuar me qira në qytetin e Tiranës dhe ky fakt duket i provuar; (iv) subjekti ka depozituar vërtetimin e pagës; (v) subjekti nuk rezultoi zotëruar i ndonjë pasurie në Tiranë, vendin ku ushtronte detyrën në kohën e përfitimit të kredisë.

20.7.7 Bazuar në faktet e dala në raport me ligjin e zbatueshëm, Komisioni konstatoi se subjekti nuk ka përfituar kredi me kushte lehtësuese, në kundërshtim me ndonjë parashikim ligjor të aktit referues.

20.7.8 Në vijim të hetimit, po nga të dhënat e pasqyruara në dokumentacionin e administruar, konkretisht në kontratën e kredisë, rezultoi se hipotekuesit për të garantuar shlyerjen e plotë të kësaj kredie kanë

²⁶ Me pyetësorin nr. 5, datë 20.3.2023.

²⁷ *Gjatë kohës që funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë të administratës së lartë shtetërore janë pa banesë ose kanë nevojë për një shtesë sipërfaqeje banimi, u lind e drejta të kërkojnë strehim nga shteti. 3. Trajtimi me strehim bëhet sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet ministrit të Financave dhe “Raiffeisen Bank” të Shqipërisë, për sigurimin e skemës për kreditimin e funksionarëve dhe nëpunësve. 5. Listat për marrjen e kredive nga funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë të administratës së lartë shtetërore, sipas pikës 1 të këtij vendimi, bëhen me miratimin e Kryeministrit, pas kërkesës së motivuar të ministrive dhe të institucioneve përkatëse. Listat për marrjen e kredive, sipas paragrafit të mësipërm, dërgohen në Bankën e Kursimeve nga Kryeministri. Banka respekton emrat dhe radhën e vendosur në këto lista nga Kryeministri. 6. Kredia jepet me vlerë 5 milionë lekë me interes 3% dhe afat kthimi deri në 25 vjet, për funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë të administratës së lartë shtetërore dhe 2.5 milionë lekë me interes 3% dhe afat kthimi deri në 15 vjet, në përputhje me kërkesën e paraqitur nga funksionari. 6/1 Fondet e dhëna dhe të krijuara sipas skemës së zbatuar për trajtimin me strehim nëpërmjet sistemit të kredive shërbejnë për përballimin e diferencave të interesit, të parashikuara në pikën 6 të këtij vendimi, me interesin e ofruar nga banka e përzgjedhur, i cili nuk mund të jetë më i lartë se interesi i bonove të thesarit, me maturim 12-mujor, plus 1%. 7. Kredimarrësit paraqesin pranë Bankës së Kursimeve këto dokumente: (a) kërkesën personale; (b) certifikatën e gjendjes familjare; (c) dokumentin identifikues; (ç) dokumentin e vërtetimit të të ardhurave personale; (d) aktin e blerjes së banesës, vlerësimi i së cilës është bërë nga ekspertë vlerësues të licencuar; (dh) në rastin e ndërtimit të banesës paraqitet dokumentacioni sipas ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”. 8. Ekzekutimi i kredisë të bëhet pasi përfituesi i kredisë të vendosë për Bankën e Kursimeve me barrë hipotekore banesën e blerë apo të ndërtuar me kredi.*

vendosur hipotekë pasurinë apartament me nr. ***, ndodhur në rrugën “***”, S, z. k. ***, me sip. 124 m².

20.7.9 Komisioni hetoi në lidhje me ekzistencën e pasurisë së vënë në hipotekë, si dhe titullarin e saj, nga ku rezultoi se sipas vërtetimit nga dokumentet hipotekore të ZVRPP-së Tiranë figuron e regjistruar në pronësi të shtetasit K.S e njëjta pasuri e hipotekuar me nr. ***, me sip. 124 m², apartament, me vendndodhje në Tiranë, rruga “***”, e regjistruar në regjistrin nr. ***, datë 12.10.2005.

20.7.10 Subjekti është pyetur²⁸ lidhur me marrëdhënien që ka me hipotekuesit e pasurisë në favor të bankës, me qëllim përfitimin e kredisë prej tij, nga ku ka konfirmuar se shtetasja N.S është e afërmja e tij (kushërirë e parë, vajza e vëllait të nënës së tij), ndërsa shtetasi K.S është bashkëshorti i saj.

20.7.11 Në përfundim, nga analizimi i lëvizjeve të llogarisë bankare të subjektit të rivlerësimit në “Raiffeisen Bank”²⁹, rezultoi se kredia është disbursuar në datën 8.8.2006 në shumën 5.000.000 lekë dhe të nesërmen, në datën 9.8.2006, kjo shumë është transferuar në favor të shoqërisë “***” sh.p.k., me përshkrimin “Pagesë detyrimi nga Sokol Malaj”.

20.8 Lidhur me burimin e krijimit të shumës 2.300.000 lekë, të financuar nga nëna e subjektit të rivlerësimit, znj. B.M

20.8.1 Nga analizimi i lëvizjeve të llogarisë së nënës së subjektit në “Raiffeisen Bank”³⁰, rezultoi se në datën 26.2.2007 është kryer transferimi i shumës 2.300.000 lekë në favor të shoqërisë “***” sh.p.k., me përshkrimin “Detyrim për blerje shtëpie nga B.M”.

20.8.2 Subjekti është pyetur³¹ lidhur me ligjshmërinë e krijimit të kësaj shume, si dhe të pagesës së kryer nga nëna e tij për këtë pasuri, ndërkohë që porositësi i saj ka qenë vetë subjekti i rivlerësimit dhe në përgjigjen e dhënë ka deklaruar se shuma 2.300.000 e transferuar nga nëna e tij ka ardhur nga trashëgimia ligjore që prindërit e tij kanë trashëguar³² nga i ndjeri djali i tyre/vëllai i subjektit. Në lidhje me krijimin e shumës, subjekti ka deklaruar se *vëllai i tij i ndjeri A.M, duke filluar nga muaji janar 1997, ka qenë emigrant ekonomik në Greqi, në qytetin e A. Atje ka punuar pa ndërprerje, duke qenë i siguarur dhe ka krijuar të ardhura. Për shkak të rrethanave se ai nuk jeton më (ka ndërruar jetë në datën 26.10.2006), subjekti deklaron se ai ka arritur të sigurojë vetëm një sërë dokumentesh (që ndodheshin tek sendet e tij personale), që provojnë jetesën e tij në atë vend, të ardhura të realizuara, sigurime shoqërore e shëndetësore të paguara, deklarime në organet tatimore të shtetit grek. Subjekti ka deklaruar se vëllai i tij, duke filluar nga vitet 2000, ndërsa nga statementi bankar rezulton të paktën se nga data 1.10.2003 ai ka çelur llogari bankare kursimi pranë Bankës së Kursimeve dhe më pas në “Raiffeisen Bank”, duke investuar edhe në bono thesari. Kjo llogari është kredituar me kursimet e tij, nga vetë ai, ndër vite.*

20.8.3 Në mbështetje të deklarimeve të kryera, subjekti ka depozituar dokumentacionin justifikues të cilin ka mundur ta sigurojë, si: dokumente nga shteti grek të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara; kopje të pasaportës së vëllait të tij të ndjerë A.M, për të provuar edhe hyrje-daljet e tij drejt Greqisë; *statement* të llogarisë së vëllait të ndjerë A.M, në “Raiffeisen Bank”; si dhe vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për çeljen e trashëgimisë.

²⁸ Pyetësor nr. 2, datë 5.1.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

²⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 28.5.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

³⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 21.11.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

³¹ Me pyetësorin nr. 2, datë 5.1.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

³² Me dëshminë e trashëgimisë së çelur me vendimin nr. ***, datë 24.1.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

20.8.4 Nga verifikimi dhe analizimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti lidhur me provueshmërinë e të ardhurave të krijuara nga vëllai i subjektit të rivlerësimit, Komisionit i rezultoi se i ndjeri A.M ka siguruar të ardhura në shtetin grek, si vijon:

- në korrik të vitit 1998 ka përfituar 55.100 dhrahmi të ardhura dhe 13.775 dhrahmi dhurata;
- për vitin 2001 ka përfituar 1.040,51 euro;
- për vitin 2006 ka përfituar 8.047,49 euro.

20.8.5 Komisioni mbajti korrespondencë me “Raiffeisen Bank” për llogaritë bankare/kursimet e shtetasit A.M, e cila ka informuar³³ se ky shtetas ka pasur llogari investimi bono thesari/obligacione, me gjendje aktuale zero lekë. Nga verifikimi i *statement*-it rezulton se llogaria rrjedhëse e të ndjerit A.M, në datën 1.10.2004, është në vlerën 503.328,70 lekë, si rezultat i tepricës së mbartur nga ish-Banka e Kursimeve. Po në këtë llogari, në datën 6.9.2005, është kredituar shuma 5.653.555 lekë nga investimi i mëparshëm në bono thesari. Kjo shumë së bashku me gjendjen e mëparshme është investuar në bono thesari dhe depozitë në vitet pasardhëse, ku si rezultat i këtyre investimeve janë përfituar edhe interesat përkatëse nga bono dhe nga depozita. Gjithashtu, rezulton se i ndjeri A.M ka depozituar në datën 19.6.2006 shumën 300.000 lekë, në llogarinë e tij rrjedhëse.

20.8.6 Në tërësi, lidhur me ligjshmërinë e këtij burimi, Komisioni konstatoi se dukej se kursimet e të ndjerit A.M datonin herët, por mbi të dhënat e administruara deri në këtë fazë të hetimit subjekti duhet të vijonte të jepte shpjegime bindëse dhe të provonte me dokumentacion justifikues burimin e ligjshëm të krijimit të të ardhurave të përfituara.

20.8.7 Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarive të vëllait të subjektit të rivlerësimit në “Raiffeisen Bank”, rezulton se në datën 26.2.2007 janë transferuar nga llogaritë e shtetasit A.M (aktualisht i ndjeri), në favor të llogarive të nënës së subjektit, znj. B.M dhe babait të subjektit të rivlerësimit, z. J.M, përkatësisht shumat 2.974.020,5 lekë dhe 150.181 lekë, në emër të secilit prej tyre, sipas vendimit për çeljen e trashëgimisë, ku secili prej tyre përfiton nga 1/2 pjesë të të gjithë pasurisë trashëgimore të trashëgimlënësit A.M kudo që ndodhen, si dhe marrin përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin prej saj.

20.8.8 Konstatohet se nëna e subjektit, znj. B.M, po në këtë datë, 26.2.2007, nga shumat e mbërritura në llogari ka kryer edhe transfertën prej 2.300.000 lekësh në favor të shoqërisë “****” sh.p.k.

20.9 Në lidhje me likuidimin e kësaj pasurie

20.9.i Nga verifikimi i kontratës së porosisë³⁴ konstatohet se në nenin 3 të saj është përcaktuar çmimi i shitjes së apartamentit në vlerën 60.000 euro (7.350.000 lekë), i cili do të shlyhej me këste dhe, më konkretisht, ka parashikuar se: shuma 5.000.000 lekë likuidohet me marrjen e kredisë; shuma 735.000 lekë me marrjen e çelësave; dhe diferenca prej 1.615.000 lekësh likuidohet deri më 15.9.2006.

20.9.ii Lidhur me kryerjen e pagesave të kësteve, kontrata ka parashikuar se ato do të vërtetohen me mandatarëtimet e sipërmarrësit.

20.9.iii Komisioni konstatoi se nga shuma totale e çmimit të pasurisë prej 7.350.000 lekësh rezultonte e paguar me transfertë bankare vetëm 7.300.000 lekë. Për rrjedhojë, subjekti është pyetur³⁵ lidhur me pagesën e shumës 50.000 lekë, e cila rezulton e papaguar sipas dokumentacionit të administruar.

³³ Me shkresën nr. *** prot., datë 6.3.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

³⁴ Referojuni aneksit nr. 4/3 në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁵ Me pyetësorin nr. 2, datë 5.1.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

20.9.iv Në lidhje me shumën 50.000 lekë, e cila dukej e pakonfirmuar si e paguar (gjithnjë duke iu referuar diferencës së konstatuar midis vlerës së përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes dhe vlerës së konfirmuar si e paguar nëpërmjet sistemit bankar), subjekti ka deklaruar se pjesa e mbetur prej 50.000 lekësh është paguar *cash* pranë zyrave të shoqërisë shitëse. Këtë shumë Komisioni e ka përfshirë si të paguar në vitin 2006, pasi në deklaratën periodike të atij viti (2006) subjekti ka deklaruar si detyrim të mbetur ndaj shoqërisë vetëm vlerën 2.300.000 lekë.

20.10 Gjithashtu, nga korrespondenca e mbajtur me ASHK-në dhe drejtoritë vendore të saj, lidhur me ekzistencën e ndonjë pasurie në favor të prindërve të subjektit, të prejardhur nga ndonjë marrëdhënie kontraktore me shoqërinë “****” sh.p.k., Komisionit nuk i rezultoi ndonjë e tillë.

20.11 Mbi këto të dhëna, Komisioni vlerësoi që në përlllogaritjet për analizën financiare për vitet 2006 - 2007, deri në këtë fazë të hetimit, të mos e marrë në konsideratë shumën 2.300.000 lekë, kur është investuar në këtë pasuri.

20.12 Komisioni hetoi në lidhje me ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm të interesit midis subjektit të rivlerësimit për shkak të pozicionit të tij, në raport me hipotekuesit e pasurisë në favor të përfitimit të kredisë në shumën 5.000.000 lekë, si dhe në raport me shoqërinë “****” sh.p.k., me administrator shtetasin H.Q, ku nga informacioni i administruar³⁶ nuk u konfirmua një fakt i tillë.

20.13 Komisioni hetoi gjithashtu në lidhje me ndonjë trajtim të mundshëm preferencial në përfitimin e kësaj pasurie. Komisioni i është referuar udhëzimit nr. 5, datë 7.9.2006, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave dhe të koeficientit “K” për vitin 2006”.

Sipas këtij udhëzimi rezultojnë se kostoja e shitjes në tregun e lirë të apartamenteve në qytetin e Tiranës është 79.615 lekë/m² sipërfaqe e shfrytëzueshme.

Apartamenti i porositur nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2006 është me sip. 109.7 m². Duke u bazuar në çmimet referuese, rezultojnë se vlera e apartamentit është 8.733.766 lekë (109.7 m² x 79.615 lekë/m²). Kjo vlerë rezultojnë më e lartë nga çmimi që ka paguar subjekti, pasi apartamenti është blerë në vlerën 7.350.000 lekë. Pra rezultojnë se kjo pasuri është blerë 1.383.766 lekë³⁷ më lirë nga çmimet e tregut.

20.14 Në përfundim, për këtë pasuri, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për të provuar të kundërtën e rezultatit, pasi dukej se: (i) subjekti nuk ka pasur mundësi financiare në shumën 1.741.533 lekë të investojë në këtë pasuri, të kursejë, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare, për shkak të mosmarrjes në konsideratë të shumës 2.300.000 lekë; (ii) subjekti e kishte përfituar këtë pasuri me trajtim preferencial, në raport me çmimet referuese të tregut, në kundërshtim me nenin 23, pika 1 e ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar, dhe i kërkoi të depozitonte kontrata të ngjashme që i përkisnin thujtë të njëjtë vit investimi me të njëjtën sipërfaqe me pasurinë e subjektit; (iii) kishte mospërputhje në deklaratimet e subjektit dhe dokumentacionit të administruar për këtë pasuri, pasi në DPV-në e vitit 2006 subjekti kishte deklaruar apartament me sip. 114 m², në deklaratën *Vetting* apartament me sip. 109.7 m², ndërsa në kontratën e shitjes sipërfaqja e apartamentit pasqyrohej 80 m² dhe 13 m² verandë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

³⁶ Sipas shkresës nr. *** prot., datë 13.1.2023, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier; shkresës nr. *** prot., datë 13.1.2023, të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; shkresës nr. *** prot., datë 11.1.2023, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë; shkresës nr. *** prot., datë 13.1.2023, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shkresës nr. *** prot., datë 13.2.2023 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; shkresës nr. *** prot., datë 16.2.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; shkresës nr. *** prot., datë 16.2.2023, të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; si dhe shkresës nr. *** prot., datë 16.2.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

³⁷ Vjen si rezultat i diferencës së vlerës me çmime referuese dhe çmimit të paguar nga subjekti, pra 8.733.766 lekë - 7.350.000 lekë.

20.14.1 Lidhur me burimin e krijimit të shumës 2.300.000 lekë, e financuar nga nëna në datën 26.2.2007, subjekti ka shpjeguar se ky burim është nga trashëgimia ligjore e vëllait (të ndjerë) dhe vlerat monetare janë transferuar nëpërmjet sistemit bankar nga llogaria bankare e vëllait, pas çeljes së dëshmisë së trashëgimisë së tij, tek llogaria e prindërve, dhe më pas nga llogaria bankare e nënës së tij tek llogaria bankare e firmës ndërtuese “****” sh.p.k.

Subjekti ka depozituar në cilësinë e provës dokumentin “Libreza origjinale e Sigurimeve Shoqërore (IKA)”, e lëshuar nga dega e institucionit në A, Greqi, nga përmbajtja e të cilës, sipas subjektit, pasqyrohen ditët e paaftësisë për punë dhe raportet e mjekut të ISSH/IKA për periudhën 2000 – 2006, çka provon punësimin e tij të ligjshëm të paktën nga viti 2000 e në vijim në shtetin grek dhe rrjedhimisht ligjshmërinë e të ardhurave të krijuara prej tij, të cilat kanë bërë të mundur krijimin e llogarisë bankare në Shqipëri dhe kreditimin e saj. Për rrjedhojë, subjekti ka pretenduar që Komisioni në zërin “Të ardhura” të përfshijë shumën prej 2.300.000 lekësh, në rubrikën “Të ardhura nga trashëgimia dhuruar nga nëna”, nga ku rezulton se diferenca midis të ardhurave, shpenzimeve dhe pasurive do të jetë pozitive, konkretisht në vlerën +558.467 lekë.

20.14.2 Në lidhje me ndryshimin e sipërfaqes së apartamentit nga 109.7 m² në 114 m², midis deklaratës *Vetting* dhe DPV-së së vitit 2006, subjekti i është referuar përgjigjeve të dhëna në pyetësonin nr. 3, ku sipas tij *sipërfaqja 109.7 m² e këtij apartamenti përfaqëson sipërfaqen neto (ambiente të brendshme + verandë), ndërsa sipërfaqja totale së bashku me sipërfaqet e përbashkëta ishte 114 m²*. Sipas subjektit, regjistrimi i kësaj pasurie nga shoqëria ndërtuese me një sipërfaqe prej 80 m², sipërfaqe neto e brendshme, dhe 13 m² sipërfaqe verande, si dhe shitja nga “****” sh.p.k. tek subjekti në datën 31.5.2018, janë elemente të cilat i përkasin procesit të regjistrimit nga ZVRPP-ja Tiranë, proces i ndjekur nga shoqëria ndërtuese “****” sh.p.k.

20.14.3 Në lidhje me konstatimin e Komisionit për trajtim preferencial në blerjen e kësaj pasurie, subjekti ka parashtruar se në rastin konkret nuk ka asnjë trajtim të tillë preferencial, pasi firma ndërtuese “****” sh.p.k. ka shitur në shumë raste edhe apartamente të tjera me çmim të përafërt, madje edhe më të ulët sesa çmimi i shitjes së apartamentit të tij. Subjekti ka depozituar 5 kontrata të ngjashme, që sipas tij i përkasin apartamenteve të ndodhura në të njëjtin pallat, të cilat janë lidhur dhe ekzekutuar midis palëve shumë vite më vonë nga kontrata e tij e lidhur që në vitin 2006, konkretisht në vitin 2012 apo vitin 2015.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

20.15 Trupi gjykues, në analizë të pretendimeve të subjektit në raport me faktet e konstatuara në çështjen objekt vlerësimi, arsyeton:

- Sa i takon vlerësimin për ligjshmërinë e kursimeve të vëllait të subjektit (të ndjerit), trupi gjykues, sikurse ka konstatuar përgjatë hetimit, vlerëson se u provua fakti që këto të ardhura datojnë herët dhe se identifikohen transaksione me bankë të kryera nga i ndjeri, të paktën që prej vitit 2003. Nga ana tjetër, nga dokumentacioni i depozituar gjatë hetimit nga subjekti i rivlerësimit, provohet fakti se vëllai i subjektit ka siguruar të ardhura në shtetin grek, konkretisht: në korrik të vitit 1998 ka përfituar 55.100 dhrahmi dhe 13.775 dhrahmi dhurata; për vitin 2001 ka përfituar 1.040,51 euro; për vitin 2006 ka përfituar 8.047,49 euro.

Trupi gjykues, referuar dokumentacionit të depozituar nga subjekti, konkretisht Librezës origjinale të Sigurimeve Shoqërore (IKA), lëshuar nga dega e atij institucioni në A, Greqi, në të cilën identifikohen vizita mjekësore dhe raporte prej vitit 2000 deri në vitin 2006, e konsideron këtë si një provë indirekte që vëllai i subjektit ka qenë i punësuar dhe i siguruar, për sa kohë që ka përfituar raporte për paaftësi në punë, si dhe kompensime për shkak të sëmundjes. Trupi gjykues çmon se faktet janë të tilla që nuk krijojnë dyshime për ligjshmërinë e tyre dhe, për rrjedhojë, të ardhurat e vëllait duhet të merren në

konsideratë. Njësia e Shërbimit Ligjor ripërlllogariti analizën financiare për vitin 2007 dhe rezultati financiar nga balancë negative prej 1.741.533 lekësh, pas përfshirjes së shumës 2.300.000 lekë, rezulton pozitive.

20.15.1 Lidhur më çështjen e mospërputhjes së sipërfaqes dhe trajtimit preferencial, trupi gjykues çmon se shpjegimet e subjektit janë bindëse. Ky konkluzion është rezultat edhe i krahasimit të të dhënave të kësaj pasurie me ato të kontratave të ngjashme që subjekti depozitoi, ku nuk evidentohet ndonjë rrethanë e trajtimit preferencial, por edhe në mungesë të evidentimit të ndonjë situatë për konflikt interesi, trupi gjykues konkludon se në çështjen objekt vlerësimi nuk vërehet ndonjë problematikë që mund të cenojë procesin e rivlerësimit të subjektit.

21. Apartament banimi me nr. pasurie * dhe nr. ***, me sipërfaqe (96 m² + 51.7 m²), në vlerën 68.060 euro, si dhe garazh me sipërfaqe 33.2 m², me nr. pasurie ***, me vlerë 10.715 euro, me adresë rruga “****”, S, blerë me kontratën nr. *** rep. dhe *** kol., datë 25.1.2016. Burimi i krijimit: të ardhurat e realizuara nga biznesi “klinikë dentare” në pronësi të bashkëshortes A.M. Vlera: 78.775 euro. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacionin mbështetës.**

Hetimi i Komisionit

21.1 Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar për herë të parë pasurinë apartament banimi dhe garazh, në DPV-në e vitit 2016. Nga verifikimi i DPV-së për vitin 2016 rezultoi se subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar këto pasuri me të njëjtin përshkrim si në deklaratën *Vetting*.

21.2 Nga dokumentacioni i administruar³⁸ rezulton se me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.1.2016, nënshkruar ndërmjet palës shitëse, shoqëria “****” sh.p.k. dhe palës blerëse Sokol Malaj, janë blerë pasuritë: (i) apartament me sip. 96 m² në shumën 44.230 euro, apartament me sip. 51.7 m² në shumën 23.830 euro, si dhe (ii) garazh me sip. 33.2 m², kundrejt shumës 10.715 euro. Në total të tria pasuritë janë blerë kundrejt shumës 78.775 euro.

21.3 Në lidhje me origjinën e kësaj pasurie, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar rezultoi se ZQRPP-ja³⁹, në përgjigjen shoqëruese të ZVRPP-së Tiranë, konfirmon në emër të z. Sokol Malaj pasuritë nr. ***, të llojit “apartament”, me sipërfaqe 96 m², si dhe pasurinë nr. ***, të llojit “garazh”, me sipërfaqe 33.2 m².

21.3.i ZVRPP-ja Tiranë⁴⁰ konfirmon se apartamentet me nr. pasurie *** dhe *** janë bashkuar në një numër pasurie, duke përfutur pasurinë nr. ***.

21.3.ii Sipas dokumentacionit shoqërues të praktikës, më konkretisht referuar kartelës së pasurisë, konstatohet se pasuria është regjistruar në datën 26.1.2016, me nr. ***, si transaksion i gjeneruar nga bashkimi i pasurive.

21.3.iii Mbi këtë bashkim pasurish, kartelat e mëparshme të tyre nr. *** dhe nr. *** rezultojë të mbyllura, ndërsa kartela e pasurisë së paluajtshme garazh me nr. *** rezulton në emër të subjektit të rivlerësimit.

21.4 Nga dokumentacioni i administruar dukej se nuk rezultonin problematika në lidhje me origjinën e përfitimit të pasurive.

21.5 Në lidhje me burimin e krijimit të këtyre pasurive

³⁸ Aneks nr. 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 19.04.2018, referojuni aneksit nr. 29 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴⁰ Me email-in e datës 27.11.2018, referojuni aneksit nr. 30 në dosjen e ILDKPKI-së.

21.5.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* si burim krijimi për këto pasuri të ardhurat e realizuara nga aktiviteti “klinikë dentare”, në pronësi të bashkëshortes A.M.

Komisioni hetoi për ekzistencën e aktivitetit privat në emër të bashkëshortes, si dhe për fitimin e realizuar prej tij. Nga hetimi rezultoi se:

- QKB-ja⁴¹ informon se A.N.M figuron e regjistruar si person fizik me NIPT ***.
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve⁴² informon se A.N.M është administratore e subjektit “****” (person fizik), me NIPT ***, themeluar më 22.4.2009. Kjo drejtori ka vendosur në dispozicion edhe deklaratat e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitet 2014 – 2020.
- Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë⁴³ gjithashtu ka dhënë të dhëna edhe për aktivitetin e bashkëshortes së subjektit, duke informuar edhe për fitimin e realizuar në çdo vit.

21.5.2 Bazuar në deklaratat e tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël dhe deklaratat e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, rezulton se të ardhurat në total për periudhën 2009 – 2016 janë në vlerën 28.210.084 lekë.

21.5.3 Për vitet 2015 dhe 2016, Komisioni, në përllogaritje ka marrë në konsideratë fitimin real dhe jo atë tatimor. Konkretisht, fitimi real për vitin 2015 është në vlerën 4.048.519 lekë dhe për vitin 2016 është në vlerën 2.534.732 lekë. Këto vlera, duke u bazuar në shpenzimet reale sipas deklaratës së tatimit të thjeshtuar të fitimit, vijnë si rezultat i diferencës mes të ardhurave të realizuara dhe shpenzimeve reale, pa zbritur shpenzimet e panjohura, të cilat janë për efekt të përllogaritjes së fitimit tatimor.

21.5.4 Lidhur me detyrimet tatimore të subjektit “****” (person fizik), me NIPT ***, DRT-ja Tiranë ka informuar se ato janë në vlerën 0 (zero) lekë.

21.5.5 Komisioni nuk konstatoi problematika mbi ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtyre të ardhurave, për sa kohë rezultoi se ato vijnë nga aktiviteti tregtar dhe se për to janë paguar detyrimet tatimore.

21.6 Subjekti i rivlerësimit, të ardhurat e realizuara nga aktiviteti “klinikë dentare” e bashkëshortes, i ka deklaruar si kursime pothuajse në çdo vit të deklarimit të tij periodik vjetor.

21.7 Meqenëse për vitet 2015 dhe 2016 nuk rezultoi deklarim për shtesa apo pakësime për kursimet në *cash*, Komisioni e ka pyetur subjektin e rivlerësimit lidhur me gjendjen e kursimeve *cash* në fund të viteve 2015 dhe 2016, pasi subjekti në deklaratën *Vetting* dhe atë periodike vjetore të vitit 2016, ka deklaruar përdorimin e tyre për investime në pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme. Subjekti ka deklaruar: “Gjendja e *cash* në fund të vitit 2014 ka qenë 15.000.000 lekë, e krijuar nga kursimet e deklaruara në DPVV-në e viteve 2011, 2012, 2013 dhe 2014. Gjatë vitit 2015 gjendja *cash* është pakësuar për përballimin e dhënies së huas vëllait A.M, në vlerën 3.500.000 lekë, për përballimin e kësteve të paguara për blerjen e apartamentit tek shoqëria “****” sh.p.k. në vlerën 30.000 euro dhe blerje e automjetit të markës “***”, në vlerën 9.000 euro. Gjendja *cash* e pakësuar gjithsej gjatë vitit 2015 është 9.000.000 lekë dhe gjendja *cash* e disponuar në datën 31.12.2015 është 6.000.000 lekë.gjendja *cash* më 31.12.2016 ka qenë 0 (zero) lekë”.

21.8 Në procesverbalin⁴⁴ e mbajtur në ILDKPKI në datën 9.2.2016, subjekti është pyetur lidhur me kursimet e tij *cash* dhe ka deklaruar: “Gjendja *cash* është deklaruar vit pas viti dhe në fund të vitit 2014

⁴¹ Shkresë nr. *** prot., datë 27.5.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

⁴² Me shkresën nr. *** prot., datë 25.5.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

⁴³ Aneks nr. 38 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴⁴ Administruar me shkresën nr. *** prot., datë 9.10.2020, nga ILDKPKI-ja.

ka qenë rreth 15.300.000 lekë. Pjesa më e madhe e saj është përdorur gjatë vitit 2015 dhe në janar të vitit 2016 për blerjen e dy apartamenteve, arredimin e tyre, një garazh dhe një makinë”.

21.9 Nisur nga deklarimi i subjektit, Komisioni ka vlerësuar që shumës së akumuluar në fund të vitit 2014, prej 15.000.000 lekësh (duke u bazuar në deklaratimet periodike), t’i zbresë investimet e vitit 2015, konkretisht:

- 30.000 euro ose 4.129.500 lekë për blerjen e apartamentit me sip. 73 m², te Rruga e ***, nga “****”;
- 9.000 euro ose 1.238.850 lekë për blerjen e automjetit tip “Peugeot”;
- 3.500.000 lekë dhënie huaje vëllait A.M.

Pas zbritjes së shumës së investimeve të mësipërme, rezulton se në fund të vitit 2015 ai disponon shumën 6.000.000 lekë, sikurse ka deklaruar edhe gjatë hetimit administrativ.

21.10 Subjekti i rivlerësimit në DPV-në e vitit 2016, në rubrikën e të dhënave konfidenciale, ka deklaruar: “Në muajin tetor 2016 vëllai A.M më ka kthyer shumën 10.000.000 lekë, të cilën ia kisha dhënë hua ndër vite (nga të ardhurat e krijuara nga klinika e bashkëshortes), shuma e kthyer u përdor për blerjen e apartamentit të deklaruar në pikën nr. 1 të formatit nr. 3”.

21.11 Me pyetësin nr. 2, subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.1.2017, të lëshuar nga vëllai i tij A.M, i cili deklaroi se shumën totale prej 10.000.000 lekësh ia ka kthyer vëllait Sokol Malaj në janar të vitit 2016. Deklarata është konfirmuar edhe nga noteri publik⁴⁵, i cili ka depozituar fletën e regjistrimit noterial, nga ku vërehet regjistrimi i aktit noterial.

21.12 Krahasimisht, mes deklaratimeve të bëra nga subjekti, dukej se kishte mospërputhje midis deklaratimit të tij dhe aktit noterial lidhur me saktësimin e kohës se kur ishte kthyer huaja.

21.13 Komisioni hetoi mbi mundësitë financiare të vëllait të subjektit, z. A.M, për kthimin e shumës 10.000.000 lekë subjektit të rivlerësimit.

21.13.i Nga korrespondenca e Komisionit me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, kjo e fundit, nëpërmjet Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë⁴⁶, informoi se:

- A.M, me NIPT ***, rezulton i regjistruar në sistemin tatimor më 21.3.2011, me status ligjor “Person Fizik”, fusha e aktivitetit “****”, nuk ka dorëzuar deklaratatë të ardhurash, rezulton me status “pasiv” nga data 24.12.2014 dhe ka detyrime të papaguara në vlerën 20.000 lekë.
- “****” sh.p.k., me NIPT ***, rezulton i regjistruar në sistemin tatimor më 25.11.2011, me status ligjor “Sh.P.K.”, fusha e aktivitetit “****”. Të ardhurat e deklaruara nga ky subjekt sipas të dhënave të deklaratave të të ardhurave të dorëzuara në sistemin tatimor janë si vijon:

Tabela nr. 1

Viti	Qarkullimi	Fitimi/humbja	Fitimi pas tatimit
2011	3,727,514		
2012	2,410,152	(575,000)	
2014	4,311,618	650,480	601,694
2015	4,234,147	70,902	45,902
2016	5,627,350	254,928	242,182
	TOTAL	401,310	889,778

⁴⁵ Me vërtetimin e njësitit me origjinalin i kopjes së nxjerrë nga arkivi noterial, nr. *** prot., datë 23.3.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁴⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 16.3.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

Ky subjekt nuk ka shpërndarë dividend dhe ka detyrime të papaguara në vlerën 27.500 lekë.

21.13.ii Subjekti, për të provuar ligjshmërinë e shumës së huas së kthyer nga shtetasi A.M, në përgjigje të pyetësorit⁴⁷ ka deklaruar: *“...shumën totale prej 10.000.000 lekësh vëllai ma ka kthyer në muajin janar 2016. Vëllai A.M, duke ushtruar aktivitetin e tij tregtar si sipërmarrës me ekip punëtorësh, ka krijuar në mënyrë të vazhdueshme marrëdhënie kleringu me shoqëri ndërtimi, të tilla si: “****” sh.p.k., “****” sh.p.k., “****” sh.p.k. etj., duke kryer punime për ndërtimet e realizuara nga këto shoqëri dhe duke përfitur sipërfaqe ndërtimi prej tyre. Një nga këto marrëdhënie kleringu ka qenë edhe apartamenti i ndodhur në rezidencën “****”, hyrja nr. ***, ap. nr. ***, Tiranë, i ndërtuar nga subjekti “****” sh.p.k., të cilin im vëlla e ka marrë në posedim në vitin 2012. Në kushtet kur shuma prej 10.000.000 lekësh i ishte dhënë borxh nga ana ime tim vëllai (shtetasit A.M), kthimi i saj është realizuar dhe ka shërbyer për formalizimin e kontratës së shitjes me “****” sh.p.k., në datën 25.1.2016, të apartamentit të banimit dhe garazhit në rrugën “****”, kundrejt vlerës 78.775 euro. Formalizimi në këtë mënyrë i marrëdhënies së transferimit të pronësisë nga shoqëria ndërtuese tek përfituesi, nëpërmjet shitblerjes dhe pagimit të vlerës prej 78.775 euro, ishte një kërkesë e shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k. Shoqëria “****” sh.p.k. dhe im vëlla kanë deklaruar më pas shlyerjen dhe zerimin e detyrimeve ndaj njëri-tjetrit. Kjo mënyrë e ndërtimit të marrëdhënieve të kleringut midis tim vëllai A.M dhe disa shoqërive ndërtuese, nëpërmjet përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore kundrejt punimeve të kryera (marrëdhënie kleringu), rezultoi e pasqyruar në kontrata të shtrira në kohë dhe të ekzekutuara për mbi 10 ambiente, njësi, apartamente banimi dhe garazhe, të cilat kam arritur të siguroj dhe i përcjell pranë Komisionit. Fakti që nga ana e shoqërisë “****” sh.p.k. kjo marrëdhënie është formalizuar me kontratë shitjeje, dua të theksoj se është ndjekur e njëjta praktikë me rastet e tjera dhe për këtë subjekti ka konkretizuar kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.2.2012, lidhur midis shoqërisë “****” sh.p.k. dhe subjektit juridik “****” sh.p.k. (në pronësi të vëllait A.M), me objekt kryerjen e punimeve të rifiniturës në të gjitha objektet që kompania “****” sh.p.k. ndërtonte në atë kohë në zonën e Komunës F. Palët në atë kontratë janë dakordësuar që çmimi i kontratës do të ishte sipas listës së çmimeve të miratuara dhe përcaktuara nga të dyja palët dhe sipas nenit 4 të kontratës, pagesa do të bëhej në masën 100% me klering. Ajo kontratë fillestare sipërmarrjeje është detajuar më pas në disa kontrata të tjera sipërmarrjeje për ambiente (sipërfaqe ndërtimore) konkrete. Sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., *** kol., datë 7.6.2012, palët kanë rënë dakord që shtetasi A.M të përfitonte një apartament me nr. *** dhe sipërfaqe 124.6 m², me vlerë 74.760 euro. Sipas nenit 2 të kësaj kontrate palët dakordësoheshin që ky apartament do të kalonte në pronësi të A.M, në momentin që do shlyheshin me punë (klering) nga porositësi A.M. Më pas, kjo pasuri, me kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.10.2015, i është shitur drejtpërdrejt nga shoqëria “****” sh.p.k. blerësit E.M (kushëri i imi dhe i tim vëllai A.M). Në kontratë cilësohet se vlera e shitjes është likuiduar tërësisht nga ana e blerësit, sipas kontratës së lidhur ndërmjet palëve. Edhe në këtë rast, blerësi E.M nuk ka paguar për llogari të shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k. çmimin e apartamentit, por çmimi i është paguar tim vëllai (A.M) ndër vite. Për më tepër, një rast identik me apartamentin e blerë nga ana ime në datën 25.1.2016 nga “****” sh.p.k. është edhe rasti i apartamentit të shitur nga shoqëria “****” sh.p.k. tek familja e motrës tonë V.H, me nr. *** dhe nr. pasurie ***, i ndodhur në Tiranë, hyrja ***, apartamenti ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***. Ky apartament është porositur fillimisht me kontratën e porosisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.11.2016, lidhur midis investitorit/sipërmarrës “****” sh.p.k. dhe porositësit, shoqërisë “****” sh.p.k., me objekt porositjen e 2 apartamenteve (me nr. *** dhe nr. ***) dhe 2 post parkimeve (me nr. *** dhe nr. ***), për të cilat gjithashtu mënyra e pagesës është cilësuar sipas punës që do të kryente shoqëria “****” sh.p.k... Ndërsa apartamenti i dytë (***), referuar deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.5.2021, nënshkruar nga deklaruesit: shoqëria “****” sh.p.k., shoqëria “****” sh.p.k. dhe*

⁴⁷ Nr.***, datë 10.3.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

shtetasit Ç.H dhe V.H, është përcaktuar se të drejtat mbi këtë apartament do të kalonin me lidhjen e kontratës përfundimtare të shitjes drejtpërdrejt tek shtetasit Ç. dhe V.H. Në atë deklaratë noteriale është cilësuar se: “Për shkak të lidhjes familjare të tyre dhe për shkak se pala Ç.H dhe V.H i kanë dhënë në formë huaje në mënyrë të herëpashershme vlera monetare më përpara në kohë, të cilat arrijnë vlerën e këtij apartamenti prej 62.920 euro, palët kanë vendosur që të shlyejnë këtë detyrim ndaj njëra-tjetrës, duke i kaluar palës Ç.H dhe V.H të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin si pasojë e posedimit ligjor, si dhe lidhjes së kontratës së shitjes me firmën e ndërtimit”. Me kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.4.2022, rezulton se, në përputhje me sa ishte deklaruar me deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.5.2021, shitja përfundimtare e këtij apartamenti është bërë drejtpërdrejt nga shoqëria ndërtuese “****” sh.p.k. tek blerësit Ç. dhe V.H, duke u cilësuar në nenin 2, i emërtuar “Çmimi i shitjes dhe mënyra e pagesës”, se: “Palët kanë rënë dakord që vlera e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme – apartament është 62.920 euro, vlerë e cila është likuiduar tërësisht sipas deklaratës noteriale të palëve me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.5.2021”... Edhe në rastin tim dhe blerjes së apartamentit nga “****” sh.p.k. në datën 25.1.2016, është vepruar në të njëjtën mënyrë si dhe rastet e detajuara më lart. Konkretisht, në datën 10.4.2011 është lidhur kontrata e sipërmarrjes midis A.M si person fizik dhe shoqërisë “****” sh.p.k. me objekt realizimin e punimeve ndërtimore me çmimet sipas zërave të punimeve, me një vlerë totale prej 78.775 euro (çmim i cili ka përfaqësuar çmimin e shitjes së apartamentit dhe garazheve të blera nga ana ime në datën 25.1.2016). Sipas nenit 4 të asaj kontrate sipërmarrjeje, palët janë dakordësuar se likuidimi i vlerës së kontratës do të kryhej në 100% të vlerës me klering dhe sipërfaqe ndërtimore apartament dhe post parkimi (apartament duplex, me sipërfaqe fizike 147.7 m² dhe post parkimi me sipërfaqe 33.2 m²), të ndodhura në rezidencën “****”, Tiranë. Këto ambiente të kontraktuara nga im vëlla A.M dhe të shlyera nga ana e tij nëpërmjet kleringut janë blerë më pas nga ana ime me kontratën e shitjes me “****” sh.p.k., në datën 25.1.2016 të apartamentit të banimit dhe garazhit në rrugën “****”, kundrejt vlerës prej 78.775 euro, me të cilin veprim është kthyer përfundimisht huaja prej 10.000.000 lekësh e marrë nga im vëlla në vitet 2009 - 2010 dhe 2015. Rezulton se më pas shoqëria “****” sh.p.k. dhe im vëlla, personi fizik “A.M”, kanë deklaruar edhe përfundimin e raportit, duke mos ekzistuar më detyrime ndaj njëri-tjetrit”.

21.13.iii Për të provuar këtë deklaram subjekti ka depozituar kontratën e porosisë datë 10.4.2011, nënshkruar midis vëllait të subjektit të rivlerësimit, z. A.M, si person fizik, dhe shoqërisë ndërtimore “****” sh.p.k., si dhe kontrata të tjera të lidhura mes shoqërisë “****” sh.p.k., shoqërisë “****” sh.p.k., etj.

21.14 Lidhur me këtë çështje, Komisioni konstatoi faktet si vijon:

21.14.i Nga verifikimi i kontratës së sipërmarrjes datë 10.4.2011, rezultoi se në nenin 1 të saj është parashikuar kryerja e punimeve nga personi fizik “A.M”.

21.14.ii Në nenin 2 të po kësaj kontrate është parashikuar se punimet e kryera janë përllogaritur në shumën 78.755 euro, duke u specifikuar edhe zërat e tyre.

21.14.iii Kontrata ka të parashikuar se likuidimi i shumës do të kryhet 100% me klering, me sipërfaqe ndërtimore apartament duplex nr. ***, me sip. 147,7 m² dhe sipërfaqe të përbashkët 9.2 m², ndodhur në rezidencën “****”, S, si dhe post parkim nr. ***, me sip. 33.2 m², ndodhur në të njëjtën adresë.

21.14.iv Subjekti ka deklaruar se në këtë pasuri prej vitit 2012⁴⁸ ka jetuar motra e tij me bashkëshortin dhe prindërit, gjithashtu dhe më tej, pasi ata kanë vendosur se nuk do ta blinin këtë pasuri, e ka blerë ai vetë.

⁴⁸ Ka depozituar marrëveshjen datë 18.5.2012, nënshkruar midis shoqërisë administruese të godinës dhe motrës së subjektit të rivlerësimit, znj. V.H, si dhe fatura të pagesave për shërbime administrative të komunitetit.

21.14.v Subjekti i rivlerësimit, në DPV-në e vitit 2016, në rubrikën e të dhënave konfidenciale, ka deklaruar se *shuma e kthyer 10.000.000 lekë në tetor të vitit 2016 është përdorur për blerjen e apartamentit.*

21.14.vi Me deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.1.2017, të lëshuar nga vëllai i subjektit, shtetasi A.M deklaroi se shumën totale prej 10.000.000 lekësh ia ka kthyer vëllait të tij Sokol Malaj në janar të vitit 2016.

21.14.vii Në përmbajtje të deklaratës noteriale nuk konfirmohet se shuma është marrë si rezultat i kleringut të arritur me kompaninë “****” sh.p.k.

21.14.viii Në përmbajtje të kontratës së shitjes nr. *** rep., *** kol., datë 25.1.2016, për këtë pasuri nënshkruar midis subjektit të rivlerësimit dhe kompanisë “****” sh.p.k. nuk referohet asnjë e dhënë që konfirmon veprime të shlyerjes mes palëve kontraktore të sipërmarrjes, datë 10.4.2011.

21.14.ix Lidhur me shlyerjen e pagesës së kësaj pasurie, subjekti deklaroi se e ka shlyer të gjithë shumën në llogarinë e noterit përmes transaksionit bankar dhe për të provuar këtë fakt ka depozituar dokumentin bankar që pasqyron transaksionin përkatës.

21.14.x Subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë deklaruar në asnjë rast marrëdhënien e kleringut të vëllait të tij A.M si person fizik me shoqërinë ndërtimore “****” sh.p.k., për pasurinë objekt hetimi administrativ.

21.14.xi Me deklaratën datë 26.1.2016, për mbyllje raporti kontraktual sipas kontratës së sipërmarrjes datë 10.4.2011, është shprehur vullneti i palëve, përkatësisht vëllait të subjektit si person fizik dhe shoqërisë ndërtimore, për ta mbyllur raportin kontraktual që ata kanë pasur.

21.14.xii Dokumenti është përmbyllur një ditë pas nënshkrimit të kontratës së shitjes së pasurisë objekt hetimi, nënshkruar midis subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë ndërtimore “****” sh.p.k.

21.14.xiii Dokumenti nuk konfirmon ndonjë të dhënë për kalimin e të drejtave tek subjekti i rivlerësimit me lidhjen e kontratës përfundimtare të shitjes drejtpërdrejt tek ai, sikurse subjekti deklaroi se edhe në rastin e tij të blerjes së apartamentit nga “****” sh.p.k. në datën 25.1.2016, është vepruar në të njëjtën mënyrë si dhe rastet e detajuara më lart apo ndonjë deklaram të mundshëm paraprak për shlyerje mes palëve të kontratës së sipërmarrjes datë 10.4.2011.

21.15 Komisioni, bazuar në faktet e dala për këtë pasuri, i kaloi barrën e provës subjektit, pasi konstatoi se: (i) dukej se ka mospërputhje në deklaramet e subjektit në DPV-në e vitit 2016, se huaja është shlyer në tetor të vitit 2016, ndërsa në deklaratën noteriale huamarrësi ka deklaruar kthimin e saj në janar të vitit 2016; (ii) nuk provohet përfitimi i kësaj pasurie në kushtet e kleringut, për sa kohë pagesa e çmimit të saj është kryer me transaksion bankar në llogari të noterit; (iii) nuk provohej kthimi i shumës 10.000.000 lekë nga huamarrësi A.M te subjekti i rivlerësimit; (iv) nuk provohej burimi i ligjshëm i shumës 10.000.000 lekë i kthyer subjektit të rivlerësimit në janar të vitit 2016, deklaruar nga ky i fundit se ishte marrë hua në vitet 2010 dhe 2015 – për rrjedhojë duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare në shumën 4.898.521 lekë (6.000.000 lekë gjendja *cash* – 10.898.521 lekë vlera e pasurisë) të investojë në blerjen e këtyre pasurive.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

21.16 Subjekti në qëndrimin e tij ka parashtruar të njëjtat rrethana sikurse janë përshkruar në pikën 21.13.ii të këtij vendimi, duke kërkuar vlerësimin e rrethanave të faktit për kualifikimin e vëllait të tij si person tjetër i lidhur me subjektin, në kuptim të përcaktimit të parashikuar nga neni 3, pika 14 dhe neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

21.17 Subjekti ka ritheksuar se në kuadër të barrës se provës, kjo mënyrë e ndërtimit të marrëdhënieve të kleringut midis vëllait të tij dhe disa shoqërive ndërtuese, nëpërmjet përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore kundrejt punimeve të kryera (marrëdhënie kleringu), rezulton e pasqyruar në kontrata të shtrira në kohë dhe të ekzekutuara për mbi 10 ambiente, njësi, apartamente banimi dhe garazhe, të cilat ka arritur t'i sigurojë dhe i ka dërguar pranë Komisionit, duke ezauruar plotësisht barrën e provës në kuadër të pasjes së mundësisë së huamarrësit për gjendjen *cash* në janar të vitit 2016 dhe shlyerjen prej tij të kësaj huaje, duke i kthyer shumën përkatëse.

21.18 Sipas subjektit rezulton e provuar me akt zyrtar të kohës dhe jo të kryer gjatë procesit të rivlerësimit që në janar të vitit 2016 ka marrë nga vëllai i tij huan në shumën 10.000.000 lekë, e cila është produkt i marrëdhënies së kleringut gjatë ushtrimit të aktivitetit tregtar, duke plotësuar në këtë mënyrë detyrimin ligjor të parashikuar nga neni 32/4 i ligjit nr. 84/2016. Ka parashtruar se këto subjekte tregtare që realizojnë kryerjen e pagesave dhe shërbimeve apo punimeve të tyre me klering, në ushtrimin e aktivitetit të tyre të përditshëm kanë kosto të përditshme në trajtën e shpenzimeve për materiale, pagesa punonjësish e shërbimesh për të cilat për efekt të shlyerjes së tyre të përditshme mbajnë vazhdimisht gjendje *cash*, të cilat administrohen nga personat fizikë që janë pronarë apo administratorë të personave juridikë, me qëllim përdorimin sa më të zhdërvjellët për efekt të shpenzimeve të çastit gjatë aktivitetit dhe shpesh nuk janë në llogarinë bankare të subjekteve persona juridikë.

Lidhur me shlyerjen e çmimit të kësaj pasurie nga shoqëria tek vëllai i subjektit, sikurse ishte parashikuar në marrëveshjen e kleringut, subjekti në seancë dëgjimore ka shpjeguar se vëllai i tij ka marrë të njëjtën shumë mbrapsht, formalizim ky sipas kërkesës së shoqërisë.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

21.19 Trupi gjykues, në analizë të pretendimeve të subjektit, në raport me faktet e konstatuara, në çështjen objekt vlerësimi arsyeton si vijon:

21.20 Në drejtim të pretendimeve të subjektit, për vlerësimin e rrethanave të faktit për kualifikimin e vëllait të tij si person tjetër i lidhur me subjektin, në kuptim të përcaktimit të parashikuar nga neni 3, pika 14 dhe neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues evidenton rrethanat faktiko-ligjore të kësaj çështjeje. Rezulton se përgjatë hetimit subjekti ka deklaruar se kjo pasuri është blerë me të ardhurat e realizuara nga biznesi “klinikë dentare” në pronësi të bashkëshortes, për të cilat Komisioni nuk konstatoi ndonjë problematikë sa i takon ligjshmërisë së tyre, porse ky burim i deklaruar nuk rezultoi të jetë burimi konkret i blerjes së kësaj pasurie. Në këtë drejtim, Komisioni ka konstatuar se të ardhurat e biznesit të bashkëshortes janë deklaruar si kursime pothuajse në çdo vit të deklarimit të tij periodik vjetor, të cilat janë përdorur nga subjekti për investime në pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme në vitet 2015 dhe 2016, sikurse ka rezultuar se shuma prej 10.000.000 lekësh i është dhënë hua vëllait të tij. Nën këto rrethana, Komisioni gjatë hetimit konstatoi se burimi fundor dhe real i krijimit të kësaj pasurie është kthimi i huas në shumën 10.000.000 lekë, e cila është përdorur për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi.

21.21 Trupi gjykues vlerëson se në çështjen në fjalë ekzistojnë rrethana faktiko-ligjore që e lidhin subjektin kundrejt interesit pasuror në këtë pasuri, pasi rezulton se kundrejt kësaj marrëdhënieje të vëllait deklarohet burimi konkret i krijimit të kësaj pasurie dhe, për rrjedhojë, është përfituar pronësia e subjektit në këtë pasuri. Referimi i subjektit në vendimin e shkurtuar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 2/2023, paragrafi 17.13, vlerësohet nga trupi gjykues pa relevancë në rrethanat specifike të kësaj çështjeje.

21.22 Për sa më sipërsarsyetuar, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 - 32 të ligjit nr. 84/2016, ka detyrimin ligjor për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të kësaj pasurie, pasi në rrethanat faktike dhe konkrete vlerëson se

provohet përfshirja e drejtpërdrejtë e subjektit të rivlerësimit në krijimin e pasurisë apartament, me qëllim vlerësimin e besueshmërisë së saj në raport me procesin e rivlerësimit.

21.23 Në këtë drejtim, sikurse rezultoi nga hetimi i kryer, burimi i krijimit të pasurisë ishte shuma 10.000.000 lekë e kthyer nga vëllai i subjektit A.M, marrë si hua për ushtrim të aktivitetit të tij.

Në lidhje me deklarinimin e shlyerjes së kësaj shume, trupi gjykues gjatë hetimit konstatoi se subjekti ka deklaruar se vëllai i tij A.M, shumën totale prej 10.000.000 lekësh ia ka kthyer në janar të vitit 2016.

21.24 Trupi gjykues, deklarinimin e subjektit në deklaratën e vitit 2016 se huaja është shlyer nga i vëllai i tij në tetor të atij viti, e konsideron një pasaktësi që nuk merr peshë në vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit.

21.25 Duke u nisur nga kjo deklaratë noteriale dhe deklarimi i subjektit në seancë dëgjimore se shumën 10.000.000 lekë e ka marrë cash dy ose tri ditë përpara lidhjes së kontratës, identifikohet fakti se vëllai i subjektit ka operuar në “të holla” me subjektin në kthimin e huas.

21.26 Po ashtu, subjekti ka deklaruar se kthimi i huas është realizuar dhe ka shërbyer për formalizimin e kontratës së shitjes me “****” sh.p.k., në datën 25.1.2016, të apartamentit të banimit dhe garazhit në rrugën “****”, kundrejt vlerës 78.775 euro.

21.27 Subjekti ka deklaruar se pas pagimit të vlerës prej 78.775 euro, shoqëria “****” sh.p.k. dhe i vëllai kanë deklaruar shlyerjen dhe zerimin e detyrimeve ndaj njëri-tjetrit.

21.28 Trupi gjykues vlerëson se në interpretimin logjik të këtij deklarimi kuptohet se zerimi dhe shlyerja e detyrimeve ndaj shoqërisë ka pasur si parakusht pagimin e shumë 78.775 euro, ndërkohë që nga shoqëria ndërtimore kjo pasuri i jepej vëllait të subjektit, për shkak të punimeve që ai do të kryente. Përderisa kjo pasuri posedohej dhe përdorej nga vëllai i subjektit të rivlerësimit prej vitit 2012 dhe për sa kohë nuk u kundërshtua ndonjëherë moskryerja e punimeve të cilësuar nga shoqëria ndërtimore në kontratën e kleringut për këtë pasuri, atëherë marrëdhënia e krijuar duket të jetë shuar dhe arsyeja e pagesës edhe një herë e së njëjtës shumë nga subjekti mbetet një situatë/rrethanë e paqartë.

21.29 Në këto kushte, derdhja e kësaj shume në llogarinë e noterit, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 32/4 të ligjit nr. 84/2016, sikurse u citua edhe më sipër, i nënshtrohet provueshmërisë së burimit të krijimit të saj, për të cilën subjekti ka deklaruar pikërisht huan e kthyer në shumën 10.000.000 lekë.

21.30 Për të provuar mundësinë e krijimit të shumës 10.000.000 lekë, subjekti ka shpjeguar historikun e aktivitetit të shoqërisë së krijuar prej vëllait të tij prej vitit 2011, kryesisht ndërtuar mbi bazë kleringu, pas të cilëve ai ka pretenduar se janë gjeneruar të ardhura ndër vite, duke depozituar disa kontrata.

21.31 Trupi gjykues, në analizë të këtyre kontratave, konstatoi se nuk provohet të jenë gjeneruar të ardhura në favor të vëllait të subjektit ose në disa prej tyre ai nuk rezulton të jetë palë kontraktore. Më konkretisht:

i. Në kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 2.7.2012, nënshkruar midis investitorit, shoqëria “****” sh.p.k., dhe vëllait të subjektit, z. A.M, është rënë dakord (*shihni nenin 2 të kontratës*) që këtij të fundit do t’i kalojë në pronësi apartamenti nr. ***, me sip. 124.6 m², në momentin që do të shlyejë me punë në bazë të kontratës që ka midis shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shoqërisë “****” sh.p.k. Vlera e këtij apartamenti në total është 74.760 euro. Nga të dhënat e administruara konstatohet se nuk konfirmohet gjenerim të ardhurash.

ii. Referuar kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 28.10.2015, nënshkruar midis kësaj shoqërie ndërtimore dhe shtetasit E.M rezulton e blerë dhe likuiduar plotësisht nga z. M një pasuri në shumën 6.618.000 lekë.

Rezultoni se kontrata nuk pasqyron si palë vëllain e subjektit të rivlerësimit apo shoqërinë e tij dhe, për pasojë, nuk konfirmon ndonjë të dhënë për ta identifikuar atë si përfitues në këto të ardhura.

iii. Referuar kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 5.10.2015, nënshkruar mes shitësit “****” sh.p.k., me NIPT ***, porositësit, shoqëria “****” sh.a., si dhe personit që është në dijeni dhe jep pëlqimin, shoqëria investitore “****” sh.p.k., për apartamentin në vlerën 84.330 euro, përveçse nuk konfirmohet ndonjë vlerë e përfituar në favor të shoqërisë “****” sh.p.k. (*shihni nenin 2 të kësaj kontrate*), por edhe nëse kjo ka ndodhur, trupi gjykues konstaton se nga të dhënat zyrtare të administruara nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, sikurse pasqyrohet më sipër në tabelën nr. 1, qarkullimi dhe fitimi i aktivitetit të shoqërisë është në vlera minimaliste, çka nuk pasqyron përfitimin e kësaj shume prej shoqërisë “****” sh.p.k. në qarkullimin e viteve 2013, 2014 apo 2015.

iv. Referuar kontratës nr. ***, datë 8.2.2014, nënshkruar midis shtetasit A.P/përfaqësues dhe administratori i shoqërisë “****” sh.p.k., dhe znj. A.M, premtohet nga shoqëria në favor të znj. M. një ambient tregtar në vlerën 256.800 euro, vlerë e cila theksohet se do të paguhet në dy këste. Po në këtë kontratë cilësohet se kësti i parë prej 128.400 euro do të likuidohet nëpërmjet bankës në datën 10.2.2014, veprim ky i konfirmuar me mandatin e BKT-së, datë 10.2.2014, ndërsa për këstin e dytë thuhet në kontratë se ai do të likuidohet nëpërmjet kleringut, reflektuar në mandate të pranuar nga të dyja palët dhe se likuidimi i shumës do të bëhet gradualisht deri në dorëzimin e ambientit. Referuar deklaratës noteriale datë 8.5.2020, shoqëria “****” sh.p.k. dhe shtetasit A. dhe P.M kanë deklaruar reciprokisht mënyrën e shlyerjes së detyrimeve. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se për këtë pasuri në datën 15.5.2020 (*shihni shkresën nr. 33 prot.*⁴⁹) shoqëria “****” sh.p.k. i është drejtuar noterit publik, duke dhënë miratimin me shkrim për vijimin e nënshkrimit të kontratës së shitjes, duke deklaruar se pala blerëse e ka likuiduar paraprakisht të gjithë çmimin e shitjes së pasurisë së paluajtshme private, *të llojit “njësi”, ...në shumën 256.800 euro...* Po nga dokumentacioni i administruar rezultoi se kontrata e shitjes është nënshkruar në datën 15.5.2020. Dokumentacioni ka të administruar edhe certifikatën për vërtetim pronësie për këtë pasuri, lëshuar në emër të shoqërisë ndërtimore “****” sh.p.k. në datën 25.5.2018.

Edhe për këtë kontratë, trupi gjykues konstaton se në analizë të të dhënave të pasqyruara nuk u provua marrja e këstit të dytë përpara datës 26.1.2016 (kohë kur nga subjekti u shpenzua shuma 78.775 euro për blerjen e pasurisë nga shoqëria “****” sh.p.k.) nga shoqëria “****” sh.p.k. si rrjedhojë e punimeve të kryera, sikurse citohej në kontratën nr. ***, datë 8.2.2014. Dokumentacioni për këtë çështje pasqyron faktin se minimalisht kontrata e shitblerjes së pasurisë në favor të shtetasve M. do të ishte lidhur që në vitin 2018, kohë kur pasuria ishte regjistruar në emër të shoqërisë “****” sh.p.k., gjithnjë nëse shuma e plotë e këstit të dytë do të ishte shlyer. Por, në fakt, veprimet e kryera në vitin 2020 duket se rakordojnë edhe me shlyerjet përfundimtare të palëve mes njëra-tjetrës. Pra në të gjithë variantet e mundshme, në asnjë rast nuk konfirmohen të ardhura të siguruara nga këto kontrata në favor të shoqërisë “****” sh.p.k. përpara lidhjes së kontratës së subjektit me shoqërinë “****” sh.p.k.

21.32 Po duke iu referuar marrëdhënieve kontraktore në raport me krijimin e të ardhurave, të dhënat zyrtare të administruara nga zyra tatimore konfirmojnë se aktiviteti i vëllait, të paktën deri në krijimin e pasurisë nga subjekti i rivlerësimit, ka pasur një qarkullim për vitet 2011 – 2015 në vlera të tilla, të cilat për asnjë vit nuk pasqyrojnë të jetë përfituar ndonjë shumë prej kontratave të shitjes të cituara prej subjektit. Gjithashtu, fitimi i realizuar rezulton se ka qenë në vlera të pakonsiderueshme, duke marrë këtu në konsideratë faktin që për vitin 2012 ka rezultuar me humbje dhe fitimi i viteve të mëpasshme ka qenë në vlera të ulëta, aq sa për të mbuluar humbjen e vitit 2012.

⁴⁹ Dokumentacioni i depozituar nga subjekti i rivlerësimit me pyetësorin nr. 4, datë 10.3.2023.

- Në të tilla kushte e rrethana, trupi gjykues konstaton se nuk u provua mundësia e krijimit të shumës 10.000.000 lekë për t'i shlyer huan subjektit.

21.33 Nga ana tjetër, duke qëndruar në situatën e marrëdhënies së kleringut të krijuar nga vëllai i subjekti si person fizik me shoqërinë ndërtimore “****” sh.p.k., parashikohej se ky apartament pas punimeve të përshkuara në kontratë do të kalonte në favor të vëllait të subjektit të rivlerësimit. Pra, në një logjikë të thjeshtë interpretimi, zinxhiri i pashmangshëm i transferimit të pasurisë për llogari të subjektit të rivlerësimit, në këmbim të huas që ky i fundit i kishte dhënë të vëllait, do të ishte transferimi i pasurisë te subjekti, nën pëlqimin edhe të shoqërisë ndërtimore, pa u kryer të tjera pagesa nga subjekti i rivlerësimit, sikurse ka ndodhur. Kjo logjikë arsyetimi mbështetet edhe në vetë provat e depozituara nga subjekti, sikurse ka ndodhur në rastin e huas së marrë nga vëllai i subjektit, z. A.M, motrës së tij V.H, në shumën 62.920 euro, rast të cilin në fakt subjekti e trajton si identik me situatën e tij në përfitim të pasurisë. Referuar kontratës së shitjes së pasurisë, nr. *** rep., nr. ***, datë 20.4.2022, midis shoqërisë “****” sh.p.k. dhe bashkëshortëve H, rasti nuk përkon me situatën e subjektit të rivlerësimit, pasi në kontratë, në nenin 2 të saj, cilësohet se pasuria përfitohet në këmbim të shlyerjes së huas që shtetasi A.M kishte ndaj motrës dhe bashkëshortit të saj, ndërsa në kontratën e shitjes së subjektit të rivlerësimit jo vetëm një cilësim i tillë nuk ekziston, por përmbyllja e detyrimeve, sikurse u citua edhe më sipër, ka ardhur vetëm pas pagesës së shumës 78.775 euro.

21.34 Edhe në një vlerësim të përgjithshëm të marrëdhënies së kleringut në raport me pozitën e vëllait të subjektit në të, trupi gjykues konstatoi se ky i fundit ka paraqitur në prapësime dy variante të ndryshme në lidhje me kthimin e huas.

Konkretisht, ai ka deklaruar në mbrojtjen e tij se: *“Që në vitin 2015 isha dakordësuar me vëllain tim për të blerë apartamentin në fjalë, duke qenë se gjatë kësaj periudhe deri në fillim të janarit 2016 vëllai im A.M ka mundur të më shlyejë shumën prej 10.000.000 lekësh, kam vendosur të bëj blerjen e këtij apartamenti drejtpërdrejt nga pronari, shoqëria “****”.*

...Në vitin 2016 unë kam dashur ta marr në pronësi këtë apartament dhe duke qenë se im vëlla më kishte një hua në shumën 10.000.000 lekë, unë kam menduar që të shlyhem në këtë formë, pra duke përfutur këtë apartament në vend të shumës së parave që huamarrësi më kishte marrë hua”.

21.35 Në analizë të deklarimeve të subjektit, trupi gjykues konstaton se në çdo variant të pretenduar, duke qëndruar edhe sa më afër pretendimeve të subjektit, në asnjë prej tyre nuk duket se përmbysen barra e provës. Nëse i qëndrojmë faktit se shuma u kthye *cash* në janar të vitit 2016, rezulton se të ardhurat e përfuturara nga shoqëria “****” sh.p.k. janë të pamjaftueshme për të plotësuar shumën 10.000.000 lekë. Gjithashtu, edhe për aktivitetin e vëllait A.M si person fizik, nuk u konfirmuan të ardhura nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, për më tepër që rezulton pasiv prej vitit 2014, si dhe me detyrime të papaguara.

21.36 Nga ana tjetër, trupi gjykues vlerëson se deklarimi i subjektit në seancën dëgjimore që shoqëria “****” sh.p.k. ia ktheu shumën vëllait, pasi subjekti pagoi vlerën e apartamentit, mbetet thjesht në nivel deklarativ prej tij, pasi nuk u provua me asnjë dokument. Subjekti nuk ndërmori asnjë hap, nuk bëri asnjë përpjekje gjatë këtij procesi, për të vërtetuar minimalisht të ardhurat e përfuturara nga një kontratë shitjeje apo kthimin e shumës nga shoqëria “****” sh.p.k., në një kohë që veprimet janë kryer në vite në të cilat ekonomia është e formalizuar dhe pothuajse të gjitha veprimet nga kompanitë e ndërtimit përmbillen nëpërmjet sistemit bankar apo noterit publik.

21.37 Në përfundim për këtë pasuri, trupi gjykues arrin në konkluzion se subjekti ka paraqitur në mënyrë të pasaktë marrëdhënien e interesit pasuror me vëllain e tij. Në analizë të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit të cilat rezultuan kontradiktore, si dhe provave të administruara, trupi gjykues konstatoi se

subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultatit, pasi nuk shpjegoi bindshëm burimin e krijimit të kësaj pasurie dhe, për pasojë, rezultoi në pamjaftueshmëri financiare në shumën 4.898.521 lekë për blerjen e saj dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera.

21.38 Në lidhje me likuidimin e kësaj pasurie

21.38.i Nga verifikimi i kontratës së shitjes⁵⁰ konstatohet se në nenin 2 të saj është përcaktuar çmimi i shitjes së tre pasurive (dy apartamenteve dhe një garazh), në total në vlerën 78.775 euro, çmim i cili do të likuidohet nga blerësi në llogarinë bankare Escrow të noteres.

21.38.ii Lidhur me pagesën e këtyre pasurive, Komisioni ka pyetur⁵¹ subjektin, i cili ka deklaruar se kjo pagesë është derdhur nëpërmjet llogarisë së “Raiffeisen Bank” dhe për të provuar këtë fakt ka depozituar pagesën e kryer në shumën 78.775 euro në llogarinë e noteres N.GJ, person fizik, në “Raiffeisen Bank”, në datën 25.1.2016.

21.38.iii Sipas kontratës së shitblerjes së pasurive, si dhe transaksionit bankar të verifikuar, rezultoi se shuma ka kaluar nga llogaria e noterit sipas legjislacionit në fuqi.

21.39 Komisioni hetoi në lidhje me ndonjë trajtim të mundshëm preferencial në përfitim të këtyre pasurive. Komisioni i është referuar udhëzimit nr. 4, datë 30.9.2015, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2015”, pasi pasuria është blerë në janar të vitit 2016. Sipas këtij udhëzimi rezultoi se kostoja e shitjes në tregun e lirë të apartamenteve në qytetin e Tiranës, në zonën 6 ku ndodhen pasuritë, është 65.000 lekë/m² sipërfaqe e shfrytëzueshme. Apartamentet e blera nga subjekti i rivlerësimit janë në total me sip. 147.7 m², pra 96 m² + 51.7 m². Duke u bazuar në çmimet referuese, rezultoi se vlera e apartamenteve është 9.600.500 lekë (147.7 m² x 65.000 lekë). Kjo vlerë është më e lartë nga çmimi që ka paguar subjekti, pasi apartamentet janë blerë në vlerën totale 9.416.101 lekë⁵². Pra, rezultoi se kjo pasuri është blerë 184.399 lekë (9.600.500 – 9.416.101) më lirë nga çmimet e tregut.

21.39.1 Ndërsa lidhur me çmimin e garazhit, Komisioni është bazuar në udhëzimin nr. 9, datë 26.2.2008, “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pasurisë së paluajtshme”, i ndryshuar (MF dhe MD), ku në pikën 5/b përcaktohet se çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për garazh të mbuluar është 70% e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas zonave të Tiranës. Pra, rezultoi se çmimi referues është 45.500 lekë/m² (70% e çmimit 65.000 lekë/m² sipas zonës 6). Garazhi është me sip. 33.2 m² dhe vlera e tij sipas çmimeve referuese është 1.510.600 lekë. Kjo vlerë është më e lartë nga çmimi që ka paguar subjekti, pasi garazhi është blerë në vlerën 1.482.420 lekë⁵³. Pra, rezultoi se garazhi është blerë 28.180 lekë (1.510.600 – 1.482.420) më lirë nga çmimet e tregut.

21.39.2 Pra, në total për këto pasuri, rezultoi se janë blerë nga subjekti i rivlerësimit 212.579 lekë më lirë sesa çmimi referues i tregut.

21.40 Komisioni, për këto pasuri, iu drejtua edhe shoqërisë “***” sh.p.k., e cila ka depozituar⁵⁴ kontrata të ngjashme me të tjerë shtetas, thujse për të njëjtën sipërfaqe dhe nënshkruar në të njëjtën kohë, nga ku rezultoi se çmimet referuese të shitjes janë të ngjashme me shumën që ka investuar subjekti i rivlerësimit.

⁵⁰ Aneks nr. 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵¹ Pyetësor nr. 3, datë 20.2.2023.

⁵² Vlera 68.060 euro e konvertuar me kursin mesatar sipas Bankës së Shqipërisë për muajin janar 2016.

⁵³ Vlera 10.715 euro e konvertuar me kursin mesatar sipas Bankës së Shqipërisë për muajin janar 2016.

⁵⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 9.3.2023.

21.41 Komisioni hetoi në lidhje me gjendjen e ndonjë konflikti të mundshëm të interesit midis subjektit të rivlerësimit për shkak të detyrës së tij dhe shoqërisë ndërtimore, bashkërisht edhe me përfaqësuesit e saj. Në përgjigjet e ardhura⁵⁵ nuk konfirmohen procese hetimore të mosfilluara, pushuara apo të kërkuara për gjykim në adresë të shoqërisë apo përfaqësuesve të saj, apo të iniciuara prej tyre.

22. Apartament banimi me nr. pasurie *, me sipërfaqe 176 m², me vlerë 13.733.000 lekë, si dhe 2 garazhe me nr. pasurie ***, me sipërfaqe 25 m² dhe nr. pasurie ***, me sipërfaqe 25 m², me vlerë 2.257.500 lekë, me adresë rruga “****”, pallati “****”, Selitë.** Blerë me kontratën nr. *** rep., *** kol., datë 7.10.2016. Burimi i krijimit: 6.000.000 lekë kredi nga “Credins Bank”, e mbyllur në datën 27.12.2016, pas maturimit të depozitës që ndodhet pranë kësaj banke, si dhe pjesërisht nga të ardhura të realizuara nga biznesi “****”, në pronësi të bashkëshortes A.M dhe pjesërisht fitimi i realizuar nga dividendi si ortak në shoqërinë “****” sh.p.k. Vlera: 15.990.500 lekë. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën dokumentacionin mbështetës.

Hetimi i Komisionit

22.1 Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar për herë të parë pasurinë apartament banimi dhe dy garazhe në DPV-në e vitit 2016. Nga verifikimi i DPV-së së vitit 2016 rezultoi se subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar këto pasuri me të njëjtin përshkrim si edhe në deklaratën për *Vetting*.

22.2 Nga hetimi i kryer rezultoi se ZQRPP-ja⁵⁶ ka bashkëlidhur përgjigjen e ZVRPP-së Tiranë, e cila konfirmon në emër të z. Sokol Malaj pasuritë: nr. ***, e llojit “apartament”, me sip. 176 m², z k. ***; nr. ***, e llojit “garazh”, me sip. 25 m², z. k. ***; nr. ***, e llojit “garazh”, me sip. 25 m², z. k. ***.

22.3 Praktika e ZVRPP-së⁵⁷ ka të bashkëlidhur: (i) kartelat e pasurive të paluajtshme dhe certifikatat e pronësisë së apartamentit dhe garazheve, regjistruar në emër të shtetasit F.V; (ii) pasqyrën llogaritëse të tatimit për kalimin e së drejtës së pronësisë; (iii) kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.10.2016, nënshkruar ndërmjet palës shitëse F.V e A.V dhe palës blerëse Sokol Malaj, të pasurive apartament me sip. 176 m² dhe dy garazhe me sipërfaqe secili prej 25 m², kundrejt shumës 13.733.000 lekë për apartamentin dhe 1.128.750 lekë për secilin garazh; (iv) mandatin e xhirit bankar pranë “Credins Bank”, datë 7.10.2016, të shumës 13.990.500 lekë, nga llogaria e subjektit në favor të llogarisë së “****”, person fizik; si dhe (v) deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.10.2016.

22.4 Nga dokumentacioni i administruar⁵⁸ vërehet se DPPP-ja⁵⁹ konfirmon se z. Sokol Malaj, në datën 7.10.2015, i ka blerë pasuri të paluajtshme, me çmim të deklaruar 15.990.500 lekë, shtetasit F.V, i datëlindjes 18.9.1966, si dhe në datën 6.10.2016 ka nënshkruar deklaratën noteriale si blerës i ardhshëm me çmim të deklaruar 2.000.000 lekë, këtë me shtetas.

22.5 Nga hetimi i Komisionit⁶⁰ mbi dokumentacionin e analizuar, konfirmohet blerja e tri pasurive me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.10.2016, nënshkruar ndërmjet palës shitëse F.V e A.V dhe palës blerëse Sokol Malaj, më konkretisht:

⁵⁵ Sipas shkresës nr. *** prot., datë 13.1.2023, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier; shkresës nr. *** prot., datë 13.1.2023, të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; shkresës nr. *** prot., datë 11.1.2023, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë; shkresës nr. *** prot., datë 13.1.2023, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë; shkresës nr. *** prot., datë 13.2.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; shkresës nr. *** prot., datë 16.2.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; shkresës nr. *** prot., datë 16.2.2023, të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, si dhe shkresës nr. *** prot., datë 16.2.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

⁵⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 19.4.2018, referojuni aneksit nr. 29 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵⁷ Referojuni aneksit nr. 29 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵⁸ Referuar aneksit nr. 45 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 11.5.2017, referojuni aneksit nr. 45 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶⁰ Referuar dokumentacionit të administruar në dosjen e ILDKPKI-së në aneksin nr. 4/5 të saj.

22.5.i Për pasurinë apartament banimi me sip. 176 m², ndodhur në S, Tiranë, z. k. ***, me nr. pasurie ***, kundrejt çmimit 13.733.000 lekë.

22.5.ii Për pasurinë garazh me sip. 25 m², ndodhur në S, Tiranë, z. k. ***, me nr. pasurie ***, kundrejt çmimit 1.128.750 lekë.

22.5.iii Për pasurinë garazh me sip. 25 m², ndodhur në S, Tiranë, z. k. ***, me nr. pasurie ***, kundrejt çmimit 1.128.750 lekë.

22.6 Referuar kontratës së shitblerjes së pasurive, konstatohet se palët kanë deklaruar se nga vlera e apartamentit prej 13.733.000 lekësh është likuiduar shuma 2.000.000 lekë, sipas deklaratës nr. *** rep., nr. *** kol., ndërsa diferenca prej 11.733.000 lekësh dhe vlerat e dy garazheve do të kalojnë nëpërmjet llogarisë së noterit pranë “Credins Bank”.

22.7 Nga dokumentacioni i administruar konfirmohen me certifikatat për vërtetim pronësie të njëjtit pasuri⁶¹ me ato të shitura në favor të shitësve F dhe A.V.

22.8 Sipas deklaratës noteriale nr.*** rep., nr. *** kol., datë 6.10.2016, konstatohet se deklaruesit F e A.V kanë deklaruar se janë dakord që pasurinë apartament, me nr. ***, me sip. 176 m², ta shesin në favor të shtetasit Sokol Malaj, i cili gjithashtu është dakordësuar ta blejë atë dhe ka dhënë paradhënie *cash* për blerjen e këtij apartamenti shumën 2.000.000 lekë, në datën 1.9.2016. Deklaruesit janë dakordësuar që ky apartament do t'i shitet z. Sokol Malaj në shumën totale 13.733.000 lekë, në momentin e shlyerjes së plotë të diferencës së detyrimit prej 11.733.000 lekësh, nëpërmjet llogarisë së noterit.

22.9 Sipas mandatxhimit bankar në “Credins Bank”, datë 7.10.2016, rezultoi se nga llogaria e z. Sokol Malaj ka kaluar në favor të llogarisë së noterit M.B, person fizik, shuma 13.990.500 lekë, sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 7.10.2016.

22.10 Pas tjetërsimit të pasurive janë lëshuar certifikatat përkatëse për vërtetim pronësie, në emër të subjektit të rivlerësimit, më konkretisht është lëshuar: (i) certifikatë për vërtetim pronësie, datë 14.10.2016, për pasurinë apartament, nr.***, me sip. 176 m², si dhe kartela e pasurisë e harta treguese e regjistrimit; (ii) certifikatë për vërtetim pronësie, datë 14.10.2016, e pasurisë garazh, nr. ***, me sip. 25 m² dhe kartela e pasurisë dhe harta treguese e regjistrimit; si dhe (iii) certifikatë për vërtetim pronësie, datë 14.10.2016, e pasurisë garazh, nr. ***, me sip. 25 m², si dhe kartela e pasurisë dhe harta treguese e regjistrimit.

22.11 Në lidhje me burimin e krijimit të këtyre pasurive

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe në DPV-në e vitit 2016 se burim krijimi për këto pasuri kanë shërbyer:

- a. shuma 6.000.000 lekë kredi në “Credins Bank”;
- b. pjesërisht të ardhurat e realizuara nga biznesi “****” në pronësi të bashkëshortes A.M;
- c. pjesërisht fitimi i realizuar nga dividendi si ortak në shoqërinë “****” sh.p.k.

Komisioni hetoi për secilin nga burimet e deklaruara nga ana e subjektit, që kanë shërbyer për likuidimin e kësaj pasurie.

⁶¹ Referuar certifikatës për vërtetim pronësie, datë 13.12.2013, si dhe kartelës së pasurisë, konfirmohet në emër të shtetasit F.V pasuria apartament, nr.***, me sip.176 m²; referuar certifikatës për vërtetim pronësie, datë 10.4.2015, si dhe kartelës së pasurisë, konfirmohet në emër të shtetasit F.V pasuria garazh, nr. ***, me sip. 25 m²; referuar certifikatës për vërtetim pronësie, datë 10.4.2015, si dhe kartelës së pasurisë, konfirmohet në emër të shtetasit F.V pasuria garazh, nr.***, me sip. 25 m².

22.11.1 Në lidhje me kredinë e marrë në “Credins Bank”, në shumën 6.000.000 lekë

Nga dokumentacioni i administruar⁶² rezultoi se me kontratën e kredisë nr. ***, datë 7.10.2016, e nënshkruar ndërmjet kredithënësit “Credins Bank” dhe kredimarrësit Sokol Malaj është miratuar kredia në vlerën 6.000.000 lekë, me qëllim konsumator. Kontrata e kredisë ka parashikuar si afat shlyerje deri në datën 23.12.2016. Kredimarrësi e ka siguruar bankën me anë të garancisë, përfaqësuar nga marrëveshja siguroese nr. ***, datë 7.10.2016. Sipas kësaj marrëveshjeje, z. Sokol Malaj ka lënë peng llogarinë/depozitën nr. ***, me vlerë 12.000.000 lekë, në pronësi të tij dhe interesat *cash* që burojnë nga kjo depozitë e ndodhur pranë “Credins Bank”. Kredia rezultoi e disbursuar në llogarinë e subjektit në datën 7.10.2016, në shumën 6.000.000 lekë dhe po në këtë datë, së bashku me gjendjen e akumuluar në llogari, ka kaluar në llogarinë e noteres M.B, person fizik.

22.11.2 Komisioni nuk ngriti dyshime për këtë burim krijimi, pasi konstatoi se kredia kishte kaluar në favor të noterit publik sipas legjislacionit në fuqi, por edhe për sa kohë që nuk vërejtí problematika në lidhje me përfitimin e saj.

22.12 Në lidhje me të ardhurat e realizuara nga biznesi “**” në pronësi të bashkëshortes A.**

Komisioni, të ardhurat e përfituara nga aktiviteti “****” e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, i ka trajtuar më sipër në këtë vendimarrje. Gjatë hetimit rezultoi se të ardhurat në total për periudhën 2009 – 2016 ishin në vlerën 28.210.084 lekë.

Komisioni, lidhur me këto të ardhura, nuk konstatoi problematika mbi ligjshmërinë e burimit të krijimit, për sa kohë ato vijnë nga aktiviteti tregtar dhe për to janë paguar detyrimet tatimore.

22.13 Në lidhje me të ardhurat nga fitimi i realizuar nga dividendi si ortak në shoqërinë “**” sh.p.k.**

22.13.1 Gjatë hetimit ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit është aksioner në shoqërinë “****” sh.p.k. Lidhur me këtë pronësi, aktivitetin tregtar, ortakët dhe pjesëmarrjen, Komisioni e ka trajtuar në detaje tek “Gjetje të tjera”.

22.13.2 DPT, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë⁶³, ka informuar lidhur me fitimin e realizuar për vitet 2014 – 2016 nga shoqëria “****” sh.p.k. dhe shpërndarjen e dividendit. Fitimi i realizuar për këtë periudhë është në shumën 61.380.245 lekë.

Rezulton se shoqëria “****” sh.p.k. ka vendosur që nga fitimi i vitit 2014 të shpërndajë dividend shumën 28.000.000 lekë. Nga ky dividend subjekti i rivlerësimit ka përfituar shumën 10.200.000 lekë në datën 11.11.2015, në llogarinë e tij bankare në “Credins Bank”, me përshkrimin “**** sh.p.k. pagesë dividend për vitin 2014” dhe shumën 8.000.000 lekë në datën 6.10.2016, po në llogarinë e tij bankare në “Credins Bank”, me përshkrimin “**** sh.p.k. pagesë dividend”. Shumat e përfituara nga shpërndarja e dividendit, subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar jo vetëm në deklaratat periodike vjetore përkatëse (2015 dhe 2016), por edhe në deklaratën individuale⁶⁴ vjetore të të ardhurave të viteve 2015 dhe 2016. Shoqëria ka paguar detyrimet tatimore përkatëse, konkretisht tatim fitimin për fitimin e realizuar, si dhe tatimin në burim për shpërndarjen e dividendit. Detyrimet në kohë reale⁶⁵ për shoqërinë janë në vlerën 0 (zero) lekë. Në këto kushte, Komisionit nuk i rezultojnë problematika lidhur me ligjshmërinë e këtij burimi.

22.14 Në lidhje me likuidimin e kësaj pasurie

⁶² Aneks nr. 4/5 në dosjen e ILDKPKI-së dhe shkresë nr. *** prot., datë 22.6.2021, nga “Credins Bank”, në dosjen e Komisionit.

⁶³ Me shkresën nr. *** prot., datë 1.8.2017, aneks nr. 35 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶⁴ Administruar me shkresën nr. *** prot., datë 25.5.2021 nga DPT-ja, në dosjen e Komisionit.

⁶⁵ Datë 24.5.2021, nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë, administruar me shkresën nr. *** prot., datë 25.5.2021 nga DPT-ja, në dosjen e Komisionit.

22.14.i Nga verifikimi i kontratës së shitjes⁶⁶ nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.10.2016, konstatohet se çmimi i shitjes së apartamentit është në vlerën 13.733.000 lekë dhe dy garazhet nga 1.128.750 lekë secili. Në total vlera e pasurive është 15.990.500 lekë. Palët deklarojnë se nga çmimi i blerjes prej 13.733.000 lekësh për blerjen e apartamentit është likuiduar 2.000.000 lekë, sipas deklaratës nr. *** rep., nr. *** kol., ndërsa diferenca prej 11.733.000 lekësh do të kalojë nëpërmjet llogarisë së noterit pranë “Credins Bank”. Shuma e çmimit prej 1.128.750 lekësh për blerjen e garazhit *** dhe shuma e çmimit prej 1.128.750 lekësh për blerjen e garazhit *** do të kalojë nëpërmjet llogarisë së noterit pranë “Credins Bank”.

22.14.ii Subjekti i rivlerësimit ka depozituar deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.10.2016, ku shtetasit F dhe A.V (shitësit e pasurisë) deklarojnë se z. Sokol Malaj u ka dhënë paradhënie për blerjen e apartamentit shumë prej 2.000.000 lekësh, *cash* në dorë, në datën 1.9.2016. Kjo shumë është likuiduar me kursimet që subjekti ka pasur gjendje *cash*.

22.14.iii Ndërsa pjesa tjetër e çmimit të kontratës në vlerën 13.990.500 lekë është likuiduar me transaksion bankar në datën 7.10.2016 nga llogaria bankare e subjektit të rivlerësimit në “Credins Bank” në llogarinë e noteres M.B, person fizik. Kjo shumë është krijuar nga: (i) shpërndarja e dividendit të shoqërisë “****” sh.p.k., ku subjekti ka përfituar në llogarinë e tij bankare shumë prej 8.000.000 lekë, në datën 6.10.2016; dhe (ii) kredia e marrë në vlerën 6.000.000 lekë, e cila është disbursuar në datën 7.10.2016.

Pra, sipas kontratës së shitblerjes së pasurive, si dhe transaksionit bankar të verifikuar, rezultoi se shuma 13.990.500 lekë ka kaluar nga llogaria e noterit sipas legjislacionit në fuqi.

Komisioni kreu analizën financiare për vitin 2016, nga ku si rrjedhojë e mospërfshirjes së shumë 10.000.000 lekë, hua e kthyer nga vëllai i subjektit, z. A.M, dukej se subjekti i rivlerësimit gjendej në pamundësi financiare në shumë prej 9.592.417 lekë për të investuar në këto pasuri, të shlyente kredinë, si dhe të përballonte shpenzimet e tjera familjare dhe, për pasojë, i kaloi subjektit barrën e provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.

22.15 Në qëndrimin e tij subjekti ka parashtruar se Komisioni duhet të përfshijë në analizën financiare vjetore të kryer për vitin 2016 shumë prej 10.000.000 lekësh, që përfaqëson kthimin e huas nga vëllai i tij. Subjekti ka parashtruar se: *“...me përfshirjen e shumë prej 10.000.000 lekësh në të ardhurat e mia, të realizuara gjatë vitit 2016, e cila është një e ardhur tërësisht e provuar dhe e ligjshme, analiza financiare shndërrohet në pozitive, konkretisht në vlerën 407.583 lekë. Është thelbësore të sqarohet fakti se vlera 10.000.000 lekë e ka burimin e saj fillestar tek unë, krijuar nga të ardhurat e aktivitetit tregtar të bashkëshortes sime (klinika dentare), duke u deklaruar rregullisht si kursim ndër vite, në deklaratat vjetore të depozituara në ILDKPKI dhe të detajuar njëkohësisht në deklaratën Vetting se të ardhurat vijnë nga ***. Këto fakte janë hetuar dhe verifikuar në themel dhe në mënyrë të detajuar nga Komisioni, duke rezultuar plotësisht e provuar mundësia ime financiare për të kursyer vlerën 10.000.000 lekë dhe për ta huazuar atë në dy pjesë (6.500.000 lekë dhe 3.500.000 lekë) tek im vëlla A.M përgjatë viteve 2009 - 2010 dhe 2015. Kthimi i shumë prej 10.000.000 lekësh nga im vëlla në muajin janar 2016, detajuar si më lart, detyrimisht duhet të përfshihet në zërin “Të ardhura”, pasi përfaqëson kthimin pikërisht të vlerës që unë kisha dhënë hua tek huamarrësi. Vlerësoj se është e papranueshme çdo logjikë e kundërt”.*

22.16 Trupi gjykues, lidhur me burimin e ligjshëm të shumë 10.000.000 lekë dhe kthimin e saj te subjekti i rivlerësimit nga vëllai i tij, ka arsyetuar në pikën 21.19 e në vijim të këtij vendimi. Për të mos rënë në përsëritje, për sa kohë që pretendimet e subjektit nuk u morën në konsideratë, rezultati financiar mbetet i pandryshueshëm. Në këto kushte, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është në pamundësi

⁶⁶ Aneks nr. 4/5 në dosjen e ILDKPKI-së.

financiare për vitin 2016, në shumën 9.592.417 lekë, për të investuar në pasuritë apartament dhe 2 garazhe, të shlyejë kredinë, si dhe të përballoj të gjitha shpenzimet e tjera familjare.

23. Automjet tip “Peugeot”, me targa ***, blerë me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.3.2015. Burimi i krijimit: të ardhurat e realizuara nga biznesi “***” në pronësi të bashkëshortes A.M. Vlera: 9.000 euro. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacionin mbështetës.

Hetimi i Komisionit

23.1 Nga verifikimi i DPV-ve rezultoi se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar për herë të parë këtë pasuri në vitin 2015, me përshkrimin “Blerje makine tip “Peugeot 3008”, vit prodhimi 2011, në vlerën 9.000 euro. Subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie.

23.2 DPSHTRR-ja⁶⁷ konfirmon se shtetasi Sokol Malaj ka të regjistruar automjetin me targa ***. Po ky institucion⁶⁸ ka bashkëngjitur dokumentacionin ligjor të automjetit me targa ***, i cili vërteton pronësinë e z. Sokol Malaj.

23.3 Në dokumentacionin e administruar disponohet kontrata e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.3.2015, e cila është nënshkruar ndërmjet palës shitëse E.M dhe subjektit të rivlerësimit.

23.4 Referuar lejes së qarkullimit të automjetit tip “Peugeot”, me targa ***, konstatohet se ky automjet është regjistruar për herë të parë në datën 9.4.2015, me pronar aktual subjektin e rivlerësimit.

23.5 Komisioni verifikoi dokumentacionin edhe në lidhje me pagesën e zhdoganimit të automjetit, nga ku konfirmohet se mjeti është importuar nga shtetasi E.M, referuar deklaratës së zhdoganimit datë 9.4.2015.

23.6 Nga dosja e DPSHTRR-së konstatohet se automjeti ka hyrë në kufirin doganor Hani i Hotit në datën 9.4.2015, me vlerën 8.000 euro dhe pagesa doganore ishte 298.294 lekë.

23.7 Komisioni konstatoi se automjeti ishte blerë më shumë sesa i ishte shitur shtetasit E.M.

23.8 Subjekti i rivlerësimit, pasi është pyetur lidhur me këtë konstatim, ka sqaruar se me kontratën e shitblerjes ka blerë nga shtetasi E.M automjetin tip “Peugeot”, me targa të shtetit francez ***, kundrejt çmimit 9.000 euro dhe se në momentin e lidhjes së kontratës së shitjes për këtë automjet nuk ishte paguar vlera e detyrimit doganor, duke mos u kryer ende procedurat e zhdoganimit nga shitësi.

23.9 Subjekti ka sqaruar se sikurse vihet re edhe nga përmbajtja e kontratës së shitblerjes, shitja e automjetit është bërë bazuar mbi aktet e ardhura nga Republika e Francës. Ai ka qartësuar se pas realizimit të shitjes është ndjekur procedura e zhdoganimit të automjetit dhe pagesa doganore në vlerën 298.400 lekë është paguar nga ana e tij si blerës (dhe jo nga shitësi E.M), me anë të veprimit bankar të datës 8.4.2015, në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

23.10 Nën këto argumente, subjekti ka deklaruar se çmimi i shitjes dhe vlera e paguar në total prej tij ka qenë më e lartë sesa vlera e blerjes nga shitësi E.M.

23.11 Subjekti ka depozituar: (i) kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.3.2015, e automjetit, hartuar përpara noteres S. K. B (Dhoma e Noterisë Tiranë); si dhe (ii) *statement/nxjerrje* llogarie nga “Credins Bank”, për llogarinë në lekë të z. Sokol Malaj.

⁶⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 7.12.2018/referojuni aneksit nr. 33 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶⁸ Me *email*-in e datës 27.11.2018, administruar në dosjen e ILDKPKI-së, si dhe dokumentacionin e përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 28.5.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

23.12 Nga verifikimi i nxjerrjes së llogarisë konstatohet se në datën 8.4.2015 nga subjekti i rivlerësimit është paguar detyrimi doganor i këtij automjeti, në shumën 298.400 lekë.

23.13 Komisioni hetoi në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie.

23.13.i Lidhur me ligjshmërinë e krijimit të të ardhurave të gjeneruara nga klinika dentare, Komisioni i ka trajtuar ato dhe nuk ka konstatuar problematika.

23.13.ii Sa i përket likuidimit të kësaj pasurie, Komisioni ka arsyetuar më sipër se gjendja e likuiditeteve *cash* në fund të vitit 2014 ka qenë në vlerën 15.000.000 lekë, vlerë kjo më se e mjaftueshme për të investuar në muajin mars shumën 9.000 euro për blerjen e automjetit.

23.13.iii Komisioni kreu analizën financiare për vitin 2015, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare të investojë në këtë pasuri, të kursejë, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare.

23.14 Komisioni pyeti subjektin e rivlerësimit lidhur me marrëdhënien që ka pasur apo ka me shtetasin E.M, nga ku ka deklaruar se ai është i afërmi i tij, i cili jeton prej vitesh në Francë.

23.15 Subjekti ka deklaruar se në asnjë rast nuk ka hetuar, pushuar, mosfilluar apo dërguar për gjykim ndonjë çështje penale ndaj tij apo të vënë në lëvizje nga ai. Ai ka depozituar⁶⁹ edhe vërtetimet e punëdhënësve të tij, nga ku në asnjë rast nuk konfirmohet ndonjë hetim i zhvilluar prej tij ndaj këtij shtetasi.

23.16 SPAK-u⁷⁰ nuk ka konfirmuar ndonjë material kallëzues apo procedim penal në emër të shtetasit E.M.

24. Automjet tip “Nissan Qashqai”, me targa ***, në përdorim me kontratën e huapërdorjes së automjetit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.1.2016, me huadhënës shoqëria “****” sh.p.k. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacionin mbështetës.

24.1 Komisioni hetoi në lidhje me vërtetësinë dhe saktësinë e deklaramentit të kësaj pasurie, si dhe lidhur me burimin e krijimit të saj.

24.2 Nga dokumentacioni i administruar provohet që automjeti është marrë me kontratën e huapërdorjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.1.2016, nënshkruar ndërmjet palës huadhënëse, shoqëria “****” sh.p.k. dhe palës huapërdorëse Sokol Malaj, për automjetin tip “Nissan”, me targa *** , kundrejt një afati kohor të pacaktuar, duke filluar nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate.

24.3 Me certifikatën e pronësisë së mjetit rrugor, datë 27.1.2016, konfirmohet fakti se mjeti tip “Nissan Qashqai”, me targa *** , është në pronësi të shoqërisë “****” sh.p.k.

24.4 Nga verifikimi i kryer Komisioni konstatoi se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar.

Detyrime financiare

25. Kredi bankare nr. * rep., nr. *** kol., datë 3.8.2006, pranë “Raiffeisen Bank”, me afat 25 vjet dhe interes vjetor 3%, në shumën 5.000.000 lekë, për blerjen e banesës pranë shoqërisë “****” sh.p.k.** Filluar në datën 3.8.2006, me këst mujor 23.710 lekë. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e

⁶⁹ Me pyetësorin nr. 2, datë 5.1.2023, përkatësisht shkresat: nr. *** prot., datë 13.1.2023, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier; nr. *** prot., datë 13.1.2023, të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; nr. *** prot., datë 11.1.2023, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë; dhe nr. *** prot., datë 13.1.2023, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁷⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 21.11.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

pashlyer: 3.171.057 lekë. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës⁷¹ veprimet e llogarisë së kredisë, disbursuar në datën 8.8.2006, në shumën 5.000.000 lekë, këst mujor 23.710 lekë dhe gjendje detyrimi në datën 18.1.2017 në shumën 3.357.410 lekë.

25.1 Subjekti i rivlerësimit e deklaroi kredinë e marrë në “Raiffeisen Bank”, në vlerën 5.000.000 lekë, në DPV-në e vitit 2006, me qëllimin për blerje apartamenti. Këtë kredi, Komisioni e ka trajtuar edhe në sipër në këtë vendimarrje, si një nga burimet e krijimit për pasurinë *Apartament banimi me sipërfaqe 109.7 m²*. Nga dokumentacioni i administruar rezultoi se kredia është disbursuar në datën 8.8.2006 dhe një ditë më pas ka kaluar në favor të shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k. për llogari të marrëdhënies kontraktore që subjekti kishte nënshkruar me këtë shoqëri për blerjen e apartamentit të hetuar dhe konkluduar më sipër.

25.2 Nga korrespondenca e Komisionit me “Raiffeisen Bank”⁷² konfirmohet kredia e marrë në datën 3.8.2006, në vlerën 5.000.000 lekë.

25.3 Nga analizimi i *statement*-it konfirmohet detyrimi i mbetur deri më 24.1.2017, i cili është në vlerën 3.357.410 lekë.

25.4 Në analizë të të dhënave të dala, Komisioni konstatoi se përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e ardhur nga “Raiffeisen Bank” për vlerën e mbetur të kësaj kredie deri në datën e dorëzimit të deklaratës *Vetting*.

26. Kredi bankare nr. *, datë 7.10.2016, pranë “Credins Bank”,** me afat deri në datën 27.12.2016, me interes vjetor 4.94%, në shumën 6.000.000 lekë, për blerjen e banesës në rrugën “****” pallati “****”, S. Interesi i paguar në vlerën 62.357 lekë. Kredia është mbyllur në datën 27.12.2016, duke u paguar nga llogaria e depozitës nr. ***. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer: 0 (zero) lekë. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës konfirmimin nr. *** prot., datë 19.1.2016 (2017) nga “Credins Bank”⁷³, për z. Sokol Malaj, e cila informon se ai ka pasur një kredi në vlerën 6.000.000 lekë, marrë në datën 7.10.2016 dhe mbyllur në datën 27.12.2016.

26.1 Subjekti i rivlerësimit e deklaroi kredinë e marrë në “Credins Bank” në DPV-në e vitit 2016, me qëllim blerje apartamenti. Këtë kredi, Komisioni e ka trajtuar edhe më sipër, si një nga burimet e krijimit për pasurinë nr. ***. Nga dokumentacioni i administruar⁷⁴ rezultoi se kredia është disbursuar në datën 7.10.2016 dhe po në këtë datë, së bashku me gjendjen e akumuluar në llogari, ka kaluar në llogarinë e noteres M.B, person fizik, sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., për blerjen e apartamentit, të hetuar dhe konkluduar më sipër.

26.2 Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se kredia është shlyer në datën 27.12.2016. Burim krijimi për shlyerjen e saj ka shërbyer një pjesë e depozitës prej 12.000.000 lekësh, e çelur në vitin 2015, si rezultat i pagesës së dividendit nga shoqëria “****” sh.p.k. Në datën 23.12.2015 subjekti i rivlerësimit ka investuar në depozitë 12-mujore shumën 12.000.000 lekë. Pas maturimit të saj në vitin 2016, subjekti ka transferuar në llogarinë e tij rrjedhëse, në datën 27.12.2016, shumën 6.069.000 lekë dhe po në këtë datë ka mbyllur kredinë duke paguar në favor të bankës vlerën 6.068.943,15 lekë (principal + interes).

26.3 Për sa më sipër, konstatohet se përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e administruar.

⁷¹ Aneks nr. 4/8 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁷² Shkresë nr. *** prot., datë 28.05.2021.

⁷³ Referojuni aneksit nr.4/9 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁷⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 22.6.2021, nga “Credins Bank”.

27. Kontratë overdraft nr. *, në “Credins Bank”, në shumën 6.500 euro (e papërdorur). Detyrimi: 0 (zero) euro.**

27.1 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës konfirmimin nr. *** prot., datë 19.1.2016, nga “Credins Bank”⁷⁵, për z. Sokol Malaj, i cila ka *overdraft* në vlerën 6.500 euro, marrë në datën 22.8.2016, si dhe kontratën e *overdraft*-it nr. ***, datë 22.8.2016, me palë kredidhënëse “Credins Bank” dhe palë kredimarrëse Sokol Malaj, me objekt të saj rinovimin e *overdraft*-it në shumën 6.500 euro në llogarinë A.E.

27.2 Nga korrespondenca e mbajtur me sistemin bankar⁷⁶ konfirmohet kjo llogari, si dhe gjendja e saj në datën 24.1.2017 kur është depozituar deklarata *Vetting* është në vlerën 11,52 euro.

27.3 Nga verifikimi i dokumentacionit duket se ndryshimi i gjendjes vjen për shkak se dokumentacioni i dorëzuar është i datës 19.1.2016, ndërsa konfirmimi i bankës i datës 24.1.2017.

28. Gjetje të tjera në lidhje me subjektin e rivlerësimit

*Në lidhje me aksionet e subjektit në shoqërinë “****” sh.p.k., pozitën dhe rolin e tij në raport me ushtrimin e funksionit magjistrat/prokuror.*

28.1 Situata faktike

28.2 Situata faktike e subjektit të rivlerësimit në lidhje me aksionet e tij në shoqërinë “****” sh.p.k, siç konstatohet nga ekstrakti tregtar historik nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), është si vijon:

28.2.i Subjekti i rivlerësimit, me detyrë prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është bërë subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së për një periudhë të pandërprerë që prej vitit 2003.

28.2.ii Në datën 20.2.2014 rezultoi e regjistruar në QKB shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “****” sh.p.k., me aksioner dhe pronar të vetëm Sokol Malaj dhe administrator A.H.

28.2.iii Në datën 22.4.2014, aksioneri/ortaku i vetëm Sokol Malaj ka nxjerrë vendimin për ndryshimin e administratorit të shoqërisë dhe z. A.H është zëvendësuar nga z. G.L, për një periudhë pesëvjeçare (deri më 22.4.2019), rinovuar sërish në vitin 2022 për një periudhë trevjeçare deri në vitin 2025.

28.2.iv Në datën 7.8.2014 kjo shoqëri, me përfaqësues ortakun e vetëm të shoqërisë z. Malaj/subjektin e rivlerësimit dhe njëkohësisht si dorëzanës, ka nënshkruar me “Tirana Bank” një kontratë për kredi afatmesme për blerje automjetesh, kontratë e nënshkruar prej tij, në cilësinë e kredimarrësit dhe dorëzanësit.

28.2.v Me vendimin nr. ***, datë 13.11.2014⁷⁷, të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë, subjekti i rivlerësimit, si ortak i vetëm i kësaj shoqërie, ka vendosur zgjerimin e aktivitetit me veprimtari “****”, për të tretë dhe me qira (ky veprim është parashikuar në detyrat e Asamblesë së Ortakëve⁷⁸).

28.2.vi Me vendimin nr. ***, datë 26.2.2015⁷⁹, të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë, subjekti i rivlerësimit, si ortak i vetëm i saj, ka vendosur hapjen e një adrese sekondare.

28.2.vii Në datën 23.3.2015, aksioneri i vetëm Sokol Malaj ka nxjerrë vendimin për shitjen e 50% të aksioneve që zotëronte në shoqëri për tek shtetasi K.K. Prandaj, ndarja e aksionerëve të shoqërisë “****”

⁷⁵ Referojuni aneksit nr. 4/9 dhe nr. 4/10 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁷⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 22.6.2021, e “Credins Bank”.

⁷⁷ Referuar ekstraktit të QKB-së.

⁷⁸ Referuar nenit 9/2/b të Aktit të Themelimit të Shoqërisë dhe Statutit, të drejtat e ortakëve të Asamblesë së Përgjithshme.

⁷⁹ Referuar ekstraktit të QKB-së.

sh.p.k. ishte 50% e aksioneve në pronësi të z. Sokol Malajt dhe 50% e aksioneve në pronësi të shtetasit K.K.

28.2.viii Në datën 25.7.2017, subjekti i rivlerësimit ka marrë vendim për miratimin e pasqyrave financiare të shoqërisë për vitin 2016, duke u shfaqur si pronar aktiv i aksioneve.

28.2.ix Në datën 26.3.2018, subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar marrëveshjen për pronësinë pasive të aksioneve nga pronari, z. Malaj. Sipas kësaj marrëveshjeje, z. Sokol Malaj do t'ia kalonte pronësinë aktive të aksioneve të tij në shoqërinë “****” sh.p.k. shtetasit E.XH, i cili pa kompensim do të ishte personi i besuar që do të menaxhonte aksionet e z. Malaj.

28.2.x Subjekti i rivlerësimit rezultoi se ka vepruar si pronar aktiv i aksioneve të tij edhe pas marrëveshjes së vitit 2018. Në datën 10.2.2019 ai ka marrë pjesë në asamblenë e aksionerëve të shoqërisë për shpërndarjen e dividendit për vitet 2015 – 2017.

28.2.xi Në datën 26.8.2021, subjekti ka marrë pjesë në asamblenë e aksionerëve të shoqërisë dhe ka nxjerrë vendimin për zëvendësimin e personit të tij të besuar E.XH me S.M, duke pasur të njëjtat të drejta si personi i mëparshëm (i besuar).

28.3 Analiza e fakteve në vijueshmërinë kohore lidhur me aksionet në pronësi të subjektit të rivlerësimit në shoqërinë “**” sh.p.k.**

28.3.i Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (parashikimet para ndryshimeve në vitin 2016), në nenin 143 të saj specifikonte: *“Të jesh gjyqtar nuk përputhet me asnjë veprimtari tjetër shtetërore, politike apo private”*. Kushtetuta nuk parashikon në mënyrë eksplicite të njëjtat kriteret për prokurorët.

Në nenin 148 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë citohet: *“Prokurorët gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre i nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjit”*.

28.3.ii Për rrjedhojë i referohemi ligjit nr. 8737/2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

28.3.iii Në këtë ligj, në nenin 39/2 të tij, parashikohet: *“2. Detyra e prokurorit është e papajtueshme me kandidaturën dhe çdo mandat zgjedhor, detyrë apo detyrë publike, me përjashtim të veprimtarisë edukative ose mësimore që rregullohet me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm. 3. Prokurorit i ndalohet dypunësimi, me përjashtim të veprimtarive të lejuara në pikën 2 të këtij neni. 4. Prokurorit i ndalohet pjesëmarrja në organet drejtuese të bizneseve/shoqërive tregtare”*.

28.3.iv Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit⁸⁰, ka deklaruar: *“...referuar ligjit nr. 9901/2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i cili përcakton në nenin 95 e vijues të tij, si organ drejtues të shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, administratorët e saj, jam kujdesur të veproj në përputhje me ndalimin e nenit 39/4 të ligjit nr. 8737/2001, duke mos qenë në asnjë rast pjesë e organeve drejtuese të kësaj shoqërie tregtare, duke mos marrë pjesë e as ndikuar në veprimtarinë e përditshme tregtare të shoqërisë “****” sh.p.k.”*.

28.4 Nga dokumentacioni i administruar rezultoi se subjekti i rivlerësimit ishte aksioneri i vetëm, themelues i një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e quajtur “****” sh.p.k., e cila u regjistrua më 20.2.2014 në QKB dhe më vonë, në datën 23.3.2015, aksioneri i vetëm shiti 50% të aksioneve të tij në shoqëri një personi tjetër.

28.5 Ligji nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, i cili rregullon formën e krijimit të shoqërive të ndryshme tregtare që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e

⁸⁰ Nr. ***, datë 5.1.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

Shqipërisë, në nenin 68 e në vijim të tij parashikon funksionimin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuara, organet e tyre drejtuese që janë Asambleja e Aksionerëve (si organi më i lartë vendimmarrës) dhe administratori/ët (si përfaqësues i shoqërisë me të tretët në aktivitetet e përditshme).

28.6 Në statutin e shoqërisë “***” sh.p.k, shprehimisht në nenin 8 të tij, parashikohet se organet drejtuese të shoqërisë janë: 1) Asambleja e Aksionerëve; dhe 2) administratori. Përkatësisht, nenet 9 dhe 10 të këtij ligji parashikojnë të drejtat dhe kompetencat përkatëse të tyre.

28.7 Më tej, në nenin 4, shkronja “ç” e urdhrit nr. 141, datë 19.6.2014, të Prokurorit të Përgjithshëm të asaj kohe, “Për miratimin e rregullave mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve”, thuhet shprehimisht: *“Prokurorët në ushtrimin me pavarësi të funksioneve apo detyrave të tyre nuk duhet të zhvillojnë veprimtari ekonomike, duke përfshirë çdo lloj pune apo biznesi për të përfituar interesa/të mira materiale apo jomateriale, që mund të cenojnë pavarësinë e tyre apo që mund të krijojnë përshtypjen e përdorimit të detyrës për interesat e tyre personale apo të personave të tjerë dhe nuk duhet të anëtarësohen në organizata shoqërore, të cilat krijojnë dyshimin se cenojnë figurën e prokurorit ose janë të papajtueshme me funksionin e tij”.*

28.8 Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* si burim krijimi të një prej pasurive të tij, apartament banimi nr.*** dhe dy garazhe të blera në vitin 2016, gjithashtu edhe me të ardhurat e përfituara nga dividendët, nga fitimi i kompanisë.

28.9 Rezultoi se nga shoqëria është shpërndatë dividend dhe se subjekti i rivlerësimit Sokol Malaj ka përfituar në vitin 2015 shumën 10.200.000 lekë, me përshkrimin “Pagesë nga shpërndarja e dividendit për vitin 2014”, si dhe shumën 8.000.000 lekë në vitin 2016, me përshkrimin “Pagesë dividendi”.

28.10 Në ligjin “Për konfliktin e interesit...”, i ndryshuar në vitin 2014, në nenin 3.1 të tij parashikohet: *“Konflikti i interesit” është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike”.* Gjithashtu, në nenin 5 të tij, parashikohet: *“Interesat privatë të zyrtarit janë ata interesa që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga: a) të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloji natyre; b) çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile; c) dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale; ç) negocime të mundshme për punësim në të ardhmen nga ana e zyrtarit gjatë ushtrimit të funksionit apo negocime për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat për zyrtarin, pas lënies së detyrës, të kryer nga ai gjatë ushtrimit të detyrës; d) angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtari, që krijon të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse...”.*

28.11 Në këto kushte, vërehet se përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2016, subjekti i rivlerësimit zotëronte aktivisht aksione në një shoqëri sh.p.k., duke qenë kështu pjesë e asamblesë së saj. Siç thuhet në statutin e shoqërisë, si dhe në ligjin nr. 9901/2008, asambleja është një nga organet drejtuese të një shoqërie sh.p.k., ku bënte pjesë subjekti, ndërkohë që duket se ligji “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” pengonte një prokuror të jetë në organin drejtues të një shoqërie private.

28.12 Në çështjen objekt hetimi duket se krijimi i të ardhurave nga shpërndarja e dividendëve përfshihet si *interesa privatë të zyrtarit*, sipas nenit 5 të ligjit nr. 9367/2005 i ndryshuar dhe, për rrjedhojë, duket se ekziston një konflikt interesi ndërmjet detyrës publike dhe interesit privat të subjektit të rivlerësimit.

28.13 Në ndryshimet e bëra në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë me ligjin nr. 76/2016, në nenin 149/ç të tij, parashikohet se: *“Qenia Prokuror i Përgjithshëm, prokuror ose anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër shtetërore ose politike, si dhe me veprimtari*

profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të aktivitetit mësimdhënës, akademik ose shkencor”.

28.14 Ligji nr. 96/2016, i cili hyri në fuqi në fund të vitit 2016, në nenin 7/4 të tij ka parashikuar që magjistratët mund të zotërojnë vetëm në mënyrë pasive aksione ose kapital në shoqëritë tregtare, për sa kohë që shoqëritë nuk përfitojnë tendera publike/kontrata me shtetin ose nëse veprimtaria e shoqërisë është e ndaluar me ligj. “4. Magjistratit i ndalohet: a) të administrojë, të drejtojë ose të ushtrojë ndikim në shoqëritë tregtare ose fitimprurëse, personalisht ose nëpërmjet përfaqësimit; b) të zotërojë në mënyrë aktive aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit; c) të zotërojë në mënyrë pasive aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare, nëse shoqëria ka fitime ose të mira nga kontratat publike, në përputhje me legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesit në fuqi; ç) të zotërojë në mënyrë pasive aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare, në të cilën veprimtaria e magjistratit është e ndaluar, për shkak se mund të ndikojë në pavarësinë e magjistratit, krijon konflikt interesi ose krijon përshtypjen që magjistrati është i njëanshëm ose i ndikuar”.

28.15 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit⁸¹, ka deklaruar se bazuar në këto ndryshime ligjore, në vijim ka zbatuar me korrektësi këto përcaktime ligjore, duke e vendosur cilësinë e tij si ortak pranë shoqërisë “***” sh.p.k., në kushtet e shkronjës “b” të pikës 4 të nenit 7 të ligjit nr. 96/2016, duke lidhur Marrëveshje për Zotërimin Pasiv të Kuotave me shtetasin E.XH dhe duke e depozituar atë rregullisht pranë QKB-së. Njëkohësisht, gjatë gjithë kësaj periudhe është kujdesur të mos ketë asnjë ndikim mbi shoqërinë tregtare.

28.16 Edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji duket se subjekti vazhdoi të zotëronte në mënyrë aktive aksionet e tij në shoqërinë tregtare, në kundërshtim me nenin 7 të tij. Në datën 26.3.2018, subjekti ka nënshkruar një marrëveshje për pronësinë pasive të aksioneve të tij. Në këtë marrëveshje subjekti i rivlerësimit i kalonte pronësinë aktive⁸² të aksioneve të tij në shoqërinë “***” sh.p.k. një personi të besuar, shtetasit E.XH, i cili pa kompensim do të ishte personi i besuar që do të administronte kapitalin/vlerën e subjektit.

28.17 Që nga ajo ditë subjekti i rivlerësimit do të ishte pronar pasiv⁸³ i aksioneve të tij në shoqëri.

28.17.i Subjekti i rivlerësimit duket se ka vepruar si pronar aktiv i aksioneve të tij edhe pas marrëveshjes së vitit 2018.

28.17.ii Në datën 10.2.2019 ai ka marrë pjesë në Asamblenë e Aksionerëve të Shoqërisë dhe ka vendosur shpërndarjen e dividendit për vitet 2015 – 2017.

28.18 Në nenin 12 të vendimit nr. 32, datë 24.2.2022, të KLP-së, “Për miratimin e standardeve të etikës dhe rregullave të sjelljes së prokurorit”, parashikohet: “Pjesëmarrja e prokurorit në sipërmarrjet tregtare

⁸¹ Nr. 2, datë 5.1.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁸² “Pronësia aktive e aksioneve ose e pjesëve të kapitalit” është ushtrimi i plotë i të gjitha të drejtave që rrjedhin nga pronësia e aksioneve ose pjesëve të kapitalit (neni 3.5 i ligjit “Për konfliktin e interesit...”).

⁸³ “Pronësia pasive e aksioneve ose e pjesëve të kapitalit” është një situatë në të cilën pronari ruan të drejtën për të përfituar nga frutet civile të pronësisë, por nuk mund të ushtrojë vetë asnjë veprim tjetër civil mbi këtë pronë. Të gjitha veprimet e tjera (administrimi, posedimi, tjetërsimi etj.) kryhen nga një person i besuar nga pronari, në bazë të një marrëveshjeje të lidhur ndërmjet tyre që përcakton kriteret për të shijuar frutet e pasurisë, si dhe të drejtat dhe detyrimet e tjera thelbësore. Personi i besuar nuk shkëmben asnjë mendim apo informacion me pronarin dhe nuk ndikohet prej tij për kryerjen e këtyre veprimeve me asetet. Personi i besuar duhet të veprojë vetëm për të mirën e ruajtjes dhe rritjes së aseteve, me të njëjtin motivim sikur këto veprime të kryheshin nga vetë pronari. Kufizimet për zgjedhjen e personit të besuar jepen në këtë ligj. Në çdo rast, palët ruajnë të drejtën për të zgjidhur këtë marrëveshje. Pronari ka të drejtë të rimarrë në çdo kohë të drejtat për të kryer veprime të tjera civile me pronësi, kur, sipas këtij ligji, nuk ekzistojnë më kushtet që diktuan këtë veprim. Të drejtat dhe detyrimet e tjera që nuk përmenden më sipër rregullohen nga Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë (neni 3.6 i ligjit “Për konfliktin e interesit...”).

duhet të jetë në përputhje me nenin 7, pika 4 e ligjit nr. 96/2016 “dhe legjislacionit në fuqi, duke u kujdesur që rast pas rasti të shmangët konflikti i interesit”.

28.19 Komisioni ka mbajtur korrespondencë me APP-në, nga ku është informuar⁸⁴ se shoqëria “****” sh.p.k. nuk ka marrë ndonjë kontratë publike (tender) për vitet 2014 – 2018.

28.20 Nga korrespondenca e mbajtur⁸⁵ nuk konfirmohen materiale kallëzuese apo procedime penale në ngarkim të shtetasve G.L, A.H, E.XH e K.K dhe as çështje të hetuara nga subjekti i rivlerësimit, në kuadër të ekzistencës së ndonjë konflikti të mundshëm të interesit.

28.21 Nga korrespondenca e mbajtur me Prokurorinë e Përgjithshme⁸⁶, Komisioni informohet se nga subjekti i rivlerësimit, për periudhën janar – dhjetor 2014, nuk ka rezultuar të jetë regjistruar ndonjë njoftim për angazhimin në veprimtarinë objekt hetimi administrativ.

28.22 Nga korrespondenca e mbajtur me Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë⁸⁷, Komisioni informohet se nga subjekti i rivlerësimit, për periudhën janar – dhjetor 2014, nuk ka rezultuar të jetë regjistruar ndonjë njoftim për angazhimin në veprimtarinë objekt hetimi administrativ.

28.23 ILDKPKI-ja⁸⁸ informon se: *“...subjekti i rivlerësimit ka marrë masa për të zgjidhur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik në një nga mënyrat e parashikuara nga kuadri ligjor në fuqi, nuk është ndodhur në kufizimet e parashikuara në nenin 21, pika 1, duke mos përfituar nga fondet publike për procedurat e regjistruara pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, si dhe objekti i shoqërisë tregtare është në një fushë e cila nuk ndërlidhet apo pritet me funksionin e magjistratit”.*

28.24 Në analizë të fakteve të dala, Komisioni ka konstatuar se duket se subjekti i rivlerësimit me veprimet dhe mosveprimet e tij ka vepruar në papajtueshmëri me detyrën e prokurorit, bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë⁸⁹, nenin 39/4 të ligjit nr. 8737/2001, si dhe ligjin nr. 9367/2005, i ndryshuar, duke i kaluar barrën e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit i rivlerësimit

28.25 Në parashtrimet e subjektit, ndër të tjera, është shpjeguar se Komisioni ka bërë një interpretim shumë të ngushtë të kuadrit ligjor, interpretim i cili ka sjellë cenimin në mënyrë të paarsyeshme, jo proporcionale dhe të pambështetur në ligj të të drejtave të tjera themelore kushtetuese, që mbrohen dhe garantohen nga rendi ligjor në fuqi, sikurse është e drejta e pronës private dhe e drejta e gëzimit të saj pa kufizime, për sa kohë nuk cenon interesin publik.

28.26 Subjekti ka parashtruar se qëllimi i ligjvënësit kur ka parashikuar ndalime ligjore për subjektet që ushtrojnë detyrën e magjistratit (prokurorë ose gjyqtarë), për të mos pasur veprimtari aktive në fushën tregtare, ka qenë pikërisht për faktin që të japë garanci ligjore që këta subjekte në ushtrimin e funksionit të tyre publik të garantojnë vendimmarrje të paanshme, transparente, në interesin më të mirë të

⁸⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 1.3.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁸⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 13.2.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; shkresë nr. *** prot., datë 16.2.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; shkresë nr. *** prot., datë 16.2.2023, e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; si dhe shkresë nr. *** prot., datë 16.2.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

⁸⁶ Referojuni shkresës nr. *** prot., datë 15.2.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁸⁷ Referojuni shkresës nr. *** prot., datë 16.2.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁸⁸ Me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 7.2.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁸⁹ Neni 148, pika 3 parashikon: *“...në ushtrimin e kompetencave të tyre prokurorët u nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve”.* Neni 149/ç, parashikon: *“Qenia Prokuror i Përgjithshëm, prokuror ose anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër shtetërore ose politike, si dhe me veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të aktivitetit mësimdhënës, akademik ose shkencor”.*

mundshëm të publikut e të besimit të tij ndaj institucioneve publike, nëpërmjet parandalimit të konfliktit të interesave publikë dhe atyre privatë të një zyrtari në ushtrimin e funksioneve të veta.

28.27 Subjekti ka shpjeguar dhe argumentuar gjerësisht kuadrin ligjor, përfshirë ushtrimin e veprimtarisë tregtare, papajtueshmërinë me funksionin, zbatimin e kuadrit ligjor në rast fitimi nga veprimtaria e një shoqërie tregtare, ndalesat e parashikuara për ushtrimin të atyre punëve apo bizneseve të cilat cenojnë ushtrimin korrekt të detyrës, etj.

28.28 Subjekti ka theksuar faktin se nga hetimi administrativ i kryer nga ana e Komisionit nuk ka rezultuar i provuar në asnjë rast që ai, në cilësinë e prokurorit të Republikës së Shqipërisë, të ketë kryer veprimtari tregtare aktive, e cila të ketë implikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë veprimtarinë e tij si prokuror në detyrë.

28.29 Subjekti ka kundërshtuar faktin se kjo shoqëri apo organet drejtuese të saj kanë ushtruar veprimtari të paligjshme dhe në kundërshtim me rendin ligjor kushtetues, legjislacionin fiskal në fuqi etj.

Subjekti ka theksuar se nga hetimi nuk është evidentuar që kjo shoqëri të ketë marrë pjesë aktive në tenderat publike apo të ketë krijuar marrëdhënie tregtare dhe financiare me subjekte që janë hetuar apo ka pasur dyshime që janë përfshirë në veprimtari kriminale, apo të ketë operuar me shoqëri tregtare, të cilat kanë përfituar nga fondet publike dhe që japin *indicie* se veprimtaria tregtare e kësaj shoqërie të ketë ndikuar dhe të ketë implikuar veprimtarinë e tij si prokuror në detyrë.

28.30 Në këtë çështje, sipas subjektit, nuk është identifikuar asnjë fakt apo rrethanë që të japë të dhëna apo *indicie* që ai, në cilësinë e prokurorit, të ketë ndërhyrë apo të ketë ndikuar në veprimtarinë hetimore të kryer nga strukturat përkatëse shtetërore apo publike, ose nga vetë organi i akuzës, ndaj personave privatë tregtarë apo fizikë, me të cilët ka ndërvepruar apo ka ofruar shërbime shoqëria “****” sh.p.k., të cilat mund të provonin se ka shkelur parimet dhe qëllimi kryesor për të cilin ligjvënësi ka miratuar kuadrin ligjor në fuqi për papajtueshmërinë e funksionit të magjistratit në tërësi, si dhe miratimin e dispozitave ligjore të ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar, në veçanti.

28.31 Subjekti i ka quajtur veprime sporadike dhe të kufizuara si ortak i shoqërisë pjesëmarrjet në mbledhjen e datës 25.7.2017 dhe asaj të datës 10.2.2019, e që në rastin konkret nuk provohet të kenë sjellë asnjë lloj pasoje, pra të kenë cenuar interesin publik apo të ndonjë subjekti privat, duke theksuar se ato nuk përbëjnë shkak të arsyeshem ligjor për ta klasifikuar faktin se ai ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit, për sa kohë ka pasur edhe funksionin e prokurorit.

28.32 Subjekti ka pretenduar se ligji nuk e ndalon prokurorin të zotërojë apo të ketë në pronësi të tijën kuota apo pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare, kufizimi i parashikuar në nenin 39, pika 4 e ligjit nr. 8737/2001, nenin 149/ç të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenin 7, pika 4, shkronja “b” e ligjit nr. 96/2016, nuk lidhet me ndalimin e prokurorit për të qenë pjesëtar i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, pjesëmarrja e të cilit është për shkak të ligjit dhe cilësisë së tij si pronar i kuotave të shoqërisë apo i një pjese të tyre, por lidhet me ndalimin e tij për të qenë administrator i shoqërisë, si në rastin kur ai është edhe ortak i vetëm apo në kuota të caktuara.

28.33 Mbi këtë shpjegim subjekti ka theksuar se prokurori do të ishte në shkelje të kësaj dispozite nëse ai do të kryente funksionet në çfarëdo organi drejtues të shoqërive tregtare, në të cilat ai nuk zotëron asnjë kuotë apo aksion, si dhe në rastet kur ai do të jetë funksionar i një organi drejtues që realisht administron veprimtarinë ekonomike të shoqërisë tregtare, kuotat e së cilës zotërohen nga prokurori.

Subjekti ka shpjeguar edhe mbi urdhrin nr. 141, datë 19.6.2014, të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për miratimin e rregullave mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve”, Komentarin e Bangalore mbi Parimet e

Sjelljes Gjyqësore, i titulluar “Aktivitetet financiare” (teksti i publikuar në faqen zyrtare të UNDOC)⁹⁰, në raport me këtë veprimtari tregtare.

28.34 Sipas subjektit, vlerësimi i Komisionit lidhur me konstatimin e pjesëmarrjes së tij në Mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve në datën 25.7.2017 (në të cilën është marrë vendimi për miratimin e pasqyrave financiare të shoqërisë për vitin 2016), si dhe në datën 10.2.2019 (në të cilën është marrë vendimi për shpërndarjen e fitimit për vitet 2015, 2016 dhe 2017 si dividend për ortakët), si veprim i kryer në kundërshtim me ndalesën e parashikuar në nenin 7/4/b të ligjit nr. 96/2016, është një interpretim shumë i ngushtë dhe jo harmonik i legjislacionit të zbatueshëm dhe në fuqi, pasi sipas tij nuk janë veprime që tregojnë për ushtrimin aktiv të së drejtës së tij si ortak në këto shoqëri apo zotërimin aktiv të kuotës në kapitalin themeltar të shoqërisë nga ana e magjistratit, por ato janë veprime të cilat tregojnë ushtrimin e të drejtës së tij si pronar legjitim i pasurisë së paluajtshme për të përfituar frutet civile të sendit në pronësi të tij, në kuptim të neneve 145⁹¹ dhe 151 të Kodit Civil⁹².

28.35 Subjekti parashtron se, sipas tij, nuk ka asnjë ndalim ligjor që një prokuror, të cilit ligji nuk i ka ndaluar mundësinë që të jetë pronar (ortak, aksioner) i një shoqërie tregtare të ketë ndalimin për të vendosur nëse do të duhet të përfitojë ose jo frutet civile që i rrjedhin nga sendi që është në pronësi të tij. Subjekti ka theksuar se disponimi mbi miratimin e rezultatit financiar dhe shpërndarjen e fitimit është vendimmarrje që është e lidhur ngushtësisht vetëm me cilësinë e pronarit të kuotës apo aksionit, pasi disponohet për fitimin që i takon të marrë si dividend nga shoqëria, fitim ky që nuk është asgjë tjetër veçse fryti civil që i takon vetëm pronarit të kuotave/aksioneve në kapitalin themeltar të shoqërisë, pavarësisht statusit të tij në shoqëri, pasiv apo aktiv. Këto veprime janë bërë publike dhe janë pasqyruar korrektësisht në regjistrat publikë, si dhe nuk japin asnjë *indicie*, që në cilësinë e subjektit të rivlerësimit të jetë përpjekur për të kryer veprime aktive ose mosveprime, me qëllim fshehjen e kryerjes së këtyre veprimeve apo manipulimin e tyre.

28.36 Sipas subjektit ai ka vlerësuar dhe ka qenë i bindur që për të gjithë sjelljen e tij nga viti 2014 deri në vitin 2016, por edhe me pjesëmarrjen e tij në Mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve në datat 25.7.2017 10.2.2019, nuk ka qenë në rastet e konfliktit të interesit, nuk ka shkelur asnjë normë ligjore me karakter urdhërues, nuk ka kryer asnjë veprim që vërteton drejtimin dhe administrimin efektiv dhe aktiv të shoqërisë “***” sh.p.k., pasi këto detyra sipas ligjit i janë besuar dhe janë kryer në mënyrë *de facto* dhe *de jure* nga administratori i shoqërisë. Subjekti ka kërkuar që Komisioni të mbajë në konsideratë parimin e “Mosdënimit pa ligj”, të garantuar nga neni 7 i KEDNJ-së (i cili aplikohet edhe në procedurën e dhënies së masave administrative), duke kërkuar të sjellë në vëmendje të Komisionit, interpretimet e GJEDNJ-së në lidhje me “Parashikueshmërinë” e dispozitës ligjore që pretendohet se është shkelur.

28.37 Subjekti është shprehur edhe në raport me qëndrimin e ILDKPKI-së prej kohës kur është krijuar shoqëria tregtare, periudhë që njëkohësisht ai ka qenë subjekt deklarimi, duke theksuar se nuk i është bërë me dije dhe as nuk është thirrur për t’iu evidentuar fakti se është në kushtet e shkeljes së ligjit.

28.38 Subjekti, mbi shpjegimet e dhëna, vlerëson se zyrtarët publikë, njësoj si edhe shtetasit e tjerë të Republikës, gëzojnë të drejta të barabarta për të jetuar normalisht si njerëz të lirë të një shoqërie dhe se

⁹⁰https://www.unodc.org/documents/nigeria/publications/Otherpublications/Commentry_on_the_Bangalore_principles_of_Judicial_Conduct.pdf

⁹¹ Në të cilin parashikohet qartësisht se: “*Frutat natyrore të një sendi janë produktet që nxirren prej tij. Derisa nuk janë ndarë nga sendi, ato janë pjesë përbërëse e tij. Frutat civile nxirren nga sendet si rrjedhojë e gëzimit të të drejtave që kanë personat mbi to. Frutat civile fitohen në bazë të kohëzgjatjes së të drejtave dhe kur këto janë bërë të kërkueshme*”.

⁹² Në të cilin parashikohet qartësisht se: “*Pronarit të sendit i takojnë frutat natyrore që prodhon sendi, përveç kur pronësia e tyre u është kaluar të tjerëve. Në këtë rast pronësia fitohet pasi frutat të jenë ndarë nga sendi. Personi që merr frutat duhet që brenda vlefës së tyre të shpërblejë shpenzimet e bëra për prodhimin dhe vjeljen e tyre*”.

kufizimi i ushtrimit të funksioneve publike nuk mund të shikohet thjesht bardh e zi, por duhet të vlerësohet në atë drejtim dhe në atë masë sa të justifikojë vendosjen e kufizimit.

28.39 Subjekti ka theksuar qëllimin e ligjvënësit në përcaktimin e rregullave të sjelljes apo kufizimit të ushtrimit të funksionit për zyrtarët publikë, në veçanti të atyre që janë në funksionin e prokurorit apo të gjyqtarit, i cili sipas tij nuk ka si qëllim kryesor kufizimin e tyre për të pasur një situatë faktike të tillë (pra t'u ndalojë atyre që të kryejnë një apo disa detyra njëkohësisht), por ka si qëllim që të japë garanci se zyrtarët publikë nuk do të përdorin funksionin e tyre, për të krijuar të mira materiale ose të ndryshme nga ato materiale, nëpërmjet cenimit të interesit publik dhe të interesave të ligjshme të subjekteve privatë.

28.40 Argumentin e tij subjekti e lidh edhe me masën administrative që jepet në raste të tilla, e cila sipas tij duhet të jetë proporcionale, në përputhje me shkeljen e kryer, si dhe duke mbajtur në konsideratë qasjen e sjelljes së subjektit që ka kryer shkeljen. Subjekti ka kërkuar që Komisioni t'i referohet disa vendime të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit⁹³, me qëllim kufizimin e vlerësimit në gjetje që kanë nevojë “për t'i tërhequr vëmendjen” apo “për ta këshilluar atë”, për të mos i përsëritur ato në të ardhmen.

28.41 Në përfundim të parashtrimeve të tij, subjekti është shprehur se pjesëmarrja e tij si ortak në një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, duke filluar nga viti 2014, nuk ka ndikuar në asnjë rast apo moment në pavarësinë e tij si magjistrat dhe ushtrimin e detyrës së prokurorit. Kjo pjesëmarrje, cilësia e ortakut në shoqërinë tregtare, nuk ka qenë e ndaluar nga ligji në kohën e themelimit të shoqërisë tregtare “****” sh.p.k. dhe po ashtu, më pas, është lejuar dhe rregulluar shprehimisht nga ligjvënësi, duke filluar nga viti 2016 me kufizimet përkatëse, të cilat, të analizuara si më lart, sipas tij janë respektuar gjithmonë me synimin kryesor të mungesës së ekzistencës së konfliktit të interesit dhe moscenimit të pavarësisë në ushtrimin e detyrës.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe kuadrin ligjor të zbatueshëm

28.42 Trupi gjykues, në çështjen objekt vlerësimi, ka analizuar situatën faktike-ligjore në raport me kuadrin ligjor rregullues: ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjin nr. 8737, datë 12.2.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjin nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për konfliktin e interesit...”, i ndryshuar; ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 7; ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni 68 e vijues; Komentarin mbi Parimet e Sjelljes Gjyqësore të Bangalores 2007, paragrafi 169 “Aktivitetet financiare”; urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. 141, datë 19.6.2014, “Për miratimin e rregullave etike dhe të sjelljes së prokurorëve”; vendimin e KLP-së nr. 32, datë 24.2.2022, “Për miratimin e standardeve etike dhe rregullave të sjelljes së prokurorëve”; si dhe standardet e përgjithshme ndërkombëtare mbi sjelljen dhe etikën e prokurorëve.

28.42.1 Bazuar në vlerësimin e fakteve dhe provave të dala përgjatë hetimit, trupi gjykues çmon të pabazuar interpretimin/qasjen e kuadrit ligjor nga ana e subjektit kundrejt pozitës së tij në këtë veprimtari tregtare, e cila ka prodhuar një mospërputhje thelbësore me funksionin e prokurorit dhe detyrimet ligjore të magjistratit në lidhje me etikën.

28.42.2 Trupi gjykues, interpretimin e subjektit lidhur me organizimin, përgjegjësinë e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, sipas ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, e gjen të pabazuar në ligj e fakte. Referuar ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe

⁹³ Nr. *** dhe nr. 35/2021.

shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni 68 e në vijim të tij, parashikohet qartazi funksionimi i shoqërive me përgjegjësi të kufizuara, organet e tyre drejtuese që janë Asambleja e Aksionerëve (si organi më i lartë vendimmarrës) dhe administratori/ët (si përfaqësues i shoqërisë me të tretët në aktivitetet e përditshme). Ky parashikim ligjor gjendet i materializuar në statutin e shoqërisë “****” sh.p.k., ku, shprehimisht, në nenin 8 të tij përcaktohet se organet drejtuese të shoqërisë janë Asambleja e Aksionerëve, e cila për nga natyra e kompetencave ka rol vendimmarrës lidhur me funksionimin e shoqërisë dhe administratori në rolin ekzekutiv dhe administrativ. Përkatësisht, nenet 9 dhe 10 të këtij ligji parashikojnë të drejtat dhe kompetencat përkatëse të tyre.

28.42.3 Në kushtet që përgjatë hetimit rezultoi e provuar pjesëmarrja e subjektit të rivlerësimit në organe drejtuese të shoqërisë, në cilësinë e ortakut të Asamblesë, duke ndërmarrë vendime për llogari të shoqërisë, trupi gjykues çmon se këto veprime bien ndesh me parashikimin e bërë në neni 39 të ligjit nr. 8737/2001, i ndryshuar, i cili në pikën 4 të tij ka parashikuar: *“Prokurorit i ndalohet të marrë pjesë në organet drejtuese të shoqërive tregtare”*. Veç kësaj ndalese eksplicite, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka njoftuar angazhimin e tij në këtë veprimtari para Prokurorit të Përgjithshëm apo drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në zbatim të neneve 4 dhe 12 të “Rregullave mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve”, miratuar me urdhrin nr. 141, datë 19.6.2014, të Prokurorit të Përgjithshëm të asaj kohe. Në çështjen objekt vlerësimi, trupi gjykues gjen të papranueshëm qasjen ligjore të subjektit kundrejt faktit se kufizimi i përcaktuar në ligj nuk ka vetëm lidhje me ndalimin e pjesëmarrjes në mënyrë aktive në organet drejtuese të shoqërisë, por ai do të kufizonte edhe mbrojtjen e të drejtave themelore kushtetuese, si të drejtën e pronës. Mbrojtja dhe gëzimi i së drejtës pronësore në këtë rast është rrjedhojë e një situatë të krijuar përgjatë ushtrimit të detyrës në kundërshtim me një kuadër të plotë ligjor. Për efekt të këtij procesi, trupi gjykues çmon se faktet provuese të dala përgjatë hetimit, të parashtruara më sipër, dëshmojnë qartazi sjellje të subjektit në mospërmbushje të detyrimeve ligjore të magjistratit.

28.42.4 Nga ana tjetër, në kuptim të nenit 5 të ligjit nr.9367/2005, ku parashikohet: *“Interesat privatë të zyrtarit janë ata interesa që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga: a) të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloj natyre; b) çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile; c) dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale; ç) negocime të mundshme për punësim në të ardhmen nga ana e zyrtarit gjatë ushtrimit të funksionit apo negocime për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat për zyrtarin, pas lënies së detyrës, të kryer nga ai gjatë ushtrimit të detyrës; d) angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie, që krijon të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, krijimi/fitimi i të ardhurave nga shpërndarja e dividendit çmohet nga trupi gjykues si rrethanë që përfshihet në interesat privatë të zyrtarit që, për rrjedhojë, krijojnë premisë për ekzistencën e gjendjes së konfliktit të interesit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në këtë rast të subjektit të rivlerësimit.*

28.42.4.a Në çështjen objekt vlerësimi, trupi gjykues nuk i gjen bindëse shpjegimet e subjektit se kuadri ligjor krijon dykuptimësi. Ajo që keqinterpretohet nga ana e subjektit në këtë rast është fakti se për sa kohë ligji organik nr. 8737, datë 12.2.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ndalonte subjektin të kryente aktivitet tregtar në pozicionin që ai ka pasur në këtë shoqëri, çka rezultoi tërësisht e provuar, për trupin gjykues është e papranueshme dhënia e një interpretimi ligjor ndryshe nga subjekti për këtë situatë, pasi nuk i përgjigjet frymës dhe qëllimit të dispozitave ligjore që rregullojnë veprimtarinë e prokurorit, duke arsyetuar se:

28.42.4.b Qëllimi i ligjvënësit në ligjin organik të sipërcituar, i cili ka parashikuar ndalime ligjore për subjektet që ushtrojnë detyrën e prokurorit për të mos pasur veprimtari aktive në fushën tregtare, ka qenë pikërisht që këta subjekte, në ushtrimin e funksionit të tyre publik, të garantojnë vendimmarrje të

paanshme, transparente, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut e të besimit të tij, ndaj institucioneve publike, nëpërmjet parandalimit të konfliktit ndërmjet interesave publikë dhe atyre privatë të një zyrtari në ushtrimin e funksioneve të veta. Kjo ndalesë, e parashikuar në mënyrë të qartë dhe pa ekuivoqe, i ndalonte subjektit që të kryente një veprimtari tregtare në formën, rolin dhe funksionin që kjo dispozitë ka parashikuar. Kuptueshmëria dhe zbatimi i qëllimit të ligjit duhet të shihej/kryej bazuar në rregullat mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve, Parimet e Sjelljes Gjyqësore dhe standardet e përgjithshme ndërkombëtare mbi sjelljen dhe etikën e prokurorëve, sikurse do të parashtrohen në vijim në këtë vendim, rast pas rasti.

28.42.4.c Nisur nga fakti se subjekti nuk duhet të kishte ushtruar një veprimtari të tillë tregtare, trupi gjykues, në çështjen objekt vlerësimi, ka konstatuar se kjo pjesëmarrje e subjektit ka vijuar në mospërbushje të detyrimeve ligjore të ligjit nr. 96/2016, duke e ekspozuar atë në rënien në papajtueshmëri të vazhdueshme me detyrën. Në këtë drejtim, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit është në shkelje të shkronjës “a” (për periudhën 2014 – 2016 dhe gjithashtu për periudhën pas vitit 2018), lidhur me përfshirjen aktive në veprimtari ekzekutive në kompaninë “****” sh.p.k. dhe shkronjës “ç” të nenit 7, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, bazuar në faktet provuese të dala nga hetimi, të tilla si:

i) Subjekti nuk aplikoi për të caktuar personin e besuar njëkohësisht me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 96/2016, pasi rezultoi që ky veprim ishte ndërmarrë në datën 26.3.2018, pra rreth 18 muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2016;

ii) Subjekti, me vendimmarrjen e tij datë 25.7.2017, për miratimin e pasqyrave financiare të shoqërisë për vitin 2016, ka vepruar si zotërues aktiv i aksioneve në kundërshtim me ndalesën e parashikuar në pikën 4 të nenit 7 të ligjit nr. 96/2016, ku citohet: *“4. Magjistratit i ndalohet: ..b) të zotërojë në mënyrë aktive aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit..., pasi ai nuk kishte kaluar në zotërim pasiv të kapitalit deri në datën 26.3.2018”*.

iii) Subjekti, me vendimmarrjen e tij datë 10.2.2019, për shpërndarjen e fitimit për vitet 2015, 2016 dhe 2017, si dividend për ortakët ka vepruar në kundërshtim me ndalesën e parashikuar në nenin 7/4/b të ligjit nr. 96/2016, për shkak se ai kishte kaluar në zotërim pasiv të kapitalit që me marrëveshjen datë 26.3.2018, marrëveshje e cila ka parashikuar që veprimet e tjera, me përjashtim të së drejtës së ortakut pasiv për përfitimin e fryteve civile të pronësisë, duhet të ndërmerreshin nga i besuari.

iv) Subjekti ka qenë në shkelje/kundërshtim me ligjin nr. 96/2016, që ndalon magjistratët të mbajnë aktivisht aksione në kompani private nga viti 2016 deri në vitin 2018, pasi akti/marrëveshja u nënshkrua me personin e besuar në vitin 2018.

28.42.5 Për sa rezultoi, pjesëmarrja e subjektit në këtë veprimtari gjendet nga trupi gjykues në kundërshtim me:

- nenin 149/ç të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
- nenin 4, pika 2, shkronja “b” e ligjit nr. 96/2016, i cili parashikon se: *“Magjistrati merr të gjitha masat për të mbrojtur dhe forcuar reputacionin e organeve të drejtësisë dhe besimin e publikut në sistemin gjyqësor dhe atë të prokurorisë”*;
- pikën 4 të nenit 7 të ligjit nr. 96/2016, ku parashikohet: *“4. Magjistratit i ndalohet: b) të zotërojë në mënyrë aktive aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit”*;
- urdhrin nr. 141, datë 19.6.2014, të Prokurorit të Përgjithshëm, *“Për miratimin e rregullave mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve”*. Në nenin 4, pika 1, shkronja “ç” e këtij urdhri, parashikohet:

“Prokurorët në ushtrimin me pavarësi të funksioneve apo detyrave të tyre, duhet që të mos zhvillojnë veprimtari ekonomike, përfshirë çdo lloj pune apo biznesi për të përfituar interesa materiale ose jomateriale, që mund të ndikojnë në pavarësinë e tyre, ose që mund të krijojnë përshtypjen e përdorimit të detyrës për interesat e tyre ose personave të tjerë”;

- Komentarin e Bangalore mbi Parimet e Sjelljes Gjyqësore, i vitit 2007, i cili zbatohet për të gjithë magjistratët, ku në paragrafin 169 parashikohet: *“Gjyqtari ka të njëjtat të drejta si një qytetar i zakonshëm në lidhje me çështjet e tij financiare private, me përjashtim të kufizimeve që kërkohen për mbrojtjen e kryerjes, siç duhet të detyrave të gjyqtarit. Gjyqtari mund të mbajë dhe menaxhojë investime, duke përfshirë pasuritë e paluajtshme dhe të angazhohet në aktivitete të tjera shpërblyese, por nuk duhet të shërbejë si zyrtar, drejtor, partner aktiv, aksioner, menaxher, këshilltar ose punonjës i ndonjë biznesi përveç një biznesi të vogël të mbajtur dhe të kontrolluar nga anëtarët e ngushtë të familjes... Megjithatë, është e papërshtatshme që një gjyqtar të shërbejë në bordin drejtues të një shoqërie (kompanie) tregtare, me fjalë të tjera, një shoqërie/kompanie, objektivi i së cilës është të nxjerrë fitime materiale. Kjo vlen si për shoqëritë publike ashtu edhe për ato private, pavarësisht nëse drejtimi është ekzekutiv apo jo-ekzekutiv dhe nëse shpërblehet apo jo”;*
- Standardet e përgjithshme ndërkombëtare mbi sjelljen dhe etikën e prokurorëve:
 - i) *“Statuti i Romës”, viti 2014⁹⁴, në paragrafin 77, fjalja e 3^ë, ku parashikohet se: “Prokurorët nuk duhet të angazhohen në asnjë aktivitet apo transaksion apo të fitojnë ndonjë pozicion apo funksion, qoftë të paguar apo të papaguar, që është në kundërshtim me kryerjen korrekte të detyrave të tij/saj”;*
 - ii) *“Udhëzimet/normat e Budapestit mbi sjelljen dhe Etikën e Prokurorëve Publik”⁹⁵: pjesa II – sjellja profesionale në përgjithësi, ku parashikohet: ...të mos lejojnë interesat personale ose financiare të prokurorit... të ndikojnë në mënyrë të pahijshme në sjelljen e tij...; pjesa IV – sjellja në jetën private, ku parashikohet se: a. Prokurorët nuk duhet të cenojnë integritetin, drejtësinë dhe paanshmërinë aktuale ose të perceptuar në mënyrë të arsyeshme gjatë shërbimit të tyre dhe me aktivitetet në jetën e tyre private; e. prokurorët nuk duhet... të kryejnë asnjë detyrë që mund të duket se cenon integritetin, drejtësinë dhe paanshmërinë e tyre.*
 - iii) *“Standardet e Përgjegjësisë Profesionale dhe Deklarata e Detyrave dhe të Drejtave Themelore të Prokurorëve”, viti 1999⁹⁶, neni 1/sjellja profesionale, ku parashikohet, prokurorët duhet: të përpiqen të jenë dhe të duken se janë konsistent, të pavarur dhe të paanshëm.*

28.43 Në përfundim, trupi gjykues konkludon se në çështjen konkrete, subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut, pasi ai është ekspozuar në një marrëdhënie ku përfitimet materiale të tij, të cilat buronin nga veprimtaria tregtare, janë tërësisht të varura në vullnetin dhe dëshirën e shoqërisë, lidhur me ushtrimin e aktivitetit tregtar. Pra, ekspozimi i subjektit të rivlerësimit në një lloj marrëdhënieje të tillë me shoqërinë tregtare e ka bërë atë një subjekt që mund të ndikohet në ushtrimin e detyrës së tij në mënyrë të pavarur, për shkak të nevojës së tij për garantimin e përfitimeve materiale nga kjo veprimtari. Në këto rrethana, subjekti i rivlerësimit e ka ekspozuar hapur veten ndaj rrezikut që krijon premisë për rënie në ndikueshmëri lidhur me përmbushjen e detyrave të tij publike. Trupi gjykues çmon se pjesëmarrja e subjektit në këtë veprimtari dhe mbajtja e aksioneve aktive edhe pas ndalimeve ligjore sipas ligjit nr. 96/2016, ka prodhuar një mospërputhje thelbësore me funksionin e prokurorit dhe detyrimet në lidhje me etikën. Në këtë kuptim, bazuar në nenin 61/5 të ligjit nr. 84/2016, rrethanat e kësaj çështjeje në raport me sjelljen e subjektit kundrejt detyrimeve ligjore, konsiderohen nga trupi

⁹⁴ i Këshillit Konsultues të prokurorëve evropianë/ <https://rm.coe.int/168074738b>

⁹⁵ CoE/ Këshillit të Evropës, viti 2005.

⁹⁶ të Shoqatës Ndërkombëtare të Prokurorëve (IAP).

gjykues si fakte të çështjes që janë të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk mund të gëzojë besimin e publikut për të qëndruar në detyrë.

29. Gjatë hetimit ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* llogaritë bankare.

29.1 “Raiffeisen Bank”⁹⁷ informon se subjekti i rivlerësimit ka llogari pranë kësaj banke me gjendje në datën 24.1.2017, në vlerën 28.347,97 lekë.

29.2 “Credins Bank”⁹⁸ informon se subjekti i rivlerësimit ka llogari depozite pranë kësaj banke me gjendje në datën 24.1.2017, në vlerën 6.155.415,12 lekë.

29.3 “Credins Bank”⁹⁹ informon se subjekti i rivlerësimit ka llogari pranë kësaj banke me gjendje në datën 24.1.2017, në vlerën 251.497,34 lekë.

29.4 Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime lidhur me mosdeklarimin e këtyre llogarive në deklaratën *Vetting*, për të cilat subjekti parashtroi se në këtë deklaratë, e cila është depozituar përfundimisht në datën 24.1.2017 pranë ILDKPKI-së, referuar vërtetimit të këtij Inspektorati, të kësaj date, në rubrikën “Angazhime dhe veprimtari private dhe/ose publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre”, tek “Përshkrimi i të ardhurave” ka deklaruar: “Të ardhurat e realizuara nga depozita me afat njëvjeçar për shumën 12.000.000 lekë pranë “Credins Bank”, nga data 23.12.2015, maturuar në datën 23.12.2016, numri i llogarisë së depozitës ***”, interesa të cilat kanë qenë në masën 224.415 lekë.

Subjekti ka deklaruar se kjo llogari bankare, me nr. ***, e cila në datën 23.12.2016 kishte gjendjen prej 12.000.000 lekësh dhe interesat, është deklaruar rregullisht nga ana e tij dhe se në datën 27.12.2016 kjo llogari është pakësuar me vlerën 6.000.000 lekë, për shlyerjen e kredisë bankare nr. ***, datë 7.10.2016, marrë pranë “Credins Bank”, me afat deri në datën 27.12.2016, me interes 4,94%, e cila kishte shërbyer për blerjen e banesës në rrugën “***”, pallati “***”, S.

29.4.1 Subjekti ka theksuar se ndërkohë gjendja e depozitës pranë “Credins Bank”, në vlerën 6.155.415 lekë, e cila i përket të njëjtës llogari bankare/depozita me nr. ***, është deklaruar rregullisht në DPV-në e vitit 2017, dorëzuar në datën 28.3.2018. Subjekti ka sqaruar se gjendja e llogarisë bankare në “Raiffeisen Bank” në vlerën 28.347,97 lekë lidhet me gjendjen e llogarisë bankare të kredisë me kushte lehtësuese, të marrë në vitin 2006, prej 5.000.000 lekësh, për blerjen e banesës në Tiranë.

29.4.2 Në lidhje me gjendjen pranë “Credins Bank”, të vlerës prej 251.497,34 lekësh, subjekti ka sqaruar se ajo është llogaria e pagës së tij si prokuror dhe se gjendja e saj është krijuar për shkak të pagimit të pagës së muajit janar 2017, në momentin e konfirmimit nga kjo bankë në datën 24.1.2017. Subjekti ka konfirmuar se në deklaratën *Vetting* janë deklaruar rregullisht të ardhurat nga pagat dhe shpërblimet si prokuror për periudhën 1.10.2001 – 31.12.2016.

29.5 Trupi gjykues, lidhur me këtë çështje objekt vlerësimi, ka konstatuar se: (i) llogaria në “Credins Bank” është llogari page ku kreditohet paga e subjektit, si dhe llogari depozite e krijuar me të ardhurat e përfituara nga shpërndarja e dividendit; (ii) gjendja e llogarisë në “Raiffeisen Bank” lidhet me kredinë lehtësuese të marrë prej subjektit; (iii) provohet se subjekti ka depozituar dokumentacion mbi llogaritë e tij bankare së bashku me deklaratën *Vetting*, në datën 24.1.2017, pra para se të fillonte procesi i rivlerësimit.

⁹⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 28.5.2021.

⁹⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 22.6.2021.

⁹⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 22.6.2021.

29.6 Për sa është konstatuar më sipër, trupi gjykues çmon se jemi përpara një pasaktësie në deklaram, e cila nuk vlerësohet se ka pasur për qëllim fshehjen e llogarive dhe, për rrjedhojë, konkludon se kjo pasaktësi nuk mund të shërbejë si shkak për penalizimin e tij në këtë proces.

Deklarimi i pasurive të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj. A.M

30. Ambient shërbimi “**”, me sipërfaqe 57.3 m²**, me nr. pasurie ***, z. k. ***, me adresë në S. Blerë me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.8.2008, në shumën 28.650 euro. Burimi i krijimit: dhuratë nga babai N.P, me rastin e martesës (pjesërisht të ardhura nga shitja e banesës në Pogradec dhe pjesërisht të ardhura familjare nga biznesi klinikë dentare në emër të shtetases L.P). Vlera: 28.650 euro. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacionin mbështetës.

Hetimi i Komisionit

30.1 Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në DPV-në e vitit 2008, me përshkrimin “Njësi shërbimi me sip. 57.3 m², me adresë në S, Tiranë, nr. pasurie ***, blerë me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.8.2008, në vlerën 28.650 euro”. Ndërsa, në rubrikën e të dhënave konfidenciale ajo ka deklaruar se burimi i krijimit të pasurisë së paluajtshme (njësi shërbimi me sip. 57.3 m²) me adresë në S, Tiranë, e cila është destinuar për klinikë dentare është një shumë prej 30.000 euro, e dhuruar nga babai i saj N.P me rastin e martesës. Këtë shumë babai e ka përfituar nga shitja e shtëpisë prindërore në S, Pogradec.

30.2 Nga hetimi i kryer Komisionit i rezultoi¹⁰⁰ se me kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.8.2008, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka blerë nga shoqëria “****” sh.p.k., pasurinë njësi me sip. 57.3 m², regjistruar në ZVRPP-në Tiranë me nr. ***, me çmim shitjeje në vlerën 28.650 euro, vlerë e cila thuhet në kontratë se është likuiduar nga pala blerëse jashtë zyrës noteriale.

30.2.i Pasuria konfirmohet me certifikatën për vërtetim pronësie nr. ***, lloji i pasurisë “njësi” me sip. 57.3 m², regjistruar në emër të shoqërisë “****” sh.p.k., datë 31.7.2008, shoqëruar me kartelën e pasurisë e planimetrinë dhe më tej me certifikatën për vërtetim pronësie nr. ***, lloji i pasurisë “njësi” me sip. 57.3 m², regjistruar në emër të shtetases A.M, datë 6.9.2008, shoqëruar me kartelën e pasurisë.

30.3 Edhe ZVRPP-ja Tiranë, me email-in e datës 26.11.2018¹⁰¹ ka konfirmuar se në emër të shtetases A.M (P) rezulton e regjistruar pasuria “njësi” me sip. 57.3 m², regjistruar me nr. ***, z. k. ***, bashkëlidhur ndodhen: kartela e pasurisë së paluajtshme “njësi”, regjistruar me nr. ***, në emër të shtetases A.P; kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.8.2008, me palë shitëse shoqëria “****” sh.p.k. dhe palë blerëse A.P, të pasurisë njësi me sip. 57.3 m². Çmimi i shitjes së njësisë në vlerën 28.650 euro; certifikatë për vërtetim pronësie datë 31.7.2008, si dhe kartela e pasurisë së paluajtshme datë 12.5.2018, në emër të shoqërisë “****” sh.p.k.

30.4 Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie

Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se si burim krijimi për këtë pasuri ka shërbyer:

- dhuratë nga babai N.P me rastin e martesës pjesërisht të ardhura nga shitja e banesës në Pogradec;
- pjesërisht të ardhura familjare nga biznesi klinikë dentare në emër të shtetases L.P.

30.5 Subjekti, pasi është pyetur¹⁰² në lidhje me shumën 30.000 euro, të dhuruar nga vjehri i tij N.P për të bijën, bashkëshorten A.M, ka deklaruar se si burim krijimi kanë shërbyer pjesërisht të ardhurat nga

¹⁰⁰ Aneks nr. 4/11 në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁰¹ Aneks nr. 30, në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁰² Me pyetësorin nr. 3, datë 23.2.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

shitja e apartamentit në Pogradec, në datën 18.6.2008, kundrejt vlerës 2.357.000 lekë, siç rezulton nga kontrata e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., lidhur përpara noterit Th. B, zyra e noterisë Pogradec. Pjesa tjetër është mundësuar nga të ardhurat që familja e vjehrrit të tij ka realizuar nga aktiviteti i mjekut stomatolog, “****”, i ushtruar nga vjehrra, shtetasja E. (L.) P, duke filluar nga viti 1993 dhe deri në vitin 2003 në qytetin e Pogradecit dhe më pas, duke filluar nga viti 2003, në qytetin e Tiranës. Në lidhje me të ardhurat e realizuara si stomatologe nga shtetasja E.P, për ato të realizuara gjatë 10 viteve në qytetin e Pogradecit (1993 – 2003), për shkak të kohës së gjatë, subjekti ka deklaruar se është objektivisht e pamundur të gjenden dokumente provuese të fitimit të realizuar prej saj në ato vite. Nga ana tjetër, në lidhje me të ardhurat e realizuara në qytetin e Tiranës, nga data 1.1.2003 e në vijim, subjekti ka depozituar shkresën nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Tiranë, datë 3.3.2023, për të cilën sqaron se nëpërmjet aktit provohet se në vitet 2003 – 2006 qarkullimi i realizuar nga personi fizik “E (L) P” me NIPT ***, ka qenë në vlerat 3.000.000 – 4.000.000 lekë dhe në vitet 2007 – 2008 në vlerat 4.000.000 – 5.000.000 lekë.

- Komisioni hetoi për secilin nga burimet e cituara lidhur me ligjshmërinë e tyre.

30.6 Lidhur me të ardhurat e siguruara nga shitja e banesës në Pogradec

30.6.i Nga hetimi i kryer rezultoi se sipas deklaratës noteriale¹⁰³ nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.3.2009, dhënë nga shtetasi N.P, babai i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, konfirmohet dhurimi i bërë vajzës së tij A.P, i shumës 30.000 euro për blerjen e një njësie shërbimi “****”, me sip. 57.5 m². Po në këtë deklaratë, dhuruesi ka deklaruar se këtë vlerë ai e ka përfituar nga shitja e banesës së tij në S, Pogradec.

30.6.ii Komisioni hetoi në lidhje me ekzistencën e shtëpisë, nga e cila janë krijuar të ardhurat e dhuruara dhe nga dokumentacioni i administruar rezultoi se babai i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, së bashku me nënën e bashkëshortes së subjektit, znj. L.P dhe vëllanë e saj A.P (përfaqësuar me prokurë nga shtetasi N.P), me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.6.2008, i kanë shitur shtetasit G.C pasurinë nr. ***, trull me sip. 328 m² dhe ndërtesë 64 m², ndodhur në z. k. ***, B, Pogradec, kundrejt çmimit 2.357.000 lekë, vlerë kjo e paguar para redaktimit të kontratës, sikurse cilësohet në kontratë.

30.6.iii Subjekti depozitoi dokumentacion¹⁰⁴ lidhur me pagesën e tatimit në burim për të ardhurat e siguruara nga kjo shitje. Ai ka depozituar pasqyrën llogaritëse të tatimit për kalimin e të drejtës së pronësisë, nga ku ZVRPP-ja Pogradec në atë kohë ka përlllogaritur masën e tatimit që duhet të paguhej nga shitësi (shtetasi N.A.P), në vlerën 141.554 lekë. Pagesa është kryer nga shitësi N.P, sipas mandatarëtimit nr. ***, datë 9.12.2009, në vlerën 141.554 lekë.

30.6.iv Në analizë të kontratës së shitjes, e cila për nga forma, por edhe nga pasojat e prodhuara rezulton konform legjislacionit civil, pasi ka parashikuar palët kontraktore dhe objektin, ka përcaktuar vlerën e shitjes së pasurisë, si dhe është nënshkruar me vullnetin e lirë të palëve, Komisioni nuk konstatoi problematika për të ardhurat e përfituara nga kjo shitje, identifikuar si një ndër burimet e krijimit të kësaj pasurie.

30.7 Lidhur me të ardhurat familjare nga biznesi “klinikë dentare”, në emër të shtetasës L.P

30.7.i Komisioni hetoi për ekzistencën e aktivitetit privat në emër të vjehrrës së subjektit, si dhe për fitimin e realizuar prej këtij aktiviteti. Nga hetimi rezultoi se:

¹⁰³ Aneks nr. 4/11 në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁰⁴ Pyetësor nr. 5, datë 20.3.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

- QKB-ja¹⁰⁵ informon se L.P figuron e regjistruar si person fizik me NIPT ***. Sipas ekstraktit historik të regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit tregtar “****” rezultoi se subjekti është regjistruar si person fizik me NIPT ***, në datën 11.4.1994, me aktivitet “****”, me vendndodhje në Tiranë dhe me status aktiv.

- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve¹⁰⁶ informon se L.S.P rezulton të ketë ose të ketë pasur aktivitet ekonomik të regjistruar në emër të saj.

30.7.ii Bazuar në shkresën¹⁰⁷ e Bashkisë Tiranë, rezulton se subjekti “****”, person fizik, me NIPT *** dhe kod vendor ***, figuron i regjistruar nga viti 2003 me objekt veprimtarie “****”, në adresën: rruga “****”, L.

30.7.iii Për periudhën e analizuar rezulton se për vitet 2003 – 2006, qarkullimi i aktivitetit ka qenë 3-4 milionë lekë, ndërsa për vitet 2007 – 2008 qarkullimi i aktivitetit ka qenë 4-5 milionë lekë, si dhe janë paguar detyrimet e taksave dhe tarifave vendore.

- Komisioni nuk konstatoi problematika mbi ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtyre të ardhurave, për sa kohë ato vijnë nga aktiviteti tregtar dhe për to janë paguar detyrimet tatimore.

30.8 Gjatë hetimit rezultoi¹⁰⁸ se vjeherri i subjektit të rivlerësimit ka investuar në blerjen e një pasurie të paluajtshme në vitin 2003. Drejtoria Vendore e Kadastrës - Tirana Veri ka depozituar kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.3.2003, me palë shitëse A dhe M.K dhe palë blerëse N.P, me objekt “Blerje apartamenti në çmimin 3.400.000 lekë”. Komisioni, në përlllogaritjen e të ardhurave të familjes P, e mbajti në konsideratë këtë fakt.

30.9 Komisioni, lidhur me qarkullimin e realizuar nga E.P, person fizik (nëna e bashkëshortes) për vitet kur qarkullimi ka qenë 3-4 milionë, vlerësoi të marrë në konsideratë vlerën 3.500.000 lekë dhe në vitet kur ka qenë 4-5 milionë vlerësoi të marrë në konsideratë vlerën 4.500.000 lekë. Për vitin 2003, Komisioni e ka përlllogaritur qarkullimin e realizuar pas datës së investimit në pasurinë e paluajtshme, ndërsa për vitin 2008 është përlllogaritur deri në muajin korrik, pasi më 7.8.2008 është blerë pasuria ***. Komisioni, në pamundësi për të përcaktuar qarkullimin e realizuar për çdo muaj, e ka ndarë atë në mënyrë të barabartë për secilin muaj. Lidhur me fitimin e realizuar, Komisioni, nisur edhe nga eksperiencia në raste të ngjashme¹⁰⁹, ka aplikuar një marzh fitimi prej 70% dhe nga përlllogaritjet rezultoi se fitimi i mundshëm për periudhën prill 2003 – korrik 2008 ishte në shumën 14.175.000 lekë.

30.10 Sa më sipër, rezultoi se familja P. për periudhën prill 2003 – korrik 2008 ka pasur në dispozicion shumën 16.532.000 lekë, nga e cila 14.175.000 lekë nga aktiviteti dhe 2.357.000 lekë nga shitja e pasurisë në B, Pogradec. Kjo shumë është më se e mjaftueshme për të mbuluar dhurimin prej 30.000 euro ndaj vajzës së tyre, bashkëshortes së subjektit.

30.11 Komisioni kreu analizën financiare për vitin 2008, periudhë kur është investuar në pasurinë klinikë dentare dhe nga përlllogaritjet nuk i rezultoi ndonjë problematikë apo pamundësi financiare.

31. Apartament banimi me sipërfaqe 66.4 m² (zonë e pamenaxhuar) me adresë Rruga ***, porositur në datën 17.2.2015, blerë me kontratën nr. *** rep., nr. ***kol., datë 12.7.2016, në shumën 40.150 euro. Burimi i krijimit: të ardhurat e realizuara nga klinika dentare. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacionin mbështetës.

¹⁰⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 27.5.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

¹⁰⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 25.5.2021, depozituar nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 3, datë 20.2.2023.

¹⁰⁷ Nr. *** prot., datë 3.3.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

¹⁰⁸ Sipas shkresës nr. *** prot., datë 29.6.2021, të ASHK-së, Drejtoria Vendore Tirana Veri, administruar në dosjen e Komisionit.

¹⁰⁹ Referuar vendimit nr. ***, datë 12.10.2021, të Kolegjit.

Hetimi i Komisionit

31.1 Subjekti i rivlerësimit e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në DPV-në e vitit 2015, me përshkrimin “Prenotim apartament banimi me sip. 73 m², në Rugën ***, kontrata e porosisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.2.2015, në vlerën 40.150 euro. Vlera e paguar: 35.000 euro”.

31.2 Ndërsa në DPV-në e vitit 2016, në rubrikën e detyrimeve financiare, subjekti deklaroi: “*Shlyer detyrimi i mbetur në shumën 5.150 euro për blerjen e apartamentit, deklaruar në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë 2015*”.

31.3 Nga hetimi i Komisionit rezultoi se ASHK/Drejtoria Vendore Tirana Jug¹¹⁰ konfirmon se kjo pasuri është blerë me kontratën e shitjes nr. ***, datë 12.7.2016, në vlerën 40.150 euro. Nga dokumentacioni i administruar konfirmohet se në emër të shtetas A.M rezultoi e regjistruar pasuria apartament me sip. 66.4 m², regjistruar me nr. ***, z. k. ***. Praktika ka të administruar mandatpagesat bankare nga shtetasja A.M në favor të ZVRPP-së Tiranë për regjistrim të pasurisë, kartelën e pasurisë së paluajtshme apartament, me sip. 66.4 m², me vendndodhje në Rugën ***, Tiranë, regjistruar në emër të shtetas A.M, kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.7.2016, nënshkruar ndërmjet palës shitëse “****” dhe palës blerëse A.M, të pasurisë apartament me sip. 66.4 m², regjistruar me nr. ***, z. k. ***, kundrejt shumës 40.150 euro, dokumentacionin ligjor të pasurisë së regjistruar në emër të shoqërisë “****” sh.p.k., kontratën e porosisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.2.2015, nënshkruar ndërmjet palës porositëse A.M dhe palës sipërmarrëse shoqëria “****” sh.p.k., të një apartamenti me sip. 73 m², kundrejt çmimit 40.150 euro.

31.4 Subjekti, pasi është pyetur në lidhje me mospërputhjen e sipërfaqes së apartamentit, ka deklaruar se është porositur fillimisht me kontratën e porosisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.2.2015, lidhur përpara noterës M.S (Dhoma e Noterisë Tiranë), me porositës bashkëshorten A.M dhe sipërmarrës shoqërinë “****” sh.p.k. Më pas, ka deklaruar subjekti, në datën 12.7.2016, midis palëve është lidhur kontrata e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., përpara të njëjtit noter publik. Referuar kontratave dhe akteve të vërtetimit të pronësisë mbi këtë apartament, rezultoi se sipërfaqja e tij është përshkruar 73 m², pasi vetë apartamenti ka një sipërfaqe prej 66.4 m² dhe njëkohësisht 6.6 m² përfaqëson sipërfaqe të përbashkët. Ky fakt rezultoi si nga vërtetimi nga dokumentet hipotekore, datë 31.3.2016, lëshuar nga ZVRPP-ja Tiranë, në emër të shoqërisë “****” sh.p.k., por edhe nga vërtetimi nga dokumentet hipotekore, datë 19.7.2016, lëshuar po nga ZVRPP-ja Tiranë në emër të blerësit, bashkëshortes A.M. Po ashtu, ky fakt, pra që apartamenti ka një sipërfaqe bruto prej 73 m², e përbërë nga sipërfaqja neto e tij prej 66.4 m² dhe sipërfaqja e përbashkët prej 6.6 m², detajohet qartë në nenet 1 dhe 3 të kontratës së shitjes nr. ***, datë 12.7.2016.

31.5 Subjekti ka depozituar kontratën e porosisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.2.2015, lidhur përpara noterës M.S dhe kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.7.2016, lidhur përpara të njëjtës notere. Nga dokumentacioni i depozituar konfirmohet pasuria, çmimi i shitjes së saj 40.150 euro, si dhe mënyra e pagesës.

31.6 Në lidhje me pagesat e kryera subjekti ka depozituar *statement* bankar të kësaj shoqërie në “Tirana Bank”, nga ku rezultojnë pagesat e kryera për këstet e kontratës, në datën 17.2.2015 – 20.000 euro; 23.6.2015 – 5.000 euro; 8.10.2015 – 5.000 euro; 29.1.2016 – 5.000 euro dhe në datën 8.2.2016 – 5.000

¹¹⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 31.5.2021, administruar në dosjen e Komisionit dhe nga dokumentacioni i administruar me *email-in* e datës 26.11.2018, administruar në dosjen e ILDKPKI-së, aneks nr. 30 në dosjen e ILDKPKI-së.

euro, për vlerën totale prej 40.000 euro, duke u paguar një pjesë fare e vogël e mbetur prej 150 euro në formën *cash*.

31.7 Po ashtu, subjekti, pasi është pyetur¹¹¹ ka deklaruar se pagesa e shlyer prej tij kundrejt shoqërisë “****” sh.p.k. në shumën 10.000 euro, në tetor të vitit 2015, referuar *statement*-it (ekstraktit të llogarisë) të këtij subjekti në “Tirana Bank”, konkretisht në datën 8.10.2015, ka qenë në vlerën 5.000 euro, e kryer nga bashkëshortja e tij A.M, në favor të shoqërisë “****” sh.p.k., ka sqaruar se në deklarin e tij ka konstatuar se i është referuar dy mandatave që posedon, të pagesës së bashkëshortes së tij në “Tirana Bank” në datën 8.10.2015, por të cilat nga akti që ka depozituar përfaqësojnë të njëjtin mandat, të pagesës prej 5.000 euro, me përshkrimin “Pagesë kësti apartamenti *** rep., *** kol., datë 17.2.2015”, ku, thekson ai, njëri prej tyre i nënshkruar dhe tjetri jo. Pra, sqaron subjekti, shuma prej 10.000 euro përbën lapsus, në fakt në muajin tetor 2015 rezultojn të jetë paguar vetëm shuma 5.000 euro, sipas pagesave të përcjella edhe në përgjigjet e pyetësorit nr. 2.

31.8 Subjekti ka depozituar¹¹² edhe librezën e pagesave për furnizimin me energji elektrike për këtë pasuri. Nga verifikimi përkatës librezat rezultojn ende në emër të shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k. Gjithashtu, po nga verifikimi përkatës për këtë pasuri konfirmohet kontrata e FSHU-së me nr. *** dhe njëkohësisht konfirmohen pagesa edhe për vitin 2023.

31.9 Komisioni hetoi në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie

31.9.i Lidhur me të ardhurat nga klinika dentare, Komisioni i ka trajtuar ato dhe nuk ka konstatuar problematika për sa i përket ligjshmërisë së tyre.

31.10 Sa i përket likuidimit të kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DPV-në e vitit 2015 se ka paguar 35.000 euro dhe në DPV-në e vitit 2016 se ka paguar diferencën prej 5.150 euro. Gjithashtu, subjekti ka depozituar *statement* bankar të shoqërisë “****” sh.p.k. në “Tirana Bank”, nga ku rezultojnë pagesat e kryera nga bashkëshortja e tij, paraqitur në tabelën si vijon:

Tabela nr. 2

Data	Shuma e paguar në euro	Përshkrimi i transaksionit
17.2.2015	20,000	A.M derdh në “Tirana Bank”, llog. e ***
12.6.2015	5,000	A.M derdh në “Tirana Bank”, llog. e ***
8.10.2015	5,000	A.M derdh në “Tirana Bank”, llog. e ***
29.1.2016	5,000	A.M derdh në “Tirana Bank”, llog. e ***
8.2.2016	5,000	A.M derdh në “Tirana Bank”, llog. e ***
	150	<i>Cash</i> në arkën e shoqërisë

31.11 Sa më sipër, rezultoi se subjekti ka paguar 30.000 euro në vitin 2015 dhe 10.150 euro në vitin 2016. Nga hetimi konstatohet se diferenca vjen për faktin se njëri nga këstet prej 5.000 euro është paguar më 29.1.2016, përpara dorëzimit të deklaratës periodike vjetore. Komisioni i ka pasqyruar likuidimet në analizën financiare sipas vitit përkatës.

31.12 Komisioni ka arsyetuar më sipër për sa i përket gjendjes së likuiditeteve *cash*, të cilat në fund të vitit 2014 kanë qenë në vlerën 15.000.000 lekë. Kjo shumë ka qenë e mjaftueshme për të investuar në

¹¹¹ Me pyetësorin nr. 3, datë 20.2.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

¹¹² Me pyetësorin nr. 4, datë 10.3.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

blerjen e pasurisë së paluajtshme, si dhe për kryerje të investimeve të tjera nga subjekti i rivlerësimit përgjatë vitit 2015.

31.13 Lidhur me kështet e paguara gjatë periudhës janar – shkurt 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se janë paguar me kursimet *cash*. Trupi gjykues ka arsyetuar më sipër, lidhur me ligjshmërinë e shumës 10.000.000 lekë, deklaruar nga subjekti si hua e shlyer në favor të tij nga vëllai A.M, shumë e cila nuk u konsiderua si e ardhur e subjektit.

31.14 Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare në shumën 1.372.991 lekë të paguajë kështet e fundit të kësaj pasurie në shumën 10.150 euro. Në total, në fund të muajit shkurt 2016, trupit gjykues i rezultoi se subjekti është në pamundësi financiare në shumën 6.271.512 lekë¹¹³ të investojë në blerjen e dy pasurive të paluajtshme, duke u gjendur në kushtet e parashikuara në shkronjën “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

31.15 Komisioni hetoi në lidhje me ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm të interesit midis subjektit të rivlerësimit, për shkak të funksionit të tij, shoqërisë ndërtimore dhe administratorëve të saj.

31.15.1 Subjekti, në përgjigje të pyetësorit, ka deklaruar se për shoqërinë “****” sh.p.k. nuk ka hetuar, pushuar, mosfilluar apo dërguar për gjykim ndonjë çështje penale ndaj kësaj shoqërie apo të vënë në lëvizje prej saj. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se në lidhje me shtetasit M.D dhe V.D, në datën 30.12.2021, ka disponuar si prokuror me vendim “Për mosfillimin e procedimit penal” për kallëzimin penal të paraqitur nga shtetasi M.L, për veprën penale “mashttrim”, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal, për shkak të parashkrimit të afatit për ushtrimin e ndjekjes penale, sipas përcaktimeve të nenit 66 të Kodit Penal, në kushtet kur fakti pretendohet të kishte ndodhur 17 vjet më parë, konkretisht në vitin 2005.

31.15.2 Subjekti ka depozituar dokumentacionin provues nga prokuroritë e rretheve ku ka ushtruar detyrën, nga ku vërehet se subjekti ka deklaruar me vërtetësi. Po ashtu, subjekti ka depozituar kopjen e praktikës¹¹⁴ me të cilën është trajtuar kallëzimi penal i cituar më sipër për të cilin subjekti ka marrë vendimin “Për mosfillimin e procedimit penal”, datë 30.12.2021.

31.15.3 Nga verifikimi përkatës rezulton se subjekti ka hetuar këtë çështje disa vite pas blerjes së pasurisë nga bashkëshortja e tij dhe ndërkohë nga analizimi i praktikës duket se vendimmarrja ka qenë e mbështetur në ligj.

31.16 Për sa më sipër, nuk konstatohet ndonjë gjendje e konfliktit të interesit ndaj subjektit të rivlerësimit sipas parashikimeve të legjislacionit të fushës.

32. Tokë bujqësore në bashkëpronësi, me sipërfaqe 3.250 m² (fshati B, Bashkia Pogradec), marrë sipas ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991. Pjesa takuese: ¼. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës¹¹⁵ vërtetimin datë 6.4.2011, lëshuar nga Komuna B për familjen e z. N.P me banim në fshatin B, është trajtuar me tokë sipas ligjit nr. 7501 “Për tokën”, me sipërfaqe gjithsej 3.250 m². Numri i aktit të marrjes në pronësi është ***.

¹¹³ 4.898.521 lekë për pasurinë duplex te “****” sh.p.k. dhe 1.372.991 lekë për të paguar kështet e fundit për pasurinë - apartament të blerë nga shoqëria “****” sh.p.k. (6.000.000 lekë gjendja *cash* në fund të vitit 2015 – 10.898.521 lekë vlera e pasurisë duplex + garazh blerë te shoqëria “****” sh.p.k. – 1.372.991 lekë kështet e fundit për apartamentin e blerë nga shoqëria “****” sh.p.k.).

¹¹⁴ Ndërkohë Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka depozituar të njëjtën kopje me shkresën përcjellëse nr. *** prot., datë 22.11.2022.

¹¹⁵ Referojuni aneksit nr. 4/13 në dosjen e ILDKPKI-së.

32.1 Komisioni hetoi në lidhje me ekzistencën e kësaj pasurie dhe mënyrën e fitimit të saj. Nga dokumentacioni i administruar¹¹⁶ kjo pasuri konfirmohet me AMTP-në me numër të regjistrimit të aktit ***, datë 28.12.1992, e ndodhur në fshatin B/Pogradec, me kryefamiljar z. N.P.

32.2 Sipas certifikatës së përbërjes familjare të muajit gusht 1991¹¹⁷, rezulton se bashkëshortja e subjektit është pjesë e familjes bujqësore dhe sipas përbërjes familjare ajo zotëron ¼ e pasurisë.

32.3 Për sa më sipër, trupit gjykues nuk i rezultuan problematika në lidhje me ekzistencën e kësaj pasurie dhe gjithashtu u konstatua se pasuria është deklaruar nga subjekti me vërtetësi dhe saktësi.

33. Të ardhura nga qiraja e apartamentit në Rrugën ***, dhënë me kontratën e qirasë nr. *** rep., *** kol., datë 16.2.2016. Të ardhurat janë derdhur nga qiradhënësi në “Raiffeisen Bank” në numrin e llogarisë *** në shumën 3.982,14 euro. Tatimi i fitimit do të paguhet në momentin e daljes së formularit të pagesës nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve në muajin mars 2017. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës¹¹⁸ kontratën e qirasë së pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol, datë 16.2.2016, me palë qiradhënëse A.M dhe palë qiramarrëse D.M për pasurinë paluajtshme apartament, ndodhur në Rrugën ***, me sipërfaqe totale 73 m², me afat 1-vjeçar, nga data 16.2.2016 deri më 16.2.2017, në vlerën e qerasë 300 euro/muaj. Në kontratë konfirmohet se pagesa do të kryhet nëpërmjet llogarisë bankare, për të cilën subjekti ka depozituar nxjerrjen e llogarisë në emër të shtetases A.M pranë “Raiffeisen Bank”, për datën 31.12.2016.

33.1 Nga korrespondenca e Komisionit me Ministrinë e Drejtësisë¹¹⁹ dhe noterin publik¹²⁰, ky i fundit ka vendosur në dispozicion kontratën e qirasë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.2.2016, me palë qiradhënëse A.N.M dhe palë qiramarrëse D.I.M. Kontrata është me afat 1-vjeçar, afat i cili mund të përsëritet. Vlera e qirasë është 300 euro/muaj, nga e cila janë dhënë një muaj paradhënie dhe dy muaj depozitë.

33.2 Nga korrespondenca e Komisionit me “Raiffeisen Bank”¹²¹ rezulton se në llogarinë e bashkëshortes së subjektit është kredituar nga shtetasi D.I.M shuma 4.000 euro, përgjatë periudhës prill – nëntor 2016.

33.3 Gjatë hetimit¹²² rezultoi se bashkëshortja e subjektit i ka deklaruar të ardhurat nga qiraja në deklaratën individuale vjetore të të ardhurave për vitin 2016 (DIVA) në vlerën 494.385 lekë dhe ka paguar tatim në burim për këto të ardhura, vlerën 74.158 lekë. Komisioni ka përfshirë në analizën financiare shumën e deklaruar në formularin DIVA.

33.4 Në këto kushte, për sa rezultoi se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka paguar detyrimet tatimore përkatëse, trupit gjykues nuk i rezultuan problematika lidhur me ligjshmërinë e këtyre të ardhurave.

B. KONTROLI I FIGURËS

34. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte, nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr.

¹¹⁶ Përcjellë nga subjekti i rivlerësimit me pyetësorin nr. 3, datë 23.2.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

¹¹⁷ Lëshuar në datën 23.2.2023 nga Njësia Administrative B, Zyra e Gjendjes Civile ***, përcjellë nga subjekti me pyetësorin nr. 3, datë 23.2.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

¹¹⁸ Referuar aneksit nr. 4/14 në dosjen e ILDKPKI-së.

¹¹⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 20.5.2021.

¹²⁰ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 21.11.2022, nga znj. M.B.

¹²¹ Shkresë nr. *** prot., datë 28.5.2021.

¹²² Shkresë nr. *** prot., datë 25.5.2021, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin nr. *** prot., datë 2.11.2017 mbi kontrollin e figurës, deklasifikuar me vendimin nr. ***, datë 14.10.2022, të KDZH-së për subjektin e rivlerësimit, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Sokol Malaj.

34.1 Në informacionin e përditësuar, DSIK-ja¹²³, me vendimin nr. ***, datë 8.3.2023, ka deklasifikuar pjesërisht raportin nr. *** prot., datë 1.2.2023, mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Sokol Malaj, me të cilin informon se:

i. Nga informacionet e autoriteteve verifikuese në kohështrirje gjatë periudhës së rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Sokol Malaj bëhet me dije se disponohen të dhëna mbi përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme.

ii. Në konfirmim të konstatimit fillestar për përshtatshmëri në vijimin e ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit Sokol J. Malaj, gjykojmë që për rastin në fjalë konkluzioni të mbetet në vlerësimin tuaj nën dritën e informacioneve të tjera që mund të dispononi si pjesë e gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ që po kryhen ndaj subjektit të rivlerësimit.

34.2 Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit¹²⁴ të japë shpjegime.

34.2.i Subjekti ka kundërshtuar konstatimin e DSIK-së, duke theksuar se është pikërisht ky institucion, i cili fillimisht me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017, ka përcjellë raportin për kontrollin e figurës për të si subjekt rivlerësimi, me konstatimin për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.

34.2.ii Subjekti e quan tërësisht të pabazuar dhe jo të përshtatshëm për personin e tij, ndryshimin e këtij qëndrimi me raportin e përditësuar për kontrollin e figurës, me të cilin është lënë konkluzioni për këtë kriter në vlerësim të Komisionit, bazuar në informacionet e tjera që mund të disponohen nga ky i fundit.

34.2.iii Subjekti ka shpjeguar se gjatë gjithë kohës së gjatë të ushtrimit të detyrës së magjistratit dhe prokurorit të Republikës, prej 22 vitesh tanimë, ka ruajtur një figurë të pastër, pa krijuar asnjë kontakt të papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të nenit 34 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

34.2.iv Subjekti i është referuar edhe rezultatit të hetimit të thelluar të kryer nga Komisioni, nga ku nuk është konstatuar që në ushtrimin e detyrës së tij të ketë vepruar ndonjëherë në kushtet e konfliktit të interesit dhe gjithashtu asnjë nga familjarët e tij apo personat e lidhur nuk janë ndodhur në kushtet e kontakteve të papërshtatshme apo të veprimeve të tjera, të cilat mund të ndikonin tek figura e tij si magjistrat apo të cenonte besimin e publikut të drejtësia.

34.2.v Subjekti ka sqaruar dhe deklaruar se në kushtet e mosdijenisë së arsyeve konkrete të ndryshimit të qëndrimit të DSIK-së në raportin e përditësuar, figura e tij vijon të jetë e pastër dhe e përshtatshme për ushtrimin e detyrës si magjistrat.

34.3 Trupi gjykues, në analizë të raportit të DSIK-së, të të dhënave të pasqyruara në përditësimin e tij, në mbështetje të hetimit tërësor të kryer, si dhe pas administrimit të shpjegimeve të subjektit, në kushtet që nga hetimi i kryer: (a) nuk konstatoi mangësi në lidhje me plotësimin e deklaratës së kontrollit të figurës apo vërtetësisë së të dhënave nga subjekti i rivlerësimit; (b) nuk evidentoi fakte apo rrethana, të cilat mund të përbënin *indicie* për kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit apo të mund të cenonin figurën e subjektit – arrin në përfundimin se të dhënat e referuara në raportin e DSIK-së mbeten

¹²³ Mbi kërkesën e Komisionit nr. *** prot., datë 4.11.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

¹²⁴ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

të paprovuara. Nën këto konstatime, trupi gjykues nuk mund të arrijë në një konkluzion ndryshe, përveçse të konkludojë se është i përshtatshëm sipas dispozitave ligjore të kreut V të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

35. Raporti¹²⁵ për këtë kriter është përgatitur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

35.1 Raporti i vlerësimit profesional është mbështetur në: (i) formularin e vetëdeklarimit; (ii) 3 dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, të dhëna e dokumente që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; (iii) 5 dosjet gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; si dhe (iv) të dhënat nga burimet arkivore të KLP-së, pas të cilit është konkluduar në: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale; (ç) aftësitë personale dhe angazhimin profesional.

35.2 Raporti i vlerësimit profesional, në analizë të gjetjeve¹²⁶, si dhe bazuar në të gjitha burimet e informacioneve për subjektin e rivlerësimit, nuk ka evidentuar problematika në aspektin e aftësive profesionale, organizative, etikën dhe integritetin e tij.

35.3 Analiza e gjetjeve¹²⁷

35.3.1 Analiza e gjetjeve në këtë raport bazohet në 3 burime informacioni:

- a. *Së pari*, te formulari i vetëvlerësimit dhe dokumenteve bashkëlidhur, të paraqitura nga vetë subjekti.
- b. *Së dyti*, te dosjet e përzgjedhura me short.
- c. *Së treti*, te dokumentacioni arkivor pranë Sektorit të Protokoll-Arkivit në Prokurorinë e Përgjithshme.

Të dhënat nga 23 prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, Drejtorisë së Përgjimeve të Telekomunikimit dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informativë dhe Zyra e Informacionit të Klasifikuar, Sektori i Protokoll-Arkivit, si dhe burimet arkivore të Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun në Prokurorinë e Përgjithshme.

35.3.2 Aftësitë profesionale

a. Njohuritë ligjore

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, prokuror Sokol Malaj, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se është vlerësuar “shumë mirë”, mbështetur në treguesit vjetorë të punës. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se subjekti i rivlerësimit identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Për sa i përket vlerësimit në aspektin profesional, rezulton se ai ka shfaqur aftësi në interpretimin e ligjit, analizën e jurisprudencës dhe arsyetimit ligjor e logjik, duke marrë vendime dhe përpiluar akte të qarta e të plota.

b. Arsyetimi ligjor

¹²⁵ Nr.*** prot., datë 13.2.2023.

¹²⁶ Bazuar në kriteret ligjore të parashikuara nga nenet 73-76 të ligjit nr. 96/2016.

¹²⁷ Bazuar në kriteret ligjore të parashikuara nga nenet 73-76 të ligjit nr. 96/2016.

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, prokuror Sokol Malaj, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se është vlerësuar “shumë mirë” mbështetur në treguesit vjetorë të punës. Bazuar në aktet e dorëzuara dhe në dosjet e shortuara, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, prokuror Sokol Malaj, shfaq aftësi në pasqyrimin e rrethanave të faktit dhe analizën e provave në përputhje me bazën ligjore të aplikueshme. Aktet e përpiluara prej tij paraqiten të qarta dhe të kuptueshme. Respektohen përgjithësisht rregullat e drejtshkrimit dhe niveli i arsytimit është në përputhje me standardin e procesit të rregullt ligjor.

35.3.3 Aftësitë organizative

a. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, prokuror Sokol Malaj, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se është vlerësuar “shumë mirë”, mbështetur në treguesit vjetorë të punës. Duke iu referuar vërtetimit nr. ***, datë 3.6.2020 dhe listës së statistikave të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vënë në dispozicion të Komisionit në procedurën e shortimit të dosjeve të datës 5.6.2020, konstatohet se janë 1123 çështje të trajtuara nga subjekti i rivlerësimit, të marra në shqyrtim për shortim. Duke pasur parasysh statistikën e ngarkesës së punës, si dhe natyrën e çështjeve, konstatohet se prokurori Sokol Malaj është përballur me një ngarkesë të konsiderueshme pune, duke treguar eficiencë në marrjen e vendimeve brenda një afati të arsyeshëm, referuar natyrës dhe shumëllojshmërisë së veprimeve hetimore. Afatet kohore të zgjidhjes së praktikave që kanë lidhje me dokumentet ligjore të përzgjedhura me short janë të arsyeshme¹²⁸ në raport me natyrën dhe kompleksitetin e praktikave përkatëse. Në analizë të të dhënave të mësipërme konstatohet se subjekti Sokol Malaj ka treguar aftësi në organizimin efektiv të kohës së punës duke kryer detyrat e ngarkuara me efikasitet.

b. Aftësia për të kryer procedurat hetimore

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, prokuror Sokol Malaj, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se është vlerësuar “shumë mirë”, mbështetur në treguesit vjetorë të punës. Subjekti i rivlerësimit, në rastin e vendimmarrjes mbi mosfillimin e procedimit penal, rezulton të ketë argumentuar mungesën e elementeve të veprës penale. Në procedimet penale për të cilat është vendosur pushimi i hetimeve, është realizuar drejtimi i hetimeve të kryera nga policia gjyqësore, duke argumentuar vendimmarrjen për pushimin e procedimit penal. Subjekti i rivlerësimit ka shfaqur aftësitë e nevojshme edhe mbi kontrollin e hetimeve të kryera nga policia gjyqësore për të mbështetur akuzën në çështjet me të pandehur të dërguar për gjykim.

c. Aftësia për të administruar dosjet

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, prokuror Sokol Malaj, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se është vlerësuar “shumë mirë”, mbështetur në treguesit vjetorë të punës. Nga vëzhgimi i akteve të dorëzuara nga subjekti dhe 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, prokurori Sokol Malaj, në ushtrim të kompetencave të tij, ka aftësi për të administruar dosjet.

35.3.4 Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a. Etika në punë

¹²⁸ Konkretisht kohëzgjatja e trajtimit të praktikave që lidhen me dosjet 1, 2, 3, 4 dhe 5 ka qenë respektivisht: dosja nr. 1 – kohëzgjatja 5.5.2014 – 12.5.2014 (7 ditë); dosja nr. 2 – kohëzgjatja 10.9.2014 – 5.11.2014 (1 muaj e 25 ditë); dosja nr. 3 – kohëzgjatja 11.3.2016 – 25.5.2016 (2 muaj e 14 ditë); dosja nr. 4 – kohëzgjatja 20.4.2016 – 5.5.2016 (15 ditë); dosja nr. 5 – kohëzgjatja 12.2.2015 – 17.2.2015 (5 ditë).

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, prokuror Sokol Malaj, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se është vlerësuar “shumë mirë”, mbështetur në treguesit vjetorë të punës.

b. Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Sokol Malaj dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c. Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Sokol Malaj. Në asnjë prej dokumenteve dhe dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Gjithashtu, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

35.3.5 Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a. Aftësitë e komunikimit

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, prokuror Sokol Malaj, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se është vlerësuar “shumë mirë”, mbështetur në treguesit vjetorë të punës. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk rezultojnë të dhëna që flasin për mënyrën e komunikimit ndërpersonal të subjektit me pjesëmarrësit në proces.

b. Aftësia për të bashkëpunuar

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, prokuror Sokol Malaj, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se është vlerësuar “shumë mirë”, mbështetur në treguesit vjetorë të punës. Bazuar në të gjitha burimet e informacioneve të këtij raporti nuk rezultojnë të dhëna konkrete që flasin mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar mes kolegësh apo më gjerë.

C/1. Rivlerësimi i aftësive profesionale

36. Nga analizimi i të gjitha dokumenteve ligjore¹²⁹ të administruara dhe akteve të hartuara nga subjekti i rivlerësimit, pas të cilave është përgatitur edhe raporti përkatës, trupi gjykues nuk vërejtí fakte apo rrethana që mund të ndikojnë në kriterin e vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit.

36.1 Në lidhje me 3 dokumentet ligjore të dorëzuara nga subjekti në KLP për vlerësimin e aftësive profesionale, Komisioni, pas shqyrtimit të dokumentit nr. 2, i cili përshkruhet më poshtë (sikurse ishte

¹²⁹ Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit: dokumenti nr. 1 – “Vendim për mosfillimin e procedimit penal”. Akti është përpiluar dhe nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit, prokuror Sokol Malaj, në cilësinë e prokurorit të çështjes; dokumenti nr. 2 – “Ankim kundër vendimit të drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shfuqizimin e vendimit të pushimit të procedimit penal nr. ***”; dokumenti nr. 3/“Konkluzione përfundimtare të gjykimit të çështjes penale nr. ***”, me të pandehur M.L, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në këtë raport me fjalën dosje nr. 1 kemi cilësuar kallëzimin penal nr. ***, viti 2014 (Vendosur mosfillimi i procedimit/Akti – Vendimi i Mosfillimit). Në këtë raport me fjalën dosje nr. 2 kemi cilësuar procedimin penal nr. *** (Vendosur pushimi i procedimit penal/Akti – Vendimi i pushimit). Në këtë raport me fjalën dosje nr. 3 kemi cilësuar procedimin penal nr. *** (Vendosur pushimi i procedimit penal/Akti – Vendimi i pushimit). Në këtë raport me fjalën dosje nr. 4 kemi cilësuar procedimin penal nr. *** (Vendosur dërgimi për gjykim i procedimit penal/Akti – Kërkesë për gjykim). Në këtë raport me fjalën dosje nr. 5 kemi cilësuar procedimin penal nr. *** (Vendosur dërgimi për gjykim i procedimit penal Akti – Kërkesë për gjykim).

pasqyruar në raportin e KLP-së), i ka kërkuar subjektin të qartësojë statusin e “Ankimit¹³⁰ të tij drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, kundër vendimit të drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shfuqizimin e vendimit të pushimit të procedimit penal nr. ***¹³¹”, si dhe të depozitojë dokumentacion mbështetës mbi shpjegimin e dhënë.

Dokumenti nr. 2 – “Ankim kundër vendimit të drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shfuqizimin e vendimit të pushimit të procedimit penal nr. ***”

Nga shqyrtimi i aktit ligjor ka rezultuar se në datën 10.1.2014, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është regjistruar procedimi penal nr. ***, për kryerjen e veprës penale “drejtim i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal ndaj shtetasit F.B. Për hetimin e çështjes penale është ngarkuar prokurori Sokol Malaj, i cili në përfundim të hetimeve ka vendosur pushimin e çështjes penale. Në datën 27.1.2014, drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur shfuqizimin e vendimit të pushimit të procedimit penal nr. ***, viti 2014.

Referuar nenit 24, pikat 4 dhe 5 të Kodit të Procedurës Penale dhe pikës 6 të urdhrit nr. 147, datë 9.5.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm, prokurori i çështjes ka paraqitur ankimin para Prokurorit të Përgjithshëm, duke parashtruar faktin penal dhe arsyetimin ligjor mbi vendimmarrjen e tij.

Ka rezultuar se në datën 9.1.2013, rreth orës 22:30, në rrugën “****”, ka ndodhur një aksident automobilistik pa pasoja në lidhje me shëndetin. Automjeti tip “Ford Fokus”, me targa ***, me drejtues shtetasin F.B, është përplasur me automjetin tip “Audi”, me targa ***, me drejtues shtetasin D.L. Nga ana e punonjësit të policisë i është bërë testi për përdorimin e alkoolit, ku ka rezultuar se shtetasi F.B kishte konsumuar alkool në masën mbi 0.5%. Në dosjen hetimore ishin administruar 2 gypa, indikatorë alkool testi, tipi “drager”, me të cilët ishte testuar drejtuesi i automjetit.

Pas kryerjes së veprimeve hetimore, prokurori ka vendosur pushimin e procedimit penal me vendimin e datës 22.1.2014, bazuar në nenin 328/1, shkronja “b”, me arsyetimin se fakti nuk parashikohej nga ligji si vepër penale.

Prokurori i çështjes ka arsyetuar mbi kuptimin e nocionit “...drejtimi i mjetit në gjendje të dehur...”, përshkruar në nenin 291 të Kodit Penal, duke iu referuar disa akteve të tjera ligjore dhe nënligjore:

1. Ligji nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 153, datë 7.4.2000, “Për miratimin e rregullores në zbatim të Kodit Rrugor”.
3. Urdhër i përbashkët i ministrit të Brendshëm dhe ministrit të Shëndetësisë nr. 4310, datë 15.11.2002.

Prokurori ka arsyetuar se punonjësi i policisë, në respektim të akteve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, duhet të kryente verifikime më të sakta të gjendjes psikofizike të drejtuesit të automjetit, nëpërmjet analizave të gjakut ose me aparate integrale të quajtur “etilometra” të omologuar, të përcaktuar në VKM-në Nr. 153, datë 7.4.2000.

Në nenin 184 të Kodit Rrugor, paragrafët 7, 8 dhe 9, si dhe në “Rregulloren për zbatimin e Kodit Rrugor”, miratuar me VKM-në Nr. 153, datë 7.4.2000, neni 346, është përcaktuar se kontrolli i drejtuesve të mjeteve rrugore nën ndikimin e alkoolit kryhet nëpërmjet analizave të ajrit gjatë frymëmarrjes dhe kur

¹³⁰ Referuar dokumentit nr. 2, i përshkruar në raportin e vlerësimit profesional nga Grupi i Punës pranë KLP-së, depozituar nga subjekti i rivlerësimit si një ndër tri dokumentet e depozituara nga subjekti.

¹³¹ Dhënë nga subjekti i rivlerësimit.

përqendrimi i ajrit në gjak që del nga frymëmarrja është mbi 0.5 g/l, drejtuesi është i dehur dhe kjo gjendje nënkupton përdorimin e etilometrave (me printer) ose digjitale me tregim të memorizuar.

Neni 184 i Kodit Rrugor ka të përcaktuar qartësisht ndalimin për të drejtuar automjetet në gjendje të dehur apo nën ndikimin e alkoolit pas përdorimit të pijeve alkoolike. Sipas të njëjtës dispozitë, shërbimet e policisë gjyqësore ishin të detyruara, që për verifikimin e saktë të gjendjes psikofizike të drejtuesit të automjetit, të procedonin me matjen e nivelit (përqindjes) të alkoolit me analiza gjaku ose me aparate integrale të quajtura “etilometra” të omologuar.

Duke iu referuar edhe Urdhrit të përbashkët të ministrit të Brendshëm dhe ministrit të Shëndetësisë nr. 4310, datë 15.11.2002, aparatura e etilometrit të omologuar dhe me tregues digjital ishte mjeti i vetëm për të treguar gjendjen psikofizike të drejtuesit të automjetit pas përdorimit të pijeve alkoolike, duke saktësuar në nenin 10 të tij që çdo aparat tjetër nuk përbënte burim prove, por shërbente që të procedohej më tej me etilometra të aprovuar.

Nga të dhënat e referuara nga policia gjyqësore kishte rezultuar që drejtuesi F.B i ishte nënshtruar verifikimit me gyp indikator alkool testi “drager”, për verifikimin e përqindjes së alkoolit në gjak, nga i cili kishte rezultuar se pas testit, gypi ishte ngjyrosur me jeshile dhe sipas oficerit përpilues, nga krahasimi me tabelën e posaçme ka rezultuar një përbërje alkooli mbi 0.5%. Në udhëzuesin e përdorimit (tabela e posaçme) të gypit “drager” përcaktohej se aparati i alkool testit jepte një përcaktim nëse përqendrimi i alkoolit i kalonte ose jo limitet e caktuara. Sipas këtij manuali, nëse rezultati me gyp “drager” dilte pozitiv, atëherë marrja e gjakut për nevoja ligjore ishte e detyrueshme. Në tabelë jepeshin edhe figurat e ngjyrosjes së tubit pas provës, si dhe përqindja e alkoolit për çdo ngjyrë, duke u përcaktuar në limite të tilla si “më pak se 0.3%”, “më pak se 0.5%” dhe “afërsisht 0.5% ose më shumë”, fakt që provonte se aparatura jepte rezultate tërësisht të përgjithshme.

Prokurori ka arsyetuar se Kodi Rrugor dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij parashikonin si të kundërligjshëm veprimin e drejtimit të mjeteve motorike në kushtet e gjendjes së dehur apo nën efektin e alkoolit pas përdorimit të pijeve alkoolike dhe për këto raste merreshin masa administrative. Ndërsa vepra penale e parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal inkriminonte vetëm drejtimin e mjeteve motorike në kushtet e gjendjes së dehur. Në interpretim literal, por edhe në kuptimin shkencor dhe ligjor, gjendja e dehur pasqyrore një gjendje të ndryshme psikofizike nga gjendja nën efektin e alkoolit. Neni 346 i VKM-së Nr. 153, datë 7.4.2000, ka të përcaktuar se kur përqendrimi i alkoolit në ajrin që del nga frymëmarrja është 0.2-0.5 g/l drejtuesi i mjetit rezultonte nën efektin e alkoolit dhe kur është mbi 0.5 g/l drejtuesi rezultonte në gjendje të dehur.

Në bazë të këtij arsyetimi ligjor, prokurori ka konkluduar se shërbimet e policisë gjyqësore, në funksion të sqarimit të rrethanave të faktit, duhet të kishin proceduar, pas testit me gypat “drager”, me matjen e nivelit të alkoolit me aparatet e etilometrit të omologuar dhe me tregues digjitalizuar ose me marrjen e materialit biologjik të gjakut, me qëllim kryerjen e ekspertimit toksikologjiko-ligjor.

Duke analizuar të gjitha provat e administruara dhe duke çmuar se nuk provohej një nga elementet e anës objektive të veprës penale, prokurori i çështjes ka vendosur pushimin e procedimit penal.

Drejtuesi i Prokurorisë ka vendosur të shfuqizojë vendimin e pushimit, duke arsyetuar:

1. Referuar arsyetimit të prokurorit të çështjes dhe bazës ligjore ku është mbështetur vendimi i pushimit, prokurori duhet të procedonte menjëherë me mosfillimin e procedimit penal dhe me lirimin e të arrestuarit, pasi me të njëjtat akte është vendosur pushimi i procedimit.

2. Në lidhje me cilësimin juridik të veprës penale, vlerësohej se shtetasi F.B kishte konsumuar plotësisht elementet e figurës së veprës penale “drejtim i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal.

Në arsyetimin e vendimit për shfuqizimin e vendimit të pushimit është çmuar se policia gjyqësore kishte respektuar kriteret e përcaktuara në Kodin Rrugor dhe se aparati i alkooltestit vlerësohej si një nga llojet e provave për të përcaktuar gjendjen e dehur, provë e pranuar edhe nga gjykatat, të cilat kishin vendosur një praktikë të konsoliduar.

Prokurori i çështjes, duke u bazuar në arsyetimin e tij ligjor, ka vlerësuar përfundimisht se përcaktimi ligjor, nëse *...drejtuesi i mjetit ishte në gjendje të dehur...*, realizohej vetëm me dy forma, me etilometra të omologuar ose akt ekspertimi toksikologjik dhe për këtë arsye ka paraqitur ankimin, duke çmuar se vendimi i pushimit ishte i bazuar në ligj dhe prova.

Dokumenti ligjor është i strukturuar në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe pjesën konkluduese.

Në pjesën hyrëse, prokurori subjekt i rivlerësimi përshkruan emërtimin e dokumentit, të dhënat referuese të procedimit penal, vendimin e pushimit dhe vendimin e drejtuesit për shfuqizimin e vendimit të pushimit, si dhe bazën ligjore ku mbështetet ankimi. Pjesa përshkruese-arsyetuese është strukturuar në disa nënpjesë. Fillimisht përshkruhet fakti i ndodhur dhe provat e administruara në fashikullin e hetimit. Pastaj është bërë arsyetimi ligjor mbi provat e administruara referuar Kodit Penal dhe akteve ligjore e nënligjore. Më tej përshkruhet arsyetimi ligjor i drejtuesit të Prokurorisë ku bazohet vendimi për shfuqizimin e vendimit të pushimit. Në fund janë përshkruar kundërshtitë e prokurorit të çështjes të bazuara në arsyetimin e tij ligjor. Në pjesën konkluduese të ankimit drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, prokurori subjekt rivlerësimi ka parashtruar kërkesën e tij për shfuqizimin e vendimit të drejtuesit të Prokurorisë.

Nga përmbajtja e dokumentit të mësipërm konstatohet se përgjithësisht janë respektuar rregullat e drejtshkrimin, fjalitë paraqiten të qarta, teksti është i kuptueshëm dhe i strukturuar në paragrafë të ndarë nga njëri-tjetri. Në arsyetimin e ankimit referohen normat e Kodit Penal, Kodit të Procedurës Penale, si dhe ligjeve materiale e akteve përkatëse nënligjore.

Subjekti, mbi kërkimin e Komisionit për këtë çështje, ka shpjeguar se mbi vendimin e tij të pushimit drejtuesi i prokurorisë së rrethit ka vendosur shfuqizimin, i cili gjithashtu mbi bazë të ankimit të subjektit ka lënë në fuqi vendimin e shfuqizimit. Sipas subjektit, kjo vendimmarrje vijonte të ishte e pambështetur në ligj dhe në argumentet e parashtruara në ankim. Subjekti ka detajuar procedurën e ndjekur me çështjen objekt hetimi. Ai ka sqaruar se me vendimin nr. ***, datë 20.3.2014, ish-Prokurori i Përgjithshëm ka lënë në fuqi vendimmarrjen e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, por pa dhënë asnjë argument se pse ky vendim duhet të lihej në fuqi dhe se pse argumentet e subjektit në ankim nuk qëndronin. Subjekti ka theksuar se detyrat e lëna nga ish-Prokurori i Përgjithshëm për vijimin e hetimeve në këtë procedim penal dhe konkretisht “Pyetja e dëshmitarëve”, nuk shërbenin për zgjidhjen e drejtë të çështjes, pasi vetë natyra e kësaj vepre penale “drejtim i automjeteve në mënyrë të parregullt”, në gjendje të dehur, nuk mund të provohet me anë të dëshmitarëve, por vetëm me prova shkresore, si ato të cilat janë referuar në ankimin e tij (analiza mjekësore etj.).

Subjekti ka shpjeguar se me rëndësi për këtë procedim ka qenë fakti se pas shfuqizimit të vendimmarrjes së tij për pushim, procedimi është dërguar për gjykim nga një tjetër prokuror. Subjekti ka konfirmuar se gjykata, në përfundim të gjykimit, duke u mbështetur në arsyetimin e saj në argumentet që kishte parashtruar subjekti në vendimin e pushimit dhe në ankimin drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, ka vendosur deklarinimin e pafajshëm të të pandehurit F.B, vendim i cili më pas ka marrë formë të prerë,

duke u lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë. Subjekti depozitoi praktikën e akteve për këtë procedim, si vendimin datë 22.1.2014, “Për pushimin e procedimit penal”, vendimin datë 27.1.2014, “Për shfuqizimin e vendimit të pushimit të procedimit penal nr. ***”, ankimin e subjektit nr. *** prot., datë 6.2.2014, vendimin nr. ***, datë 20.3.2014, të Prokurorit të Përgjithshëm, për shqyrtimin e ankimit, kërkesën datë 26.3.2014, drejtuar gjykatës për gjykimin e çështjes, vendimin nr. ***, datë 1.6.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vendimin nr. ***, datë 11.5.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

36.2 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, të cilat i çmon bindëse, por edhe duke analizuar ecurinë dhe përfundimin e çështjes në gjykatë, ku me vendim të formës së prerë është vendosur pafajësia e të pandehurit, nuk konkludon në problematika, fakte apo rrethana, të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit. Nga verifikimi i akteve rezulton se me vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë është vendosur mospranimi i ankimit të ushtruar nga prokuroria, ndaj vendimit nr. ***, datë 1.6.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili kishte deklaruar të pafajshëm të pandehurin B.

36.3 Për sa përshkruhej në raportin e vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit nga KLP-ja, në rubrikën “Të dhënat e administruara nga Prokuroria e Përgjithshme”, ndër të tjera, kanë rezultuar të regjistruara: (a) praktikat nr. *** dhe nr. ***, mbi bazën e ankesës së shtetasit A.P¹³², për shkak se, sipas pretendimit të ankuesit, *prokurori i çështjes ka zgjatur hetimet pa i marrë shpjegime dhe ka përfunduar çështjen pa i vënë në dispozicion një kopje të akteve, duke mbajtur qëndrim të njëanshëm në favor të kallëzuesit*; dhe (b) praktika nr. *** mbi bazën e ankesës së shtetasit I.TH¹³³, për shkak se, sipas pretendimit të ankuesit, *hetimet që ka kryer prokurori Sokol Malaj (në tri procedime) kanë favorizuar të kallëzuarën N.U, për kryerje të veprës penale “mashttrim”*.

36.3.i Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime mbi pretendimin e shtetasit I.TH se *hetimet që ka kryer prokurori Sokol Malaj (në tri procedime) kanë favorizuar të kallëzuarën N.U, për kryerje të veprës penale “mashttrim”*, si dhe të dokumentojë lidhur me ecurinë e tri procedimeve, për të cilat nga ankuesi pretendohet për kryerje të hetimeve favorizuese.

36.3.ii Subjekti, ndër të tjera, ka parashtruar: (i) në datën 24.5.2018 është regjistruar kallëzimi penal nr. ***, paraqitur nga shtetasi I.TH ndaj shtetases N.U për veprën penale “mashttrim”; (ii) në datën 31.5.2018, pasi është vlerësuar ky kallëzim, prej subjektit është vendosur mosfillimi i hetimeve me argumentin se *ndodhemi përpara një marrëdhënieje juridiko-civile*; (iii) shtetasi I.TH kishte bërë kallëzim penal ndaj të njëjtës kallëzuese, për të njëjtin fakt penal, për të cilin ishte regjistruar procedimi penal nr. ***, datë 18.2.2015, i pushuar nga një tjetër prokuror (Gj. K), në vitin 2015 dhe një tjetër procedim (nr. ***), i dërguar për pushim nga prokurori K.B. Subjekti ka shpjeguar se vendimi i tij është shfuqizuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. *** regjistri, datë 11.10.2018, vendim i lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë. Në këto kushte është regjistruar procedimi penal (nr. ***) dhe janë kryer veprimet hetimore përkatëse. Në datën 10.5.2019 është kërkuar pushimi i çështjes penale, për shkak të faktit se kjo çështje ishte gjykuar më parë dhe gjithashtu ishte parashkruar ndjekja penale (kishin kaluar mbi 10 vjet nga pretendimi i ndodhjes së faktit penal). Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. *** akti, datë 9.7.2019, ka vendosur kthimin e akteve prokurorit, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, duke u lënë si detyrë administrimi i kontratave të sipërmarrjes së vitit 2006 – 2007.

¹³² I cili njëkohësisht ka depozituar në Komision edhe denoncimin nr. ***, datë 8.2.2018, administruar në dosjen e Komisionit dhe që pretendimet e ankuesit/denoncuesit, por edhe konkluzioni i Komisionit janë trajtuar në këtë vendimmarrje tek denoncimi i këtij shtetasi.

¹³³ I cili njëkohësisht ka depozituar në Komision edhe denoncimet nr. *** prot., datë 18.1.2019 dhe nr. *** prot., datë 4.4.2019 të administruar në dosjen e Komisionit.

Subjekti ka shpjeguar se megjithëse këto akte ishin administruar më parë, ndodheshin në dosje, janë administruar këto kontrata përsëri, si dhe *statementi* bankar nga “Tirana Bank” dhe BKT-ja, ku rezultonte se shtetasja N.U kishte kthyer shumën për anulimin e kontratës tek shtetasi I.TH.

Subjekti ka sqaruar se në datën 9.7.2021 i është drejtuar gjykatës me kërkesë “Për pushimin e procedimit penal”, kërkesë e cila është miratuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. *** akti, datë 28.10.2021, i cili ka marrë formë të prerë, pa u ankimuar nga palët.

Subjekti ka deklaruar se nuk ka kryer asnjë favorizim për ndonjë palë, aq më tepër që kallëzuesi I.TH kishte depozituar njëkohësisht edhe dy kallëzime të tjera, për të njëjtin fakt penal, në prokurori, me qëllimin e vetëm që të përdorte organin e prokurorisë, për të realizuar qëllimin e tij për përmbushjen e detyrimeve kontraktore nga e kallëzuara.

36.4 Trupi gjykues, në analizë të parashtrimeve të subjektit dhe dokumentacionit të administruar, konstatoi se: (a) çështja penale, pas mosfillimit të procedimit penal, është prishur në mënyrë të përsëritur nga gjykata; (b) pas mosfillimit të procedimit penal gjykata ka lënë detyrë regjistrimin e procedimit penal dhe hetimin nëse rastet e para të kallëzuara në prokurori kanë nisur për të njëjtat fakte dhe rrethana të pretenduara për shkak se vendimi i subjektit për mosfillimin e procedimit penal është bazuar pikërisht në vendimin e pushimit të vitit 2015, dhënë nga një tjetër prokuror, por që rezultonte i prishur më pas; (c) në vijim është lënë detyrë lidhur me hetimin e zgjeruar për të saktësuar historikun e shumës së depozituar nga e kallëzuara në favor të kallëzuesit në vitin 2011 e në vijim, për administrimin e dy kontratave për të cilat subjekti shpjegoi se ato kanë qenë të administruara, por megjithatë i ka administruar sërish së bashku me një *statement* dhe, në vijim, çështja është pushuar sikurse ka kërkuar organi i akuzës.

Pas kryerjes së veprimeve hetimore kryesisht të hetimeve mbi veprimet bankare, subjekti ka kërkuar pushimin e procedimit, i cili është vlerësuar i drejtë dhe në këtë rast çështja është pushuar me vendim të formës së prerë.

36.5 Në të tilla kushte, nga trajtimi i këtij denoncimi, trupi gjykues vlerëson se mangësitë e konstatuara nga gjykata, për të regjistruar procedimin dhe për të kryer veprime hetimore, për shkak të mosfillimit të vendosur, të konsiderohen në vlerësimin tërësor të subjektit të rivlerësimit.

37. SPAK-u¹³⁴ ka informuar se ndaj subjektit të rivlerësimit: (a) nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë procedim penal; (b) janë regjistruar përkatësisht kallëzimi nr. *** dhe nr. **, për të cilët është vendosur mosfillimi i procedimit; (c) është depozituar materiali kallëzues me kallëzues shtetasin S.C¹³⁵, i cili është dërguar për vlerësim me shkresën nr. *** prot., datë 21.1.2021, në Prokurorinë e Përgjithshme; (ç) janë regjistruar kallëzimet penale nr. *** dhe nr. ***¹³⁶, për të cilat është vendosur mosfillimi i procedimit.

37.1 Nga dokumentacioni i administruar¹³⁷ lidhur me çështjen C. konstatohet se ajo është trajtuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila me vendimin datë 11.2.2021, ka vendosur: *“Mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal, regjistruar me nr. **, të shtetasit C. ndaj subjektit të rivlerësimit për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal”*.

Në lidhje me denoncimet e depozituara në Komision, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016

¹³⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 16.1.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

¹³⁵ I cili njëkohësisht ka depozituar në Komision edhe denoncimin nr. **, datë 19.2.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

¹³⁶ Sipas verifikimit të bërë në regjistrin e njoftimit të veprave penale të ish Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, kallëzime të konfirmuara edhe nga raporti i rivlerësimit profesional, cituar më sipër në rubrikën “Të dhëna arkivore”, pika 2.

¹³⁷ Referojuni praktikave të administruara në Komision me shkresën nr. *** prot., datë 2.6.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

38. Denoncim¹³⁸ i shtetasit F.S (bashkim i dy denoncimeve)

38.1 Denoncuesi në ankesën e tij parashtron problematika lidhur me çështjen penale të vënë në lëvizje ndaj tij nën akuzën “mashtim dhe vjedhje”, duke e fokusuar ankesën në drejtim të vendimmarrjes së padrejtë të subjektit të rivlerësimit në datën 17.2.2020, në lidhje me caktimin e ekspertit kontabël, znj. A.K. Sipas tij, eksperti është caktuar në kundërshtim me ligjin nr. 10091, datë 5.3.2009, “Për auditimin ligjor”, pasi pretendon se kjo shtetase është përfshirë dhe ka nënshkruar aktin e ekspertizës kontabile pa qenë audituese dhe eksperte ligjore, provuar kjo me dokumentin e lëshuar nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të autorizuar, nr. ***, datë 26.6.2020. Denoncuesi i ka bashkëngjitur ankimit edhe dokumentin e IEKA-s.

38.2 Komisioni, nga verifikimi i këtij dokumenti, konstaton se znj. K. nuk është miratuar nga autoritetet kompetente për të kryer auditime ligjore, si dhe nuk është regjistruar në regjistrin publik të IEKA-s për të ushtruar profesionin e audituesit ligjor, pra nuk është anëtare e Institutit të Ekspertëve Kontabël të regjistruar të Shqipërisë (IEKA).

38.3 Për sa përshkruhet më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime¹³⁹ dhe dokumentojë lidhur me pretendimet e denoncuesit për caktimin e ekspertit kontabël, në kundërshtim me legjislacionin e fushës dhe informacionit të IEKA-s, si dhe lidhur me procedurën e ndjekur mbi të cilën ai është bazuar në caktimin e këtij eksperti.

38.4 Subjekti ka shpjeguar se është caktuar si përfaqësues i akuzës gjatë gjykimit të kësaj çështjeje, pas zëvendësimit të prokurorit B.M gjatë gjykimit. Kjo çështje është gjetur nga ana e tij në fazën e gjykimit. Subjekti ka shpjeguar se në atë gjykim, dy shoqëri tregtare (“****” sh.p.k. dhe “****” sh.p.k.) akuzoheshin për veprat penale “mashtim” dhe “vjedhje”, ndërsa për shtetasit V. F, A. F dhe A. L, si administratorë të këtyre subjekteve juridike, çështja ishte dërguar për pushim.

Subjekti ka shpjeguar lidhur me veprimet e ndërmarra në gjykatë. Ai ka saktësuar se gjykata kishte deklaruar të pavlefshëm aktin e ekspertimit kontabël të kryer nga prokuroria dhe kishte urdhëruar kryerjen e një ekspertimi me një grup të ri ekspertësh (me vendimin nr. ***, datë 4.9.2019, për plotësimin e hetimeve).

Subjekti ka sqaruar se nga ana e prokurorit të mëparshëm, pas vendimit për plotësimin e hetimeve, është vijuar me caktim të grupit të ekspertëve (në datën 26.9.2019), duke u caktuar dy prej ekspertëve të caktuar në ekspertimin e mëparshëm, i cili ishte shpallur i pavlefshëm nga gjykata, çka ka passjellë përsëri vendimin e gjykatës për shfuqizimin e aktit të dytë të ekspertimit kontabël dhe plotësimin e hetimeve, për shkak se vendimmarrja e prokurorit kishte qenë në kundërshtim të plotë me vendimin e gjykatës për caktimin e ekspertëve, për të cilët ishte urdhëruar të ishin të ndryshëm nga të mëparshmit.

Subjekti ka theksuar se është caktuar si prokuror i çështjes pas këtyre veprimeve gjyqësore.

Ai ka deklaruar se në zbatim të vendimit të gjykatës, kishte urdhëruar “Plotësimin e hetimeve, duke urdhëruar përsëritjen e akteve të ekspertimit kontabël, me një grup prej 3 (tre) ekspertësh të fushës”, ku njëri prej tyre do të caktohej nga prokuroria, njëri nga të pandehurit/personat nën hetim dhe tjetri nga viktimat e veprës penale. Subjekti ka sqaruar se nga ana e tij, sipas urdhërimit të gjykatës, i është kërkuar të pandehurve dhe viktimës që të zgjidhnin nga një ekspert. Nga ana e viktimës F.S, me memon e datës 14.2.2020, është kërkuar të caktohen si ekspertë J.N dhe S.GJ, të dy këta ekspertë, të cilët kishin kryer ekspertime të mëparshme në këtë procedim, ekspertime të cilat ishin deklaruar të pavlefshme nga gjykata. Subjekti ka deklaruar se kjo kërkesë është rrëzuar nga ana e tij si prokuror me vendimin e datës

¹³⁸ Nr. *** prot., datë 9.7.2020 dhe nr. *** prot., datë 6.7.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

¹³⁹ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

14.2.2020. Ai ka deklaruar se njëkohësisht nga të pandehurit është kërkuar si ekspert B.B (auditues ligjor), i cili është pranuar, sipas urdhërimit të gjykatës. Njëkohësisht, nga ana e prokurorisë janë caktuar ekspertët Q.L (auditues ligjor) dhe A.K (kontabiliste e miratuar). Subjekti ka theksuar se të tre këta ekspertë janë pjesë e listës së publikuar nga Ministria e Drejtësisë për ekspertime në fushën e kontabilitetit.

Ai ka shpjeguar se pas administrimit të aktit të ekspertimit është kërkuar pushimi i çështjes penale, kërkesë e cila është miratuar me vendimin nr. ***, datë 10.7.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Pas ankimit të ushtruar, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 17.12.2020, ka vendosur ndryshimin e vendimit të shkallës së parë, kthimin e akteve për vijimin e hetimeve dhe kryerjen e një ekspertimi të ri kontabël. Në plotësim të hetimeve, nga ana e tij si prokuror janë caktuar tre auditues ligjorë, mes tyre edhe i përzgjedhuri nga viktimja F.S. Subjekti ka sqaruar se pas kryerjes së aktit të ekspertimit, nga ana e tij është përcjellë kërkesë për pushimin e çështjes në gjykatë, datë 7.3.2023, e cila është në pritje të shqyrtimit nga gjykata.

Në lidhje me pretendimin e ngritur nga shtetasi F.S, subjekti ka sqaruar se nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin për plotësimin e hetimeve është urdhëruar “Plotësimi i hetimeve, duke urdhëruar përsëritjen e akteve të ekspertimit kontabël, me një grup prej 3 ekspertësh të fushës”, pra caktimi i një eksperti (kontabilist i miratuar siç ishte ekspertja A.K) ishte në përputhje me këtë vendimmarrje të gjykatës, e cila nuk kishte urdhëruar caktimin e ekspertëve nga IEKA, por caktimin e një grupi ekspertësh të fushës. Subjekti ka depozituar dokumentacionin mbështetës mbi shpjegimet e dhëna.

38.5 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit, dokumentacionit të administruar, në raport me pretendimet e denoncuesit, vlerëson shterues shpjegimin dhe saktësimet e bëra nga subjekti lidhur me pretendimet e denoncuesit. Nga analizimi i dokumentacionit vërehet se në zanafillë të çështjes ka qenë një tjetër subjekt rivlerësimi, pas hetimeve të të cilit çështja është rikthyer për hetime të mëtejshme. Konstatohet se megjithëse nga ana e subjektit ishte vepruar në përputhje me detyrat e lëna për caktim të ekspertëve, sikurse kishte caktuar gjykata, sërish çështja është kthyer për një ekspertim të ri kontabël, por nga Gjykata e Apelit Tiranë, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë kishte konfirmuar kërkesën e subjektit për pushimin e çështjes.

Lidhur me pretendimin e denoncuesit për caktim të një eksperti të palicencuar nga IEKA, për të cilën subjekti ka qartësuar se eksperti është marrë nga lista e Ministrisë së Drejtësisë, e cila është publikuar në faqen e saj zyrtare nga verifikimi i listës së publikuar në faqen *online* të Ministrisë, konfirmohet ky fakt (shihni adresën <https://www.drejtesia.gov.al/regjistri-elektronik-i-eksperteve/>).

Aktualisht, pas kërimit të organit të akuzës çështja vijon shqyrtimin e saj në gjykatë.

38.6 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit dhe dokumentacionit të administruar, vlerëson se pretendimi i denoncuesit nuk qëndron.

39. Denoncim¹⁴⁰ i shtetasit H.R

Denoncuesi ankohet kryesisht për vendimmarrje të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt “Konflikt pronësor”. Ndër reshta pretendon edhe për shkelje të kryera nga subjekti i rivlerësimit lidhur me një çështje penale të hetuar dhe mosfilluar prej tij për zyrtarë, të cilët kanë qenë palë ndërgjyqëse e

¹⁴⁰ Nr. *** prot., datë 23.7.2019, administruar në dosjen e Komisionit.

procesit civil. Denoncuesi nuk ka depozituar dokumentacion provues dhe as nuk jep të dhëna konkrete mbi pretendimet e parashtruara për subjektin e rivlerësimit.

Nga shqyrtimi i këtij denoncimi duket se nuk vihet re ndonjë fakt apo rrethanë që mund të përbëjë provë në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

40. Denoncim¹⁴¹ i shtetasit I.TH (bashkim i dy denoncimeve)

40.1 Denoncuesi ankohet për disa prokurorë duke përmendur edhe subjektin e rivlerësimit, por nuk prezanton të dhëna konkrete për të provuar pretendimet e tij. Nga parashtrimet e paraqitura vërehet se janë vënë në lëvizje në organin e akuzës disa kallëzime të shtetasit Th. ndaj një shtetaseje të akuzuar për veprën penale “mashttrim me pasoja të rënda, kryer më shumë se një herë”. Nga të dhënat e parashtruara vërehet se e akuzuara i ka marrë një shumë të konsiderueshme ankuesit në këmbim të porositjes së një pasurie të paluajtshme për të cilën më tej problematikat kanë agravuar, duke mos u përmbushur qëllimi i dhënies së shumës dhe, për rrjedhojë, janë krijuar konflikte lidhur me kërkimin për kthimin e shumës. Nga dokumentacioni i administruar, i depozituar nga denoncuesi, konfirmohen akte të ndërmarra nga të tjerë prokurorë, ndërsa në vendimin e datës 11.10.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku denoncuesi është në cilësinë e kërkuesit, me objekt kërkimi “Kundërshtim i vendimit datë 31.5.2018 “Për mosfillimin e procedimit penal nr. ***, viti 2018” të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vërehet se organi i akuzës përfaqësohet nga subjekti i rivlerësimit, vendim ky i lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 15.2.2019, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Ky është i vetmi akt që lidh ankimin me subjektin e rivlerësimit. Sipas vendimit të gjykatës konstatohet se janë lënë detyra për t’u kryer nga organi i akuzës me qëllim regjistrimin e procedimit penal dhe vijimin e hetimeve. Është i paqartë roli i subjektit të rivlerësimit në këtë çështje, pra është thjesht dhe vetëm në cilësinë e përfaqësuesit në gjykatë apo në cilësinë e prokurorit që ka hetuar çështjen për të cilën është vendosur me vendimin datë 31.5.2018, “Mosfillimi i procedimit penal nr. ***, viti 2018”.

40.2 Përveç sa u kërkua dhe konkludua më sipër në rubrikën “Rivlerësimit profesional”, nisur nga përmbajtja e denoncimit dhe dokumentacioni shoqëruar, Komisioni i kërkoi subjektit të qartësojë pozitën e tij në këtë çështje objekt hetimi, pra, nëse ai kishte qenë thjesht dhe vetëm si përfaqësues i organit të akuzës apo edhe si prokuror i çështjes, si dhe të shpjegonte lidhur me ecurinë e procesit hetimor pas kthimit të saj/çështjes nga gjykata, si edhe të depozitonte dokumentacionin vërtetues mbi statusin aktual (vërtetim apo vendimet gjyqësore, etj.). Gjithashtu, Komisioni i kërkoi subjektit të depozitonte vendimin e mosfillimit, objekt ankimi në gjykatë.

40.3 Subjekti, ndër të tjera, ka parashtruar edhe një herë shpjegimin si më sipërpërkthuar të rivlerësimit profesional, që i përket të njëjtit ankues. Ai ka theksuar se e ka trajtuar këtë çështje vetëm në rastin e përfundimit me vendimin e mosfillimit të datës 31.5.2018, i cili më tej është shfuqizuar nga gjykata për regjistrim të procedimit penal dhe kryerje të hetimeve. Subjekti ka depozituar dokumentacionin e kërkuar mbi të cilin ka dhënë shpjegime.

40.4 Trupi gjykues e konsideron të plotë dhe të qartë shpjegimin e subjektit të rivlerësimit dhe për të mos rënë në përsëritje i qëndron konkluzionit të shprehur më sipër në pikat 36.4 dhe 36.5.

41. Denoncim¹⁴² i shtetasit N.K

41.1 Denoncuesi ankohet ndaj subjektit të rivlerësimit për shkelje të kryera prej tij përgjatë hetimit të procedimit penal. Nga të dhënat e administruara rezultoi se organi i akuzës fillimisht ka regjistruar procedimin penal nr.*** ndaj shtetasit B.T, akuzuar për veprat penale “shkelje e rregullave të qarkullimit

¹⁴¹ Nr. *** prot., datë 18.1.2019 dhe nr. *** prot., datë 4.4.2019, administruar në dosjen e Komisionit.

¹⁴² Nr. *** prot., datë 24.1.2019, administruar në dosjen e Komisionit.

rrugor” dhe “largim nga vendi i aksidentit” lidhur me aksidentin e kryer me pasojë shkaktimin e dëmtimeve të rënda ndaj denoncuesit. Nga aktet e depozituara prej denoncuesit rezultoi se subjekti i rivlerësimit me vendimin e datës 23.3.2017, ka vendosur: “*Pushimin e hetimeve*”. Më tej rezultoi se denoncuesi është ankuar ndaj vendimit të organit të akuzës dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e datës 16.5.2017, ka vendosur kthimin e çështjes për hetime të tjera, duke konkretizuar edhe detyrat që duhet të kryheshin. Gjykata ka konkluduar se duhet pyetur i dëmtuari dhe ndërkohë duhet të rikryhet akti i ekspertimit autoteknik me tre ekspertë të kualifikuar të fushës. Vendimi është ankimuar dhe Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin e saj nr. ***, datë 21.5.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë. Po nga aktet e depozituara prej denoncuesit vërehet se në datën 15.11.2018, subjekti i rivlerësimit ka njoftuar përfundimin e hetimeve duke arsyetuar se është pyetur i dëmtuari dhe se është kryer riekspertimi, nga i cili është konkluduar nën të njëjtin shkak determinues të aksidentit, si në ekspertimin e mëparshëm, konkretisht në shkëljen e rregullave të qarkullimit nga ana e këmbësorit (denoncuesit). Njoftimi i përfundimit të hetimeve ka konkluduar në pushimin e veprës penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, ndërsa nuk argumentohet lidhur me veprën tjetër penale “largim nga vendi i aksidentit”. Rezultoi se njoftimi i përfundimit të hetimeve është nënshkruar edhe nga i dëmtuari/denoncuesi.

41.2 Denoncuesi pretendon se: (a) nuk është thirrur nga subjekti i rivlerësimit pas vendimit të apelit; (b) subjekti nuk ka marrë në pyetje dëshmitarët okularë; dhe se (c) nuk ka dijeni se si është bërë akti i ekspertimit.

41.3 Komisioni i ka kërkuar subjektit: (a) të japë shpjegime¹⁴³ lidhur me pretendimet e denoncuesit në vijim, pas përfundimit të hetimeve pas kthimit të çështjes nga gjykata, si dhe të japë shpjegime lidhur me konstatimet e gjykatës për moskryerje të hetimeve të plota si pasojë e të cilave është kthyer çështja; (b) të vërtetojë me dokumentacion justifikues nga dosja e hetimit veprimet e kryera, sikurse citohet në aktin e përfundimit të hetimeve pas vendimmarrjes gjyqësore për kthimin e çështjes për të tjera hetime, pra për thirrjen dhe marrjen në pyetje të të dëmtuarit, kryerjen e aktit të riekspertimit së bashku me aktin; (c) të vërtetojë me dokumentacion justifikues statusin aktual të çështjes pas kërimit të tij, për përfundimin e hetimeve.

41.4 Në lidhje me këtë denoncim, subjekti ka përshkruar historikun e çështjes, veprimet hetimore të kryera dhe konkludimin e tij, pas kryerjes së 2 akteve të ekspertimit, të urdhëruara nga prokuroria, të cilat kishin nxjerrë me shkelje të rregullave të qarkullimit këmbësorin, shtetasin N.K, duke kërkuar rrjedhimisht pushimin e çështjes për të pandehurin B.L për këtë vepër.

41.5 Subjekti ka sqaruar se për veprën tjetër penale “largim nga vendi i aksidentit”, parashikuar nga neni 273 i Kodit Penal, i pandehuri B.L është deklaruar fajtor nga gjykata, duke u dënuar me 2 muaj burgim. Subjekti ka sqaruar se ashtu sikurse është referuar nga Komisioni, kjo çështje, për sa i përket veprës penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal është kthyer nga gjykata me vendimin nr. *** akti, datë 16.5.2017, lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 21.5.2018, të Gjykatës së Apelit Tiranë. Subjekti ka shpjeguar se pas rifillimit të hetimeve, nga ana e tij janë zbatuar me korrektesë detyrat e lëna nga gjykata, duke pyetur të dëmtuarin shtetasin N.K dhe urdhëruar kryerjen e riekspertimit me 3 ekspertë. Subjekti ka shpjeguar se përsëri nga grupi i ekspertëve është konkluduar se shkaku determinant ishte shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor të këmbësorit, pra viktimës N.K. Subjekti ka sqaruar se të gjitha aktet i janë komunikuar viktimës, shtetasit N.K, në datën 15.11.2018, me përfundimin e hetimeve, moment kur ai ka nënshkruar personalisht. Subjekti ka konfirmuar se kërkesa e tij paraqitur gjykatës, për pushimin e çështjes, që i përket procedimit penal me nr. ***, datë regjistrimi

¹⁴³ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

4.1.2017, regjistruar për veprën penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal është pranuar me vendimin nr. *** regj., datë 24.1.2019, vendim ky i lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***, datë 13.3.2019. Subjekti ka depozituar dokumentacionin mbështetës mbi shpjegimet e dhëna.

41.6 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të dhëna nga subjekti, dokumentacionit të administruar, si dhe pretendimeve të denoncuesit, vërejtë se pretendimet e denoncuesit nuk qëndrojnë pasi rezultoi se ai është thirrur nga subjekti i rivlerësimit për t’u pyetur, pas kthimit të çështjes nga gjykata, për t’u kryer hetime të tjera dhe se aktet e ndërmarra në vijim nga subjekti i janë bërë me dije z. K. U konstatua se çështja është kthyer nga gjykata vetëm sa i përket akuzës “shkelje e rregullave të qarkullimit”, pasi për sa i përket akuzës “largim nga vendi i aksidentit” i akuzuari është dënuar mbi kërkesën e organit të akuzës. U konstatua se pas plotësimit të detyrave të lëna çështja është pushuar me vendim të formës së prerë.

41.7 Në të tilla kushte, trupi gjykues moskryerjen e veprimeve hetimore të konfirmuar edhe nga gjykata me vendimin nr. *** akti, datë 16.5.2017, për kryerje të hetimeve të tjera, për veprën penale “shkelje e rregullave të qarkullimit”, parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal, dhënë pas kërkesës së subjektit për pushimin e saj, datë 20.3.2017, për shkak se subjekti nuk rezultoi të kishte marrë në pyetje të dëmtuarin K./denoncuesin, e çmon si mangësi që vijon të evidentohet në mënyrë të përsëritur, (*sikurse do të arsyetohet në vijim*), pesha e së cilës konsiderohet në vlerësimin tërësor të çështjes.

42. Denoncim¹⁴⁴ i shtetasit P.K

42.1 Denoncuesi ankohet për moskryerje të hetimeve duke pushuar çështjen në kundërshtim me ligjin. Denoncuesi parashtron problemin pronësor që ka pasur lidhur me tjetërsimin e pronës së tij te një fondacion italian, nën falsifikimin e firmës, për të cilën edhe ka bërë kallëzimin përkatës. Nga aktet e depozituara prej denoncuesit rezultoi se në datën 2.3.2011 është vendosur pushimi i procedimit penal nr. *** nga një tjetër subjekt rivlerësimi, vendim i cili më tej është shfuqizuar nga subjekti i rivlerësimit si drejtues i Prokurorisë, duke u vendosur ndryshimi i vendimit për pushimin e procedimit dhe pushimi i procedimit për shkakun se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

42.2 Nga dokumentacioni i administruar duket se denoncuesi ankohet mbi themelin e çështjes, pasi nga verifikimi i vendimit dhe akti i ekspertimit, i cili është referuar në arsyetimin e vendimit është pasqyruar fakti se nënshkrimi i firmave ka qenë i njëjtë me atë të personit (babai i denoncuesit, z. M.K me cilësinë e shitësit) që ka nënshkruar kontratën e shitjes së pasurisë, e cila është tjetërsuar dhe njëkohësisht, po në arsyetim, thuhet se çështja është trajtuar gjyqësisht deri edhe në Gjykatën e Apelit, ku pala blerëse e pasurisë ka fituar gjyqin.

42.3 Nga shqyrtimi i këtij denoncimi vihet re se ankesa e denoncuesit ka në fokus shqyrtimin e themelit të çështjes. Në të tilla kushte e rrethana, Komisioni nuk identifikoi ndonjë fakt apo rrethanë që mund të përbëjë provë në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

43. Denoncim¹⁴⁵ i shtetasit E.H

43.1 Denoncuesi ankohet për vendimmarrje të padrejtë të marrë nga subjekti i rivlerësimit ndaj vëllait të tij E.H, i akuzuar nga një shtetas për veprën penale “mashtrim”, tashmë i dënuar me 8 vjet heqje lirie, duke vuajtur dënimin në IEVP-në Shënkoll, Lezhë.

43.2 Denoncuesi pretendon se nuk janë kryer hetimet e nevojshme për të hedhur dritë mbi provueshmërinë e kryerjes së veprës penale. Në këtë drejtim ai pretendon se nuk janë marrë tabulatet e

¹⁴⁴ Nr. *** prot., datë 3.9.2018, administruar në dosjen e Komisionit.

¹⁴⁵ Nr. *** prot., datë 29.8.2019, administruar në dosjen e Komisionit.

thirrjeve telefonike për të provuar se kallëzuesi është mashtruar në dhënien e shumës së parave se nuk është bërë ballafaqimi i palëve, etj.

43.3 Komisioni administroi fashikullin penal që i përket procedimit nr. ***, datë 18.2.2016, regjistruar për veprën penale “mashtrim me pasoja të rënda”, parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal.

i. Nga aktet e fashikullit rezultoi se procedimi penal është regjistruar bazuar në kallëzimin e shtetasit A.B, i cili ka kallëzuar shtetasin E.H se është mashtruar prej tij, duke i dhënë një shumë të konsiderueshme parash nën pretekstin se i kishte ndodhur një aksident në Prizren dhe se duhej të tërhiqte kufomën nga morgu.

ii. Nga aktet e administruara në dosje Komisioni vërejti se është pyetur kallëzuesi dhe dëshmitarët (pasi për të kallëzuarin/të pandehurin ka pasur kërkesë të subjektit të rivlerësimit mbi deklarinimin e tij të ikjes, si dhe ka pasur masë “arrest me burg”, dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, po mbi kërkesën e organit të akuzës), si dhe është bërë këqyrja e tabulateve dhe sms-ve të telefonit, etj. dhe, në përfundim të hetimeve, është kërkuar nga organi i akuzës dënimi i shtetasit H. me 8 vjet burgim, pasi vepra penale rezultonte e kryer në kushtet e mashtrimit.

43.4 Në të tilla kushte, nga trajtimi i këtij denoncimi duket se nuk vërehen fakte apo rrethana, të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin e kriterit profesional të subjektit të rivlerësimit.

44. Denoncim¹⁴⁶ i shtetasit J.V

44.1 Denoncuesi ankohet për zvarritje të gjykimit të çështjes që i përket shtetasës shqiptaro-suedeze A.N, me cilësinë e paditëses, ndaj të paditurit F.V, me objekt “Njohje si trashëgimtare ligjore”. Njëkohësisht, denoncuesi ankohet për vendime të padrejta të marra nga disa prokurorë, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit, të cilët sipas denoncuesit janë kallëzuar pasi nuk kanë ushtruar ndjekje penale kundër gjyqtarëve për të cilët është bërë kallëzim, për shkak të gjykimeve të padrejta të tyre për këtë çështje gjyqësore.

44.2 Denoncuesi ankohet se subjekti i rivlerësimit bazuar në nenin 78¹⁴⁷ të Kodit të Procedurës Penale nuk ka qenë kompetent për të vendosur mbi kallëzimin penal të bërë nga paditësja ndaj gjyqtarës R.B të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila, sipas pretendimit të denoncuesit, ka dhënë dorëheqjen vetëm në ditën e shpalljes së vendimit gjyqësor. Sipas denoncuesit, aktet duhet t'i kalonin për hetim një tjetër prokurorie kompetente.

44.3 Për sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime¹⁴⁸ mbi pretendimin e denoncuesit (si përfaqësues i paditëses në çështjen gjyqësore), për çështjen e kompetencës në vendimin e mosfillimit, në raport me nenin 78 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe të depozitojë një kopje të vendimit të mosfillimit të marrë prej tij në çështjen e pretenduar nga denoncuesi.

44.4 Subjekti në lidhje me këtë denoncim ka sqaruar se nuk ka trajtuar ndonjë kallëzim penal të bërë nga shtetasja A.N. Subjekti ka depozituar vërtetimin nr. *** prot., datë 19.4.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nga ku konfirmohet fakti se subjekti nuk ka hetuar çështje penale në cilësinë e kallëzueses apo të kallëzuarës për shtetasen A.N.

¹⁴⁶ Nr. ***prot., datë 23.1.2018, administruar në dosjen e Komisionit.

¹⁴⁷ Neni 78, Kompetenca për procedimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve: “1. Procedimet, në të cilat një gjyqtar ose prokuror merr cilësinë e të pandehurit ose të personit të dëmtuar nga vepra penale, që sipas normave të këtij kreu do të ishin në kompetencën e një gjykate të rrethit, ku gjyqtari ose prokurori ushtron funksionet e tij ose i ushtronte në momentin e ngjarjes, janë në kompetencën e gjykatës që ka kompetencën lëndore dhe ndodhet në qendrën e një rrethi tjetër më të afërt, me përjashtim të rasteve kur në këtë rreth gjyqtari ose prokurori ka ardhur më pas për të ushtruar funksionet e tij. Në rastin e fundit është kompetente gjykata e një rrethi tjetër më të afërt me atë, në të cilën gjyqtari ose prokurori ushtronte funksionet e tij në momentin e kryerjes së veprës penale”.

¹⁴⁸ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

45. Denoncim¹⁴⁹ i shtetasit V.Ç

Denoncuesi ankohet për një vendimmarrje të padrejtë të marrë nga një tjetër subjekt rivlerësimi, por e lidh pretendimin e tij edhe me subjektin e rivlerësimit, pasi në atë kohë ai ka qenë në drejtim të organit të akuzës. Pretendimi në denoncim i referohet një kallëzimi të vitit 2012 për një çështje pronësore të kthyer me vendim të KKKPronave nën pretendimin e përdorimit të dokumenteve të falsifikuara në një proces gjyqësor civil. Denoncuesi pretendon se pushimi i çështjes është bërë në bashkëveprim me drejtuesin/subjektin e rivlerësimit. Denoncuesi nuk ka shoqëruar denoncimin me asnjë dokument provues.

Nga shqyrtimi i këtij denoncimi, Komisioni nuk vëren ndonjë fakt apo rrethanë që mund të përbëjë provë në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

46. Denoncim¹⁵⁰ i shtetasës V.P

Denoncuesja ankohet ndaj disa subjekteve të rivlerësimit, ndër to edhe për subjektin objekt hetimi administrativ. Në përmbajtje të denoncimit nuk parashtrohet asnjë çështje konkrete në adresë të subjektit të rivlerësimit.

Nga shqyrtimi i këtij denoncimi Komisioni nuk vëren ndonjë fakt apo rrethanë që mund të përbëjë provë në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

47. Denoncim¹⁵¹ i shtetasit A.P

47.1 Denoncuesi ankohet për zvarritje dhe trajtim joprofesional nga organi i akuzës për dy kallëzime të depozituara në vitin 2008, ku në drejtim të prokurorisë ka qenë subjekti i rivlerësimit. Ai ka parashtruar se në atë kohë kishte denoncuar veprime korruptive të vërejtura në Konsullatën Italiane, ku edhe punonte si inspektor, pasi në marrjen/pajisjen me viza udhëtimi depozitohej dokumentacion i falsifikuar/letërporosi që servirej sipas tij nga drejtues të institucioneve publike në qytetin e Vlorës apo qytete të tjera nën juridiksionin e kësaj konsullate dhe për të provuar këtë fakt ka vendosur në dispozicion të organit të akuzës edhe një kërkesë të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Kjo prokurori, pasi ka konfirmuar se shkresa nuk ka dalë në rrugë zyrtare prej saj dhe, më tej, pasi janë pyetur edhe denoncuesi e shtetas të tjerë, por edhe për faktin se kanë mbetur dyshime se mund të jenë kryer veprat penale “mashttrim” dhe “falsifikim të dokumenteve”, subjekti i rivlerësimit ka vendosur zëvendësimin e prokurorit E.A, i cili ishte pjesë e seksionit të të miturve me një tjetër prokuror, N.T, për ndjekjen e hetimeve paraprake për procedimin penal nr. ***. Po ashtu, denoncuesi ankohet edhe për një tjetër material kallëzues të depozituar prej tij nën pretendimin e kryerjes së veprës penale të parashikuar nga nenin 248 i Kodit Penal, në kuadër të procedurave disiplinore të kryera ndaj tij dhe procesit të emërimit të një tjetër personi me pa të drejtë në një funksion ku kishte aplikuar për ngritje në detyrë. Denoncuesi ka depozituar urdhrin e regjistrimit të procedimit penal për këtë çështje, nga ku vërehet se nuk i përket subjektit të rivlerësimit.

47.2 Po ashtu, denoncuesi ka depozituar edhe vendimin (jo të plotë) e subjektit të rivlerësimit, datë 6.4.2017, “Për mosfillimin e procedimit penal”, për një tjetër kallëzim të depozituar nga denoncuesi dhe reciprokisht edhe nga personi tjetër E.K, për shkak se nga secili prej tyre (si punonjës në varësi të Ministrisë së Bujqësisë) pretendohet për dëmtime me dashje të pësuara nga një konflikt që kanë pasur në ambientet e Ministrisë së Bujqësisë. Në vendimin e subjektit të rivlerësimit thuhet se sipas aktit të ekspertimit mjekoligjor shtetasi A.P/denoncuesi ka pasur dëmtime të parëndësishme, ndërsa shtetasi

¹⁴⁹ Nr. *** prot., datë 13.12.2017, administruar në dosjen e Komisionit.

¹⁵⁰ Nr. *** prot., datë 6.6.2018, administruar në dosjen e Komisionit.

¹⁵¹ Nr. *** prot., datë 20.3.2018, administruar në dosjen e Komisionit.

tjetër K. ka hequr dorë nga ndjekja penale. Nga fletëthirrja e depozituar së bashku me denoncimin duket se ky vendim është kundërshtuar.

47.3 Për sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime, pasi dukej se vendimi i tij është marrë në tejkalim të afatit njëmuor në kundërshtim me udhëzimin nr. 3, datë 19.6.2012, të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe i kërkoj të depozitojë vendimin e plotë të mosfillimit të procedimit penal datë 6.4.2017. Gjithashtu, Komisioni i kërkoj subjektit të konfirmojë dhe dokumentojë¹⁵² mbi statusin e këtij vendimi, pra nëse ndaj vendimit është ushtruar e drejta e ankimit nga palët dhe në cilën fazë ndodhet aktualisht çështja.

47.4 Subjekti, në shpjegimet e tij, ndër të tjera, ka sqaruar se *materiali kallëzues për këtë rast është dërguar nga Komisariati i Policisë nr. ***, Tiranë, duke u regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datën 25.1.2017, duke u referuar vepra penale “dëmtime të tjera me dashje”, parashikuar nga neni 90 i Kodit Penal, me dy procesverbale kallëzimi: një nga shtetasi A.P dhe një nga shtetasi E.K. Për shkak se të dy këta shtetas pretendonin se ishin goditur nga njëri - tjetri, nga Oficeri i Policisë Gjyqësore ishte vendosur kryerja e dy ekspertimeve mjekoligjore, në datën 18.1.2017, për secilin rast (për dëmtimet e pretenduara të shtetasit A.P dhe ato të shtetasit E.K), ekspertime të cilat do të kryheshin nga ekspertët e Institutit të Mjekësisë Ligjore Tiranë.*

47.5 Subjekti ka shpjeguar se ky material kallëzues me nr. *** është regjistruar në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë në datën 25.1.2017 dhe është referuar nga zëvendës drejtuesi i prokurorisë në datën 14.2.2017 për prokurorin Sokol Malaj dhe po ashtu është ngarkuar OPGJ-ja përkatëse për të kryer verifikimet paraprake. Ai ka qartësuar se fillimisht në prokurori ka mbërritur akti i ekspertimit mjekoligjor nr. ***, datë 23.1.2017, kryer për shtetasin A.P, me të cilin konkludohej se: *“Dëmtimet e konstatuara tek shtetasi A.P nuk kanë qenë të rrezikshme për jetën e tij në momentin e shkakimit të tyre. Dëmtimet e mësipërme hyjnë në kategorinë e atyre dëmtimeve të parëndësishme, të cilat nuk sjellin për pasojë humbjen e aftësisë së përkohshme për punë”* dhe se ndërkohë, pasi ky material është marrë për trajtim nga ana e tij si prokuror, dosja ishte ende në pritje të mbërritjes së aktit të ekspertimit mjekoligjor të urdhëruar në datën 18.1.2017, për shtetasin tjetër E.K. Një akt i tillë ende nuk kishte ardhur nga IML-ja, ndërsa në datën 6.4.2017 ky shtetas është paraqitur përpara oficerit të policisë gjyqësore, i cili sipas nenit 285 të Kodit të Procedurës Penale ka deklaruar se nuk dëshironte që kjo çështje të ndiqej penalisht, pasi konflikti kishte qenë banal dhe për këtë shkak hiqte dorë nga ankimi. Për këtë fakt është mbajtur procesverbali përkatës. Në këto kushte, ka deklaruar subjekti, në të njëjtën datë (6.4.2017) dhe pa asnjë vonesë, nga ana e tij është marrë vendimi për mosfillimin e procedimit penal, duke u cilësuar në përmbajtjen e tij faktet se: *“Nga konkluzionet e aktit të ekspertimit mjekoligjor nr. ***, datë 23.1.2017, rezulton se shtetasi A.P ka pësuar dëmtime të parëndësishme. Në datën 6.4.2017 është paraqitur shtetasi E.K, i cili ka hequr dorë nga ndjekja penale”*. Subjekti ka theksuar se në pikën 2 të vendimit të mosfillimit është urdhëruar njohja me vendimin e të interesuarve, të cilët kishin të drejtën e ankimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, brenda 5 ditëve nga marrja dijani.

47.6 Subjekti ka konfirmuar se shtetasi P. ka ushtruar ankim kundër vendimit të mosfillimit, për të cilin Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. *** akti, datë 21.3.2018, ka vendosur *“Rrëzimin e kërkesës së shtetasit A.P për shfuqizimin e vendimit të mosfillimit”*, por pas ankimit në Gjykatën e Apelit Tiranë është vendosur me vendimin nr. ***, datë 9.5.2018, ndryshimi i vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke shfuqizuar vendimin e mosfillimit dhe kthyer çështjen për hetime pranë organit të akuzës.

47.7 Subjekti ka konfirmuar se pas kthimit të dosjes për vijimin e hetimeve në prokurori, shtetasi A.P ka kërkuar ndryshimin e prokurorit nga hetimi i kësaj çështjeje penale, duke referuar ankesat e

¹⁵² Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

mëparshme që kishte dërguar, përfshirë dhe Komisionin, ku pas kësaj kërkesë dhe pavarësisht se pretendimet e ankuesit A.P ishin të pabazuara, subjekti ka shpjeguar se duke pasur parasysh situatën konfliktuale me këtë shtetas, i cili ankohej për një tjetër hetim përpara 10 vjetësh, kur ai kishte ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me qëllim mosparagjykimin e hetimeve në atë çështje penale, në bazë të nenit 27/1 të Kodit të Procedurës Penale, në datën 26.6.2018, i kishte paraqitur drejtuesve deklaratën për dhënien e pëlqimit për zëvendësimin e tij si prokuror në materialin kallëzues nr. ***, të vitit 2017. Në vijim, ka theksuar subjekti, me këtë çështje është marrë një tjetër prokuror.

47.8 Subjekti ka dhënë shpjegime edhe lidhur me mosadministrimin e aktit të ekspertimit mjekoligjor për shtetasin E.K, i cili ishte kërkuar në mënyrë të përsëritur nga organi i akuzës, porse nuk kishte mbërritur dhe se në përgjigjen e saj, IML-ja kishte deklaruar se akti i ekspertimit mjekoligjor për këtë shtetas nuk ishte kryer, pasi ai nuk ishte paraqitur për vizitë mjekoligjore.

47.9 Subjekti ka shpjeguar edhe vijimin e çështjes (nga një tjetër prokuror) së kthyer për hetime të tjera, pas vendimit të mosfillimit të dhënë prej tij, si dhe statusin e saj, ku Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pas shqyrtimit të kërkesës për pushimin e procedimit, me vendimin nr. *** akti, datë 9.5.2019, ka vendosur pranimin e saj, vendim ky i formës së prerë, i paankimuar.

47.10 Trupi gjykues, në analizim të shpjegimeve të subjektit lidhur me tejkalimin e afatit 30 ditë, për të vendosur *Mosfillimin e procedimit penal*, për të cilin subjekti shpjegoi se për njërin kallëzues/i kallëzuar për më shumë se tre muaj nga ndodhia e ngjarjes nuk ishte vendosur në dispozicion akti i ekspertimit mjekoligjor nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, vërejti se nga dokumentacioni i administruar nuk u konfirmua asnjë korrespondencë e mbajtur me IML-në, brenda afatit 30 ditë, si dhe nuk u konstatua asnjë përshkrim në arsyetimin e vendimit të mosfillimit të çështjes, që të pasqyronte veprimet/përpjekjet e bëra për të siguruar në kohë informacionin mbi kryerjen ose jo të aktit të ekspertimit.

- Trupi gjykues vlerëson se nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk është miradministruar dosja, nuk është ndërmarrë asnjë veprim procedural lidhur me kryerjen e aktit të ekspertimit, ekzistencën e tij, dhe për pasojë tejkalimi i afatit 30 ditë i marrjes së vendimit të *Mosfillimit të çështjes* rezulton i paargumentuar dhe në kundërshtim me nenin 74/2 të ligjit nr.96/2016 dhe parashikimit të bërë në udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. 3, datë 13.6.2012.

48. Denoncim¹⁵³ i shtetasit A.P

48.1 Denoncuesi në këtë ankim prezantohet në cilësinë e avokatit mbrojtës të palës, e cila pritej të dëmshpërblehej për shkak të dëmtimeve të pësuar nga një aksident automobilistik. Denoncuesi ankohet për vendimmarrje dhe veprime procedurale të padrejta të ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit përgjatë kohës së kryerjes së hetimeve, edhe në kapërcim të parashikimit ligjor (si p. sh. për rastin e zgjatjes së hetimeve), përtej afatit tremujor.

Ai shpjegon se për shkak të dëmtimeve të rënda që ka pësuar e përfaqësuara dhe të tjerë, si pasojë e një aksidenti dhe përkujdesjes që duhej treguar ndaj saj është vlerësuar me vendimmarrje deri në Gjykatën e Lartë përfitimi i një shume të konsiderueshme nga shoqëria “****” sh.a., shumë e cila përfaqëson dëmin e plotë pasuror dhe jopasuror në formën e dëmit biologjik, dëmit moral dhe ekzistencial, si dhe shpenzime të tjera për përkujdesje. Denoncuesi pretendon se prokurorët ku përfshihet edhe subjekti i rivlerësimit kanë ndërmarrë veprime jo të drejta si në sekustrimin e dosjes përmbartimore për të mos u arritur ekzekutimi i kësaj shume edhe pse vendimi ishte i formës së prerë dhe se kishte kaluar të gjitha shkallët e gjyqimit. Nga përmbajtja e denoncimit konfirmohet regjistrimi i procedimit penal nr. ***, viti

¹⁵³ Nr. *** prot., datë 9.2.2018, administruar në dosjen e Komisionit.

2017, si rezultat i kallëzimit të paraqitur nga shoqëria “***” sh.a., e cila në procesin gjyqësor civil ka qenë palë e paditur. Denoncuesi ankohet se në këtë procedim është regjistruar me pa të drejtë emri i tij si person nën hetim, për veprën penale “mashttrim”, parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal. Denoncuesi ankohet se deri në shkresën e dërguar për njoftimin e zgjatjes së hetimeve nuk ka pasur asnjë njoftim të mëparshëm (nga shtatori i vitit 2017 deri në dhjetor të po këtij viti) dhe asnjë njohje me dokumentacionin. Ai pretendon për shtyrje me pa të drejtë të afatit, për shkak se ai vetë dhe të tjerë që mund të pyeteshin kanë pasur të konfirmuar adresat dhe numrat e telefonit, lehtësisht të verifikueshme. Denoncuesi pretendon se është sekuestruar me pa të drejtë dosja përmbartimore me të cilën përmbartuesi kishte nisur ekzekutimin e vendimit gjyqësor. Denoncuesi konfirmon se prej përmbartuesit gjyqësor është depozituar edhe një kallëzim ndaj subjektit të rivlerësimit për shpërdorim detyre, për shkak edhe të konfirmimit prej tij tek denoncuesi, se ai ka qenë nën presion për të mos ekzekutuar vendimin gjyqësor. Denoncuesi pretendon se përmbartuesi gjyqësor është marrë me pa të drejtë në cilësinë e personit ndaj të cilit po kryheshin hetime, sipas nenit 248 të Kodit Penal. Denoncuesi pretendon se prokurori ka tejkaluar kompetencat ligjore duke marrë rolin e gjykatës, pikërisht në rastin kur përcakton se: *“Kërkesa e kreditorit, e cila ka vënë në lëvizje përmbartuesin, përmban të dhëna të rreme, pasi siç thamë kreditorja... ka vdekur apo për faktin se ekzekutimi do të thellonte pasojat pasi kreditorët e tjerë do të përvetësojnë shumën të konsiderueshme parash nëpërmjet mashtimit”*. Ai pretendon se prokurorët kanë trembur bankat për të mos ekzekutuar vendimin. Denoncuesi në perceptimin e tij ka krijuar bindjen se veprimet e njëpasnjëshme të prokurorit kanë synuar favorizimin e debitorit dhe nuk kanë për qëllim verifikimin apo jo të ekzistencës së veprës penale, duke krijuar një situatë të paprecedentë antiligjore. Denoncuesi ka paraqitur disa akte të cilat kryesisht pasqyrojnë kërkesat e tij (dhe memo) drejtuar organit të akuzës për pajisje me dokumentacion dhe vënie në dijeni eprorëve të këtij organi, për shkelje të pretenduara prej tij ndaj subjektit të rivlerësimit në veprimet hetimore të kryera në procedimin penal, objekt hetimi.

48.2 Lidhur me pretendimet e denoncuesit, Komisioni administroi fashikullin penal që i përket procedimit nr. ***, datë 7.9.2017.

i. Nga aktet e administruara rezultoi se çështja është referuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë në datën 5.9.2017, mbi kallëzimin e bërë nga shoqëria e sigurimeve “****” sh.a., datë 4.9.2017.

ii. Po nga aktet e administruara rezultoi se shoqëria e sigurimeve kishte depozituar kërkesë për rishikim vendimi në Gjykatën e Lartë, datë 1.7.2016, si dhe kërkesë për pezullim të ekzekutimit të vendimit të kësaj gjykate, datë 30.8.2017.

iii. Në vijim, lidhur me veprimet hetimore të kryera në lidhje me këtë çështje, u vërejt se subjekti i rivlerësimit ka regjistruar procedimin penal në datën 7.9.2017.

iv. Në datën 12.9.2017 janë regjistruar emrat e personave nën hetim, A.GJ, A.GJ, A.P nën akuzën “mashttrim” dhe përmbartuesi privat E.M, nën akuzën “shpërdorim të detyrës”, pasi ka rezultuar se ekzekutimi i vendimit ndikonte kryesisht, (dëmshpërblimi për dëmin e shkaktuar) ndaj njërës prej shtetaseve të aksidentuara L.GJ, e cila gjatë procesit gjyqësor në Gjykatën e Apelit kishte ndërruar jetë dhe ky fakt nuk ishte bërë i ditur në gjykim.

v. Nga ana e organit të akuzës janë caktuar veprimet hetimore që duhet të kryheshin si: (a) sekuestrimi i praktikës përmbartimore; (b) marrja e dosjes civile; (c) marrja në pyetje e të aksidentuarve dhe avokatit P., në cilësinë e personave nën hetim, për të konkluduar në faktin se përse është fshehur vdekja e njërës prej të aksidentuarve; (ç) administrimi i certifikatave familjare dhe i vdekjes së shtetases L.GJ; si dhe (d) të tjera veprime të vlerësuara në dobi të hetimit të çështjes.

vi. Në datën 12.12.2017 subjekti i rivlerësimit ka vendosur zgjatjen e afatit të hetimeve për të pyetur me cilësinë e personave nën hetim dhe përfundimin e hetimeve për shtetasit A.P, E.M, A dhe A.GJ, pasi nga

këqyrja që i është bërë dosjes së përmbartuesit rezulton se është marrë dijëni nga shkresa e datës 30.8.2017 e shoqërisë së sigurimeve, fakti që kreditorja L.GJ kishte vdekur dhe se ky fakt i ishte fshehur gjykatës.

vii. Sipas akteve të dosjes rezulton se praktika përmbartimore është sekuestruar me procesverbalin datë 7.9.2017.

viii. Në dosje është e administruar memoja (datë 26.12.2017) e av. P., drejtuar subjektit të rivlerësimit, ku konfirmon se për më shumë se 3 muaj nuk është marrë në pyetje.

ix. Po ashtu, në dosje është e administruar përsëri memoja e avokatit drejtuar subjektit të rivlerësimit, ku konfirmohet se është vënë në dijëni të akuzës që i atribuohet dhe të përfundimit të hetimeve ndaj tij, në datën 9.2.2018. Ky shtetas konfirmon në memo se pas një periudhe 5-mujore njihet me kopjen e kallëzimit. Në këtë memo, ndër të tjera, shtetasi P. mohon të jetë marrë në pyetje.

x. Përfaqësuesi i palës së aksidentuar, shtetasi P. rezulton i pyetur në datën 7.9.2017, ku dhe nuk ka pranuar të deklarojë duke u shprehur se këtë veprim do ta kryente në një fazë tjetër të hetimit. Po në këtë procesverbal konfirmohet se ai ka marrë dijëni që është person në hetim.

xi. Në datën 9.11.2017 janë pyetur edhe shtetasit GJ, familjarët e viktimës (pasi janë pyetur), të cilët njëkohësisht kanë qenë edhe palë paditëse në procesin gjyqësor civil për shpërbllimin e dëmit, të cilët kanë deklaruar se i kanë konfirmuar avokatit vdekjen e znj. L.GJ dhe se me procedurat e gjykimit është marrë avokati.

xii. Në datën 5.12.2018 është urdhëruar njoftimi i akuzës përmbartuesit privat, përfundimi i hetimeve, si dhe njohja me aktet.

xiii. Në shkurt të vitit 2018 subjekti i rivlerësimit ka dërguar kërkesën për gjykim për shtetasit P. dhe M., për të cilët ka konkluduar se ata kanë konsumuar veprën penale, përkatësisht “mashttrim me pasoja të rënda” dhe “shpërdorim detyre”.

xiv. Në datën 9.2.2018 subjekti i rivlerësimit ka dërguar në gjykatë kërkesën për pushimin e çështjes në ngarkim të shtetasve GJ., akuzuar për veprën penale “mashttrim”.

48.3 Për sa më sipër, nga dokumentacioni i administruar deri në këtë fazë të hetimit, Komisionit i rezultoi se dukej se nuk ishte marrë në pyetje personi nën hetim/avokati mbrojtës i palës ndërgjyqëse, shtetasi A.P, detyrë kjo e caktuar për t’u kryer që në nisjen e hetimeve, përpara zgjatjes së afatit të hetimeve dhe për këtë shkak Komisioni i kërkoi subjektit të jepte shpjegime, si dhe të depozitonte dokumentacionin mbështetës edhe në lidhje me zvarritjen e pretenduar të hetimeve nga denoncuesi, si dhe lidhur me veprimet e ndërmarra nga Prokuroria e Përgjithshme lidhur me ankesën e denoncuesit. Po ashtu, Komisioni i kërkoi subjektit të qartësonte statusin e kërkesave të tij drejtuar gjykatës, ku njëra (që i përkiste shtetasve M. dhe P.) kishte si objekt kërkimi gjykimin e çështjes dhe tjetra (që i përkiste shtetasve GJ.) pushimin e saj, si dhe të depozitonte vendimmarrjet përkatëse të gjykatës (nëse kishte të tilla).

48.4 Subjekti, në parashtrimet e tij, ka shpjeguar se në datën 7.9.2017, nga ana e tij si prokuror është urdhëruar regjistrimi i procedimit penal për veprën penale “mashttrim”, parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal dhe po në të njëjtën datë (7.9.2017) ka nxjerrë urdhrin për kryerjen e veprimeve hetimore, me të cilin janë deleguar veprimet hetimore tek oficeri i policisë gjyqësore, z. V. S, me detyrat e përcaktuara qartë. Subjekti ka pasqyruar edhe veprimet hetimore që duhet të kryeshin si, sekuestrimi i dosjes përmbartimore me të cilën kishte nisur ekzekutimi i vendimit civil, administrimi i dosjes gjyqësore që i përkiste gjykimit civil, pyetja e shtetasit P. si avokat i çështjes civile dhe vijimi i ekzekutimit të

vendimit, por edhe e shtetasve GJ. si përfitues të shumës së vendosur për t'u marrë dhe ekzekutuar nga vendimi civil, administrimi i dokumentacionit, etj.

48.5 Subjekti ka sqaruar se nga ana e oficerit të policisë gjyqësore, në datën 9.11.2017, është bërë e mundur pyetja e personave nën hetim, A.GJ dhe A.GJ, të cilët kanë sqaruar faktin se me procesin gjyqësor është ngarkuar, nëpërmjet prokurës, avokati dhe ata nuk kishin dijeni për ecurinë e procesit. Subjekti ka prezantuar në mënyrë të përmbledhur historikun e çështjes, duke pasqyruar disa fakte të rezultuara prej vitit 2013, kur kishte ndërruar jetë shtetasja L.GJ (bashkëshortja e shtetasit A.GJ dhe nëna e shtetasës A.GJ), e cila kishte qenë në koma që nga viti 2008 dhe se me ndërrimin jetë të kësaj shtetaseje duhet të ishin kryer veprimet procedurale, duke zëvendësuar palën paditëse (L.GJ) me trashëgimtarët e saj, si dhe objekti i padisë, që rrjedhimisht do të ishte më i vogël sesa nëse vetë paditësja do të ishte gjallë dhe në gjendje kome.

48.6 Subjekti ka konfirmuar se njëkohësisht nga ana e oficerit të policisë gjyqësore është thirrur disa herë me anë të telefonit edhe personi nën hetim A.P (avokati i familjes GJ), por nuk është paraqitur. Ai ka sqaruar se rrjedhimisht, në datën 12.12.2017, është vendosur zgjatja e afatit të hetimeve për t'u pyetur ky person dhe përfundimi i hetimeve në këtë procedim.

48.7 Subjekti ka qartësuar se të dy shtetasit A. dhe A.GJ janë paraqitur rregullisht pas njoftimit me telefon, për t'u njohur me zgjatjen e afatit të hetimeve, ndërsa shtetasi A.P dhe përmbartuesi gjyqësor E.M nuk paraqiteshin pavarësisht njoftimit me telefon dhe në datën 26.12.2017 iu është dërguar me shkresë vendimi i zgjatjes së afateve në këtë procedim. Duke qenë se ata nuk paraqiteshin, e njëjta rrugë procedurale për personin nën hetim A.P është ndjekur edhe në përfundim të hetimeve në datën 9.2.2018, pas njoftimit paraprak për paraqitje edhe me shkresën e datës 5.2.2018. Ndërkohë, personat e tjerë nën hetim janë paraqitur rregullisht dhe kanë nënshkruar aktet.

48.8 Subjekti ka theksuar faktin se në këtë procedim, pas vendosjes së sekuestros mbi praktikën përmbartimore nga ana e prokurorisë, shtetasi A.P ka paraqitur ankim të veçantë, i cili është shqyrtuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në seancë gjyqësore, në të cilën ai vetë është paraqitur dhe ka marrë pjesë, ashtu si edhe ai si prokuror, nga ku rezulton dijenia e plotë e këtij shtetasi mbi procedimin dhe zgjedhjen e tij për t'u paraqitur në rastet kur ai vetë çmonte.

48.9 Subjekti ka sqaruar se duke marrë parasysh kompleksitetin e hetimeve, dokumentacionin e administruar si nga gjykatat ashtu edhe nga bankat, pretendimi i denoncuesit A.P për zvarritje të hetimeve nuk qëndron. Subjekti ka deklaruar se në lidhje me veprimet e Prokurorisë së Përgjithshme në këtë rast, nuk ka dijeni.

48.10 Subjekti ka deklaruar se në lidhje me kërkesat drejtuar gjykatës, për shtetasit A. dhe A.GJ është paraqitur kërkesa për pushim, e cila është pranuar nga gjykata sipas argumenteve të paraqitura nga ana e tij në kërkesë, duke qenë se ata nuk ishin në dijeni të fatit të proceseve dhe ecurisë së tyre. Po ashtu, ai ka deklaruar se çështja është pushuar edhe për përmbartuesin E.M, ndërkohë është dërguar për gjykim kërkesa për shtetasin A.P. Për këtë të fundit, subjekti ka konfirmuar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 21.12.2018, ka marrë vendim për deklarimin e pafajshëm.

48.11 Subjekti mbi këtë konfirmim ka sqaruar se në kushtet kur vendimi gjyqësor nuk ishte njoftuar, nga ana e tij është kërkuar rivendosja në afat e ankimit, duke qenë se ky vendim nuk ishte bërë asnjëherë hyrje në librin e brendshëm të prokurorisë, duke mos iu komunikuar zyrtarisht prokurorit edhe pas interesimit të tij në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ai ka deklaruar se si prokuror i çështjes nuk ishte njoftuar asnjëherë, se në datën 28.1.2019 ka kërkuar informacion zyrtar nga sekretaria e prokurorisë, nga e cila është administruar libri i brendshëm i njoftimeve, nga ku ka rezultuar e qartë se vendimi nr. ***, datë 21.12.2018, nuk ishte bërë hyrje në këtë prokurori, duke mos iu njoftuar asnjëherë

subjektit si prokuror i çështjes. Subjekti ka sqaruar se në kushtet kur nuk kishte marrë asnjëherë dijëni për vendimin nr. ***, datë 21.12.2018, nga ana e tij ishte kërkuar rivendosja në afat për të drejtën e ankimit.

48.12 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit, dokumentacionit të administruar, konstatoi disa fakte, të cilat ndikojnë në vlerësimin e tij në tërësi të vendimmarrjes.

i. Subjekti duket se ka munguar të provojë njoftimin e bërë shtetasit A.P/denoncuesit për marrjen e tij në pyetje, por e njehson njoftimin me faktin se ai ka pasur dijëni kur ka kundërshtuar në gjykatë me ankim të veçantë sekuestrimin e dosjes përbarimore. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar rezultoi një numër i konsiderueshëm memosh të shtetasit P, drejtuar subjektit, por edhe drejtuesit të organit të akuzës, ku cilësohet se nuk është thirrur për t'u pyetur, ndërkohë nuk u provua ndonjë kundërpërgjigje nga organi i akuzës. Nga verifikimi i akteve të fashikullit të administruar, për një periudhë rreth 5 muaj, nuk u konstatua ndonjë veprim hetimor në adresë të shtetasit P/denoncuesit. Gjithashtu, nuk u konstatua e administruar ndonjë provë që të pasqyronte njoftimin me telefon të shtetasit P, sikurse pretendon subjekti. Edhe zgjatja e afatit të kryerjes së hetimeve në dhjetor të vitit 2017, e cila është bërë për të pyetur denoncuesin, rezultoi e paarrirë, pasi nga dokumentacioni ky fakt nuk provohet, por edhe në prapësime subjekti mungoi të provojë që është thirrur denoncuesi për t'u marrë në pyetje.

ii. U vërejt se në regjistrimin e procedimit, nga subjekti i rivlerësimit janë lënë për t'u kryer disa detyra ku, ndër të tjera, edhe pyetja e denoncuesit. Njëkohësisht është vendosur zgjatja e afatit të hetimeve për të njoftuar dhe pyetur denoncuesin. Ky veprim procedural nuk rezultoi i kryer dhe njëkohësisht nuk jepën arsye se përse nuk është kryer.

iii. Nga analizimi i pretendimeve të subjektit, duket kontradiktor dhe i paargumentuar fakti i pretenduar nga subjekti se ai ka dërguar fillimisht në gjykatë, në shkurt të vitit 2018, kërkesën për gjykim për shtetasit A.P dhe E.M, për të cilët ka konkluduar se ata kanë konsumuar veprën penale “mashttrim me pasoja të rënda” dhe “shpërdorim detyre”, ndërsa në prapësime citon se ka kërkuar pushimin e çështjes ndaj përbarimuesit M., pasi kishte rezultuar se kërkesën në gjykatë për të kërkuar ekzekutimin e vendimit civil të dëmshpërblimit e kishte bërë njëri prej kreditorëve, vajza e të ndjerës. Trupi gjykues vlerëson se ky fakt duket se nuk qëndron, pasi dosja përbarimore ka të administruar që në krye të herës vendimin e lëshimit të urdhrin të ekzekutimit, me të cilin vihet në lëvizje përbarimuesi dhe fakti që ajo është sekuestruar nga organi i akuzës, tregon se ka qenë lehtësisht i verifikueshëm personi që ka kërkuar lëshimin e urdhrin të ekzekutimit, i cili, gjithashtu, pasqyrohet saktësisht në pjesën hyrëse të vendimit. Duket se ky fakt i njohur që në sekuestrimin e praktikës përbarimore nuk mund të prezantohet si një fakt i ri në kërkimin e subjektit në gjykatë, për të ndryshuar objektin e kërkimit ndaj përbarimuesit gjyqësor, shtetasit E.M, nga *gjykim në kërkesë për pushimin e çështjes ndaj tij*, akuzuar për veprën penale “shpërdorim detyre”.

iv. Nga verifikimi i vendimit gjyqësor për dhënien e pafajësisë avokatit të çështjes civile, ku vërehet se subjekti ka kërkuar dënimin e të pandehurit P. me 7 vjet heqje lirie, rezultoi se ai, si përfaqësues i organit të akuzës, nuk ka qenë në mungesë, por pasqyrohet prezent në shpalljen e vendimit dhe njëkohësisht subjekti nuk provoi të kundërtën e këtij konfirmimi gjyqësor. Në këto kushte, rivendosja në afat duket si një kërkesë e paargumentuar nga subjekti, në kundërshtim me nenin 147/1 të Kodit të Procedurës Penale.

48.13 Trupi gjykues nga shqyrtimi në tërësi i kësaj çështje, çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka mirëadministruar dosjen penale, nuk provoi edhe në shpjegime faktin se ishte arritur marrja në pyetje e të kallëzuarit A.P, duke vepruar në këtë mënyrë, në kundërshtim me nenin 73/2,3 dhe 74/1 dhe 2, të Ligjit nr.96/2016.

49. Denoncim¹⁵⁴ i shtetasit E.L

Denoncuesi në ankimin e tij jep informacione të përgjithshme, dyshon për implikime të subjektit të rivlerësimit në problematika të ndryshme në ushtrimin e detyrës, por nuk hedh dritë mbi çështje konkrete. Denoncuesi nuk ka paraqitur ndonjë provë për të konkretizuar pretendimet e tij. Nga shqyrtimi i këtij denoncimi, trupi gjykues nuk vëren ndonjë fakt apo rrethanë që mund të përbëjë provë në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

50. Denoncim¹⁵⁵ i shtetasit D.P

50.1 Denoncuesi në ankimin e tij pretendon për vendim të padrejtë dhe haptazi në mbrojtje të të kallëzuarit prej tij, të quajtur I.I, i kallëzuar më parë dhe i dënuar me 2 vite burgim për shpërdorim detyre (gjithnjë sipas informacionit të denoncuesit). Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit ka njohje me këtë shtetas dhe për këtë shkak ka kërkuar edhe përjashtimin e tij për të hetuar çështjen e kallëzuar. Denoncuesi ka depozituar disa dokumente. Nga aktet e administruara vërehet se denoncuesi konfirmon se ka paraqitur kallëzim ndaj shtetasit I. për shkak të një huaje të konsiderueshme, të cilin ky i fundit ia ka marrë me pretendimin për të blerë një klinikë, porse nuk ia ka kthyer me gjithë kërkimet e vazhdueshme të denoncuesit. Denoncuesi ka pretenduar se ka mbajtur komunikime me telefon dhe mesazhe për të realizuar kthimin e shumës, por nuk ia ka arritur. Nëpërmjet një kërkesë të denoncuesit është kërkuar përjashtimi i prokurorit/subjektit të rivlerësimit nga çështja.

50.2 Denoncuesi ka sqaruar se subjekti, fillimisht, mbi kallëzimin e bërë në vitin 2014 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal nr. ***, datë 11.2.2014. Më tej informon se vendimi i mosfillimit është ankimuar prej tij dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur shfuqizimin e vendimit, vendim ky i mbetur në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë. Denoncuesi ka pretenduar se për këto vendimmarrje të padrejta ka kërkuar edhe përjashtimin e subjektit nga hetimi i kësaj çështjeje.

50.3 Po nga dokumentacioni që denoncuesi ka depozituar rezultoi se:

- i. Subjekti i rivlerësimit, me vendimin datë 19.2.2014, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin e depozituar nga denoncuesi, i regjistruar me nr. ***, datë 11.2.2014, për kryerjen e veprës penale “mashttrim”. Në këtë vendim arsyetohet se ekziston një marrëdhënie juridiko-civile mes palëve dhe për këtë shkak është orientuar kallëzuesi se mund t’i drejtohet gjykatës me padi civile.
- ii. Pas ankimit të vendimit të subjektit të rivlerësimit datë 19.2.2014, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 15.6.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 608 akti, datë 24.6.2014, i cili kishte shfuqizuar vendimin e mosfillimit dhe vazhdimin e hetimeve në bazë të kallëzimit të shtetasit P., me argumentin se: (a) nga organi i akuzës nuk është kryer asnjë veprim hetimor procedural; (b) diktohet nevoja e kryerjes së veprimeve hetimore që lidhen me thirrjen dhe pyetjen e kallëzuesit P. rreth fakteve të parashtruara në kallëzim; (c) nevojitet thirrja dhe pyetja e të kallëzuarit I.B rreth arsyeve të mospërmbushjes së detyrimit të pretenduar në kallëzim; (ç) nevojitet kryerja e një ballafaqimi midis palëve; (d) nevojitet kqyrja dhe administrimi i akteve me vlerë provuese, të cilat kallëzuesi pretendon se i disponon; (dh) por edhe kryerja e veprimeve të tjera hetimore që do të plotësonin kuadrin e një hetimi të plotë në lidhje me faktet e pretenduara.
- iii. Pas regjistrimit të procedimit, subjekti i rivlerësimit me vendimin datë 29.12.2015 ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. ***, për veprën penale “mashttrim” në zbatim të këtij vendimi.

¹⁵⁴ Nr. *** prot., datë 17.4.2019, administruar në dosjen e Komisionit.

¹⁵⁵ Nr. *** prot., datë 2.5.2019, administruar në dosjen e Komisionit.

- iv. Pas ankimimit të këtij vendimi nga kallëzuesi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. *** akti, datë 23.2.2017, ka vendosur shfuqizimin e vendimit të pushimit dhe kthimin e akteve për hetime të mëtejshme, vendim ky i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. *** , datë 16.5.2018.
- v. Në arsyetim e saj Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka evidentuar faktin se në hetimet e kryera nga prokurori është administruar një kontratë qiraje nga shtetasi I/i kallëzuar, për një klinikë dentare, porse nga subjekti nuk është kryer verifikimi nëse kjo pasuri është deklaruar në institucionin e pasurive.
- vi. Arsyetimi citon se kontrata vërteton faktin e pretenduar nga kallëzuesi se paratë i janë dhënë shtetasit I për të blerë një lokal dhe se kjo kontratë është bërë pasi ka bërë kallëzim kërkuesi. Arsyetimi pasqyron faktin se në këtë rast nuk është kryer ballafaqimi mes palëve dhe se duhet të kryhet ballafaqimi ndërmjet kallëzuesit D.P dhe shtetasit I.I. Duhet të sekuestrohet telefoni dhe të bëhet këqyrja e thirrjeve telefonike, tabulateve apo mesazheve të bëra ndërmjet telefonit të kallëzuesit me të kallëzuarin I.
- vii. Prokuroria, arsyeton gjykata, nuk ka verifikuar nëse vërtet shtetasi I.I e ka përfituar shumën 70.000 euro (pasi në atë kohë ka qenë drejtor i politikave në Ministrinë e Punës) apo ky pretendim ishte gënjeshtër dhe mashtrim për të futur në dorë pasurinë.
- viii. Gjykata ka lënë detyrë që të pyeten dhe ballafaqohen edhe shtetasit S.M, A.Y, P.P të cilët kanë qenë miq të përbashkët dhe në dijeni të dhënies së kësaj shume shtetast I.I.
- ix. Arsyetimi vijon të pasqyrojë faktin se nga organi i akuzës nuk janë kryer të gjithë detyrat e lëna nga vendimi i gjykatës së shkallës së parë për shfuqizimin e vendimit të mosfillimit, i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë.
- x. Në datën 24.12.2018, subjekti i rivlerësimit i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesë *për pushimin e çështjes penale nr. *** , datë 2.9.2015.*
- xi. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. *** akti, datë 28.9.2019, ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. *** , datë 2.9.2015.

50.4 Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të jepte shpjegime dhe dokumentonte, pasi dukej se ishte vepruar në kundërshtim me nenin 73 të ligjit nr. 96/2016, pasi nga ana e tij nuk ishin kryer veprimet e nevojshme hetimore dhe, për këtë shkak, çështja ishte kthyer në mënyrë të përsëritur nga gjykata. Po ashtu, Komisioni i kërkoi subjektit të qartësonte statusin aktual të çështjes deri aktualisht.

50.5 Subjekti, ndër të tjera, në parashtrimet e tij ka shpjeguar se në datën 11.2.2014 shtetasi D.P kishte paraqitur kallëzim penal ndaj shtetasit I.I për veprën penale “mashtrim”, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal. Në kallëzim referohet se janë marrë vlera monetare hua dhe nuk po ktheheshin nga i kallëzuar dhe se këto vlera ishin dhënë hua për shkak të njohjes së të kallëzuarit, nëpërmjet shtetasit P.P. Subjekti ka konfirmuar se është bërë vendimi i mosfillimit në datën 19.2.2014, për faktin se midis palëve ekzistonte një marrëdhënie juridiko-civile e huas, rrjedhimisht kallëzuesi mund t’i drejtohej me padi civile gjykatës, për përmbushjen e detyrimit kontraktor, kthimin e huas dhe shpërblimin e dëmit. Subjekti ka qartësuar se vendimi i mosfillimit është shfuqizuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. *** akti, datë 24.6.2014, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. *** , datë 15.6.2015. Gjykata ka lënë si detyrë pyetjen e kallëzuesit, të të kallëzuarit dhe administrimin e akteve me vlerë provuese, të cilat pretendonte se i dispononte kallëzuesi. Në datën 3.9.2015 është urdhëruar regjistrimi i procedimit penal nr. *** , për veprën penale “mashtrim”, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal. Nga ana e tij është urdhëruar kryerja e veprimeve hetimore, sipas urdhërimeve të

gjykatës. Pas kryerjes së veprimeve hetimore, në datën 29.12.2015, ka marrë vendim për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. ***, viti 2015. Subjekti ka sqaruar edhe shkaqet se përse është arritur në këtë konkluzion. Subjekti ka sqaruar se ndaj vendimit të pushimit është ushtruar ankim nga kallëzuesi D.P dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. *** akti, datë 23.2.2017, ka vendosur shfuqizimin e vendimit të pushimit, i cili është lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 16.5.2018, të Gjykatës së Apelit Tiranë. Subjekti ka shpjeguar se nga gjykata janë lënë detyrat e kryerjes së ballafaqimit midis kallëzuesit dhe të kallëzuarit, sekuestrimi i telefonave dhe këqyrja e thirrjeve të tyre, të pyeten shtetasit S.M dhe A.Y (*pavarësisht se ish-in pyetur nga ana jonë*), si dhe shtetasi P.P. Subjekti ka deklaruar se me vijimin e hetimeve janë kryer të gjitha detyrat e lëna nga gjykata dhe në datën 24.12.2018 i është bërë kërkesë gjykatës për pushimin e çështjes penale nr. ***, viti 2018, e cila është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr.***, datë 28.2.2019, vendim ky i mbetur në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin e saj nr. ***, datë 17.4.2019. Subjekti ka shpjeguar se nga ana e tij si prokuror në këtë çështje është hetuar në mënyrë të plotë dhe objektive, duke u vërtetuar fakti se vendimmarrja e tij që në momentin fillestar, ishte e saktë, e drejtë dhe e bazuar në ligj, pasi nuk provohet në asnjë rast ekzistenca e faktit penal dhe se nga i kallëzuarit I.I ishte kryer ndonjë veprim penal. Ai ka theksuar se veprimet e tij dhe hetimi i kësaj çështjeje nuk rezultojnë të jenë në kundërshtim me përcaktimet e nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, i cili trajton aftësitë profesionale të prokurorit, si për njohuritë ligjore ashtu edhe arsyetimin ligjor. Sipas pikës 4 të nenit 73 të ligjit, çmuarja e aftësive profesionale të prokurorit realizohet pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet.

50.6 Subjekti ka depozituar dokumentacionin mbështetës mbi shpjegimet e dhëna.

50.7 Trupi gjykues në analizë të shpjegimeve të subjektit, dokumentacionit të depozituar, në raport me pretendimet e denoncuesit, vërejtë se në të dy arsyetimet e vendimeve të gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përkatësisht me nr. *** Akti, datë vendimi 24.06.2014 dhe nr. *** Akti, datë vendimi 23.02.2017, për kthimin e vendimit të Mosfillimit të procedimit penal datë 19.02.2014 dhe kthimin e vendimit të Pushimit të marrë nga subjekti në datë 29.12.2015 (vendime të lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë), janë cituar mangësitë e subjektit të rivlerësimit për të ndërmarrë hetimin dhe kryer veprimet e duhura hetimore dhe më konkretisht: a) fillimisht në prishjen e vendimit të mosfillimit është konstatuar se i) nga organi i akuzës nuk është kryer asnjë veprim hetimor procedural, ii) diktohet nevoja e kryerjes së veprimeve hetimore që lidhen me thirrjen dhe pyetjen e kallëzuesit P. rreth fakteve të parashtruara në kallëzim, thirrja dhe pyetja e të kallëzuarit I.I rreth arsyeve në lidhje me mospërmbyshjen e detyrimit të pretenduar në kallëzim, iii) nevojitet kryerja e një ballafaqimi midis palëve, kqyrja dhe administrimi i akteve me vlerë provuese, të cilat kallëzuesi pretendon se i disponon, si dhe kryerja edhe e veprimeve të tjera hetimore që do të plotësonin kuadrin e një hetimi të plotë në lidhje me faktet e pretenduara, b) edhe pas prishjes në mënyrë të përsëritur, të vendimit të Pushimit të procedimit penal nr.***, gjykata sërish ka konstatuar mangësitë e subjektit për të kryer hetimet e plota duke arsyetuar se nuk janë kryer të gjithë detyrat e lëna nga vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për shfuqizimin e vendimit të mosfillimit datë 19.02.2014, i lënë në fuqi nga gjykata e Apelit Tiranë.

Mbi konstatimet e Gjykatës, trupi gjykues vlerëson se nuk qëndron pretendimi i subjektit, se për këtë çështje është analizuar themeli i saj, përkundër argumentit të vetë gjykatës ku është lënë si detyrë procedurale për tu kryer, mes disa detyrave të tjera, edhe ballafaqimi midis denoncuesit dhe të kallëzuarit I. Në të tilla kushte, trupi gjykues vlerëson se subjekti ka vepruar në trajtimin e kësaj çështjeje në kundërshtim me kërkesat e nenit 73/2 të Ligjit nr.96/2016, si pasojë e të cilës çështja është kthyer në mënyrë të përsëritur.

51. Denoncim¹⁵⁶ i shtetasit S.Ç

Denoncuesi në ankimin e tij pretendon për shkelje të kryera nga disa prokurorë, në disa çështje të kallëzuara prej tij lidhur me mospërbushjen e një detyrimi kontraktor mes kompanisë që ai drejton si ndërtues, një shtetaseje dhe një kompanie tjetër ndërtimore. Denoncuesi ankohet se nuk janë kryer hetime të plota dhe, për pasojë, nuk janë regjistruar procedimet penale, por përkundër ato janë mosfilluar. Denoncuesi, në rendin e subjekteve për të cilët ankohet, përfshin edhe subjektin e rivlerësimit, por nga dokumentacioni shoqëruar nuk rezulton që subjekti të ketë hetuar apo përfaqësuar ndonjë çështje të tij.

Nga shqyrtimi i këtij denoncimi Komisioni nuk vëren ndonjë fakt apo rrethanë që mund të përbëjë provë në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

52. Denoncim¹⁵⁷ i shtetasit E.T

52.1 Denoncuesja nëpërmjet djalit të saj ankohet për një çështje penale të vënë në lëvizje prej nënës së tij dhe trashëgimtarëve ligjore të ish-pronarit (familja V, etj.) pranë organit të prokurorisë, nën akuzën e vjedhjes së pronës nëpërmjet mashtrimit në bashkëpunim, pastrimit të produkteve të veprës penale, falsifikimit të dokumenteve, etj. dhe, konkretisht, për ndarjen që i është bërë çështjes për njërin prej të akuzuarve, av. A.D, me qëllim transferimin e tij për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Këtë veprim procedural gjyqësor denoncuesi e pasqyron si të kryer në bashkëpunim mes subjektit të rivlerësimit dhe gjyqtarës së çështjes A.B. Por, pavarësisht pretendimit konkret, denoncuesi sqaron se subjekti i rivlerësimit ndjek çështjen në gjykatë, duke lënë të nënkuptuar se nuk është subjekti prokuror i çështjes. Denoncuesi nuk ka shoqëruar denoncimin me ndonjë dokumentacion.

Komisioni i kërkoi subjektit të jepte shpjegime¹⁵⁸ në kuadrin e një sqarimi më të plotë të çështjes objekt hetimi.

52.2 Subjekti në parashtrimet e tij ka sqaruar se nuk ka qenë prokuror i çështjes, por është ngarkuar për të përfaqësuar akuzën në gjykim me autorizimin e datës 21.1.2021.

52.3 Subjekti ka depozituar vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për dërgimin e çështjes në gjyq dhe vendimin e ndarjes/moskompetencës.

52.4 Nga verifikimi i akteve rezulton se çështja në ngarkim të përfaqësuesit të të pandehurit A.D (avokat A.D) është veçuar me dakordësinë e përfaqësuesit të akuzës (subjektit të rivlerësimit) dhe të pandehurve, për kompetencë tokësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

52.5 Në këtë çështje përfaqësuesi i viktimave ka kundërshtuar këtë veçim të çështjes për shkak se sipas nenit 76 të Kodit të Procedurës Penale radha e kompetencës nis nga vendi ku është kryer vepra penale ose tentohet se do të kryhet dhe për shkak se vendi është Tiranë veçimi sipas tyre ka qenë i kundërligjshëm. Gjykata, me vendimin e saj, ka vendosur ndarjen dhe veçimin e çështjes.

52.6 Në analizë të shpjegimit të subjektit dhe dokumentacionit të administruar, trupi gjykues nuk vëren fakte apo rrethana që ndikojnë në vlerësimin e kriterit profesional të subjektit të rivlerësimit.

53. Denoncim¹⁵⁹ i shtetasit G.J.M (bashkim i dy denoncimeve)

53.1 Denoncuesi në ankimin e tij pretendon se nuk është marrë në konsideratë kërkesa e tij për përjashtim të subjektit të rivlerësimit nga çështja penale, të cilën ai e ka vënë në lëvizje ndaj dy personave të kallëzuar (A.D dhe S.Ç) për veprën penale “mashtrim me pasoja të rënda”, parashikuar nga neni 143 i

¹⁵⁶ Nr. *** prot., datë 9.9.2019, administruar në dosjen e Komisionit.

¹⁵⁷ Nr. *** prot., datë 17.3.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

¹⁵⁸ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

¹⁵⁹ Nr.*** prot., datë 21.10.2019, nr. *** prot., datë 4.10.2019.

Kodit Penal. Ai ankohet ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal, vendosur nga subjekti i rivlerësimit, i cili pas ankimit është shfuqizuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

53.2 Denoncuesi ka depozituar dokumentacion mbështetës.

53.3 Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se palët, shtetasi D. si administrator i shoqërisë “***” sh.p.k., shtetasi Ç. dhe vetë denoncuesi kanë hyrë në marrëdhënie të ndërsjella mes tyre për të shkëmbyer pasuri, për të kryer punime në favor të njëri-tjetrit, etj. dhe, më tej, janë konfliktuar mes tyre për mosdakordësi, për nënshkrim të deklaratave noteriale në padijeni të tyre, etj.

53.4 Denoncuesi i ka kallëzuar këta dy shtetas për veprën penale “mashttrim me pasoja të rënda”, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal, në datën 19.3.2018.

53.5 Në datën 3.4.2018, subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillimin e procedimit penal nr. ***, datë 23.3.2018, pasi fakti nuk parashikohej nga ligji si vepër penale. Në dosje është depozituar edhe deklaratat noteriale datë 20.3.2014.

53.6 Në datën 17.10.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. *** akti, datë 17.10.2018, mbi ankimin e denoncuesit ka vendosur shfuqizimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal duke lënë edhe detyrat përkatëse.

53.7 Më konkretisht është lënë si detyrë: (a) verifikimi i kthimit të pagesës nga shkëmbimi i pasurive sikurse është pranuar në deklaratën noteriale mes palëve, por se pretendohet se nuk është kthyer, se thëniet në deklaratë janë fiktive dhe kanë ndodhur si pasojë e mashtimit nga shtetasi D. dhe Ç.; (b) marrja në pyetje e motrës së kallëzuesit, e cila ka pasur dijeni për situatën, si dhe për faktin se ajo kishte vënë në dispozicion të organit të akuzës edhe një video për të provuar komunikimet mes palëve, e administratorit të shoqërisë “***”; (c) verifikimi dhe analizimi i CD-së, e depozituar si provë; (ç) ballafaqimi mes palëve nëse do të kishte thënie kontradiktore, si dhe duhej bërë vlerësimi i disa mesazheve të shkëmbimeve telefonike midis shtetasve M. dhe Ç., të cilat shtetasi M. i kishte vënë në dispozicionin të organit të akuzës, etj.

53.8 Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 22.7.2019, të Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila gjithashtu arsyeton se vendimi i subjektit të rivlerësimit është marrë në zbatim të gabuar të ligjit material dhe procedural, duke lënë gjithashtu thuajse të njëjtat detyra sikurse kishte lënë gjykata e shkallës së parë.

53.9 Pas prishjes së vendimit të prokurorit nga gjykatat, drejtuesi i organit të akuzës ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kallëzuesit/denoncuesit për përjashtimin e subjektit të rivlerësimit nga hetimi i çështjes, pasi nuk kishte çmuar ndonjë të dhënë apo arsye serioze që lidhej me detyrën e prokurorit për ta zëvendësuar.

53.10 Subjekti i rivlerësimit, në datën 4.12.2020, pas regjistrimit të procedimit penal nr. ***, datë 24.9.2019, dhe pasi ka kryer veprimet hetimore në zbatim të vendimeve gjyqësore ka njoftuar kallëzuesin GJM për përfundimin dhe njoftimin e tyre, si dhe komunikimin e aktit, duke konkluduar se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale dhe se çështja duhet të pushohet. Në tërësi të arsyetimit pas kryerjes së veprimeve është konkluduar se në fakt shuma e pretenduar si e palikuiduar nga shtetasi M. në favor të tij për shkak të shkëmbimit të pasurisë është likuiduar, por se marrësi i saj ka qenë shtetasi Ç., të cilit kallëzuesi i kishte pasur një shumë të marrë hua e të pashlyer.

53.11 Për sa rezultoi më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit: (i) të japë shpjegime¹⁶⁰ lidhur me moskryerjen e hetimeve dhe marrjen e vendimit në datën 3.4.2018, ku kishte vendosur mosfillimin e

¹⁶⁰ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

*procedimit penal nr. ***, datë 23.3.2018, çështje për të cilën gjykata ka vendosur prishjen e vendimit, duke lënë gjithashtu detyra; si dhe (ii) të qartësojë dhe dokumentojë ecurinë e çështjes në organet e gjyqësorit (pra statusin e saj) pas së cilës kishte kërkuar përfundimin e hetimeve dhe pushimin e saj.*

53.12 Subjekti, ndër të tjera, në parashtrimet e tij ka sqaruar se shtetasi G.J.M, në datën 23.3.2018, ka paraqitur kallëzim me shkrim në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili është regjistruar me nr. ***. Ky shtetas pretendonte se ishte mashtruar nga shtetasi A.D, administrator i shoqërisë “****” sh.p.k.

53.13 Subjekti ka përshkruar historikun e çështjes bazuar në materialin kallëzues të administruar në organin e akuzës.

53.14 Subjekti deklaroi se nga ana e tij, pasi është vlerësuar ky kallëzim penal, në datën 3.4.2018, është vendosur mosfillimi i hetimeve, duke qenë se fakti nuk parashikohej nga ligji si veprë penale.

53.15 Subjekti ka argumentuar se, nga rrethanat e faktit të dala më sipër, rezultonte se nuk kishte asnjë veprim të kryer nga ndonjë person, me qëllim shtënien në dorë të pasurisë së shtetasit G.J.M. Kallëzuesi kishte hyrë në një marrëdhënie juridiko-civile me shoqërinë “****” sh.p.k. Në këto kushte, ka shpjeguar subjekti, vendimmarrja e tij për mosfillimin e hetimeve në lidhje me këtë kallëzim është e bazuar ligjërisht në kushtet kur nga aktet rezultonte qartë mungesa e elementeve të veprës penale. Subjekti ka sqaruar faktin se, sipas tij, *vendimet e mosfillimit të hetimeve nisur nga përmbajtja e nenit 148 të Kushtetutës, të ndryshuar, rezulton se prokuroria është i vetmi organ që ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Në kuadrin e detyrimit që asnjë person të mos ndiqet penalisht padrejtësisht, neni 290 i Kodit të Procedurës Penale përcakton rastet e mosfillimit të procedimit penal. Vendimi për mosfillimin e procedimit penal merret nga prokurori. Kompetenca e prokurorit për mosfillimin e procedimit penal, në rastet e parashikuara në ligj, si aspekt i funksionit të tij kushtetues të ushtrimit të ndjekjes penale, është në pajtim me parimin e shtetit të së drejtës. Rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit penal si rregull janë rrethana që nuk kanë nevojë për kryerjen e një sërë veprimesh hetimore që të provohen, pasi janë të verifikueshme nëpërmjet dokumenteve apo ballafaqimit me dispozitat ligjore. Për të bërë një diferencë mund të sjellim në vëmendje rastet e parashikuara në nenin 290 për mosfillimin e procedimit dhe rastet në nenin 329 të Kodit të Procedurës Penale për pushimin e çështjes sepse janë pothuaj të përafërta. Prandaj, dallimi në vendimmarrje qëndron te shkaku që pengon zhvillimin e procedimit. Nëse shkaku është i qartë dhe i dukshëm në momentin e njoftimit të veprës penale, atëherë prokurori disponon me vendim për mosfillimin e procedimit. Në rast të kundërt, nëse nevojitet kryerja e veprimeve komplekse prokurori disponon me vendim për pushimin e çështjes apo me kërkesën për pushim, pasi ka kryer disa veprime hetimore të duhura për të sqaruar rastin.*

53.16 Nën këtë shpjegim, subjekti ka sqaruar se: *“Kjo ka qenë arsyeja se pse në këtë rast konkret nuk janë kryer hetime, por është vendosur mosfillimi i tyre. Subjekti ka sqaruar statusin e vendimmarrjes së tij. Më konkretisht, ka konfirmuar se ky vendim është shfuqizuar me vendimin nr. *** akti, datë 17.10.2018, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pas ankimit tonë është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***, datë 22.7.2019”.*

53.17 Subjekti ka qartësuar se në zbatim të vendimit të gjykatës, në datën 24.9.2019, është regjistruar procedimi penal nr. ***, për veprën penale “mashtrim” dhe në datën 7.12.2020 çështja është dërguar për pushim dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. *** akti, datë 29.4.2021, ka vendosur të kthejë aktet në prokurori për vijimin e hetimeve. Kundër këtij vendimi subjekti ka konfirmuar se ka ushtruar ankim, i cili është në pritje të shqyrtimit nga Gjykata e Apelit Tiranë.

53.18 Në të tilla kushte, nga trajtimi i këtij denoncimi, trupi gjykues vlerëson se mangësitë e konstatuara nga gjykata për të kryer veprime hetimore, sikurse është konstatuar në vendimin nr. *** akti, datë 17.10.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (*referuar më sipër në pikën 53.7*) dhe nr. *** akti, datë 29.4.2021, konsiderohen në vlerësimin tërësor të subjektit të rivlerësimit.

54. Denoncim¹⁶¹ i shtetas R.S (bashkim i dy denoncimeve)

54.1 Denoncuesja ankohet ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal, dhënë nga subjekti i rivlerësimit mbi kallëzimin e saj ndaj përmbauesit V.SH për shpërdorim detyre. Ndër të tjera, ajo pretendon se prokurori nuk ka marrë në pyetje përmbauesin, atë dhe bashkëshortin e saj për të hedhur dritë mbi kërkimin e saj në kallëzim. Kallëzuesja ka kallëzuar përmbauesin për shkak të veprimeve të tij të padrejta në nxjerrjen në ankand të disa pasurive, të cilat e kanë cenuar atë dhe që janë shitur nga “Alpha Bank” për llogari të “****” sh.p.k., pasuri këto të fituara gjatë martesës së saj me ortakun (e shoqërisë “****” sh.p.k.) dhe bashkëshortin e saj njëkohësisht, z. A.S. Denoncuesja ka sqaruar se ndërkohë ata kanë ndjekur edhe një proces civil për kundërshtim të veprimeve përmbaimore.

54.2 Gjithashtu, ajo ka pasqyruar faktin se ka kallëzuar në prokurori përmbauesin V.SH, për të cilin subjekti i rivlerësimit ka vendosur *Mosfillimin e procedimit penal*. Ndërkohë, ajo ka konfirmuar se vendimi i prokurorit është prishur dhe çështja është kthyer për t’u kryer veprime hetimore. Denoncuesja nuk ka bashkëngjitur dokumentacion.

54.3 Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit: (a) të jepte shpjegime¹⁶² lidhur me statusin ligjor të vendimmarrjes së tij, e cila rezultoi e prishur nga gjykata, për shkak të moskryerjes së veprimeve hetimore; (b) të qartësojë dhe dokumentojë ecurinë e kësaj çështjeje deri aktualisht; si dhe (c) të depozitojë vendimin e mosfillimit të procedimit penal.

54.4 Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e tij, ndër të tjera, ka sqaruar se shtetasja R.S, në datën 11.2.2020, ka paraqitur kallëzim penal në ngarkim të përmbauesit gjyqësor, për kryerjen e veprës penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Subjekti ka prezantuar historikun e çështjes. Ndër të tjera, subjekti ka sqaruar se kallëzuesja në materialin kallëzues parashtronte se kishte paraqitur padi civile në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt “Kundërshtimi i veprimeve përmbaimore të ndërmarra nga përmbauesi gjyqësor privat V.SH”. Në atë gjykim civil kallëzuesja shprehej se gjykata i kishte kërkuar përmbauesit të paraqiste dosjen e plotë përmbaimore, ku të përfshihej vendimi i tij për kalimin e pronësisë së pasurive objekt gjykimi dhe akte të tjera. Subjekti ka deklaruar se nga praktika e akteve të depozituara nga kallëzuesja rezultojnë veprime përmbaimore të ndërmarra nga përmbauesi, qëndrimi i tij me shkrim i parashtruar në gjykimin civil, etj. Subjekti ka parashtruar se nga ana e tij, pas studimit të materialit kallëzues, është vlerësuar se ndodheshin përpara një konflikti juridiko-civil, në kushtet kur nga vetë kallëzuesja konfirmohej fakti se i ishte drejtuar gjykatës me padi civile për kundërshtimin e veprimeve përmbaimore, duke qenë seksioni civil i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, gjykata kompetente për të përcaktuar vlefshmërinë ose jo të veprimeve përmbaimore të kryera nga përmbauesi gjyqësor. Subjekti ka qartësuar se rrjedhimisht pretendimet e kallëzueses në atë fazë nuk përmbanin ndonjë element të ndonjë fakti penal dhe nga ana e tij, në datën 27.2.2020, është proceduar me vendim “Për mosfillimin e procedimit penal”, në lidhje me materialin kallëzues nr. ***, datë 25.2.2020. Subjekti ka konfirmuar se ky vendim i është komunikuar kallëzueses, me shkresën nr. *** prot., datë 12.3.2020, të drejtueses së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Subjekti ka shpjeguar se nga ana e kallëzueses është paraqitur ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila, me vendimin nr. *** akti, datë 26.6.2020, ka vendosur të

¹⁶¹ Nr. *** prot., datë 30.4.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

¹⁶² Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

pranojë ankimin dhe të shfuqizojë vendimin e mosfillimit të procedimit penal që i përket kallëzimit nr. ***, viti 2020, duke urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për kryerjen e veprimeve hetimore.

54.5 Subjekti ka konfirmuar se kundër vendimit të gjykatës, prej tij është paraqitur ankim, i cili është në pritje të shqyrtimit pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe njëkohësisht ka depozituar praktikën e akteve të cituara nga kjo dosje.

54.6 Trupi gjykues, në vlerësim të situatës faktike si më sipër, çmon se, bazuar në nenin E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, kjo çështje nuk mund të jetë objekt rivlerësimi tërësor, pasi deri në fazën e analizuar në këtë vendimmarrje ajo rezultoi ende nën shqyrtim nga gjykata.

55. Denoncim¹⁶³ i shtetasit M.L (bashkim i tre denoncimeve)

55.1 Denoncuesi ankohet ndaj procedimit penal nr. ***, të regjistruar nga subjekti i rivlerësimit. Denoncuesi ankohet se çështja ka vijuar për dy vite radhazi dhe se sipas pretendimit të tij objekti i çështjes ka qenë një alibi e krijuar sikur ai i kishte marrë prokurorit E.K një shumë të konsiderueshme dhe nuk ia kishte kthyer. Denoncuesi shpjegon se në fakt kjo situatë e ka fillësën në kallëzimin që ai kishte bërë më parë për prokurorin K, si i përfshirë në korrupsion gjatë hetimit nga Task Forca për një grabitje të disa dynym toke në bregdet, çështje e bërë publike edhe në media. Denoncuesi shpjegon se subjekti në hetimin e procedimit penal ka ndikuar duke e nxjerrë atë person në kërkim policor në mënyrë që të mos kishte mundësi të dëshmonte në procesin gjyqësor që zhvillohej në gjykatë lidhur me çështjen pronësore.

55.2 Komisioni administroi fashikullin penal¹⁶⁴ që i përket këtij procedimi të bashkuar. Nga aktet e administruara në fashikull konstatohen dy kallëzime respektive, përkatësisht njëri i depozituar nga shtetasi E.K dhe tjetri nga shtetasi D.A, i cili pretendon se është mashtruar nga shtetasit K dhe L/denoncuesi dhe se këta shtetas kanë falsifikuar dokumente për përfitimin e pronësisë së tij. Bashkimi i dy procedimeve në një të vetëm, pas regjistrimit të tyre, ka ardhur si rezultat i një pronësie të shtetasit A, për të cilën palët kanë paraqitur pretendimet e tyre në mënyrë të ndërsjellë për dhënie huaje, mashtrime për përfitimin e pronësisë, etj. Në tërësi të shqyrtimit të akteve rezultoi se janë kryer veprimet hetimore dhe se në përfundim subjekti i rivlerësimit i është drejtuar me kërkesë për gjykim Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për kallëzimin e shtetasit E.K kundër denoncuesit, i akuzuar për veprën penale “mashttrim me pasoja të rënda” dhe për pushimin e çështjes penale, regjistruar mbi bazë të kallëzimit të shtetasit D.A po për të njëjtën vepër penale.

55.3 Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime dhe të dokumentojë statusin e secilit prej kërkimeve të tij në gjykatë, përkatësisht lidhur me kërkesën për gjykim mbi kallëzimin e shtetasit E.K dhe lidhur me kërkesën për pushimin e çështjes mbi kallëzimin e shtetasit D.A.

55.4 Subjekti, ndër të tjera, ka sqaruar historinë e ecurisë së çështjes. Subjekti ka sqaruar se nga veprimet hetimore të kryera rezultonte qartë që fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale dhe kjo çështje penale duhet të pushohej. Subjekti ka konfirmuar se me vendimin nr. *** akti, datë 15.2.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendosur pranimi i kërkesës së prokurorit dhe pushimi i çështjes penale, që i përket procedimit penal nr. ***, viti 2019, për veprën penale “mashttrim”, të parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal, i cili ka marrë formë të prerë, duke mos u ankimuar, në datën 18.3.2021. Subjekti ka deklaruar edhe në lidhje me veprimet e të pandehurit M.L (L.SH), në dëm të viktimës/kallëzuesit E.K, për të cilën ka kërkuar dërgimin e çështjes në gjyq, për veprën penale “mashttrim me pasoja të rënda”, parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal, kërkesë e cila është pranuar nga gjykata me të njëjtin vendim, atë me nr. 334 akti, datë 15.2.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor

¹⁶³ Nr. *** prot., datë 9.9.2020, nr. *** prot., datë 12.2.2021 dhe nr. *** prot., datë 2.6.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

¹⁶⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 4.4.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, administruar në dosjen e Komisionit.

Tiranë. Lidhur me statusin e çështjes në vijimësi, subjekti ka sqaruar se kjo çështje është në gjykim përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe se tanimë ai është zëvendësuar në këtë proces me një tjetër prokuror, ndaj nuk ka dijeni për ecurinë e mëtejshme të shqyrtimit të kësaj çështjeje penale. Subjekti ka depozituar dokumentacionin në mbështetje të shpjegimeve të dhëna.

55.5 Nga trajtimi i denoncimit, trupi gjykues vëren se subjekti ka dhënë shpjegime të plota dhe ka detajuar statusin e çështjes, duke depozituar edhe dokumentacionin provues. Në këto kushte, trupi gjykues nuk vëren fakte apo rrethana, të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin e kriterit profesional të subjektit të rivlerësimit.

56. Denoncim¹⁶⁵ i shtetasit S.C

56.1 Denoncuesi ankohet ndaj subjektit të rivlerësimit se në çështjen që i përket procedimit penal nr. ***, të hetuar prej tij, nuk është hetuar në mënyrë të plotë dhe shteruese, si dhe për faktin se është mjaftuar vetëm në deklaratimet e palëve dhe aktin e ekspertimit grafik të punuar nga ekspert privat, akt që sipas tij paraqet të dhëna të rreme. Denoncuesi sqaron se fillimisht ai ka kallëzuar avokatin mbrojtës A.D dhe noteren M.D për veprat penale “mashttrim me pasoja të rënda”, “falsifikim i nënshkrimeve” dhe “fshehje e të ardhurave”, si pasojë e mashttrimit të bërë prej tyre lidhur me përfitimimin e dëmshpërblimit që denoncuesi dhe familjarë të tij kishin përfutur gjyqësisht pas aksidentit të ndodhur djalit të tij në krye të detyrës si punonjës në *** sh.a., me pasojë vdekjen, ndërsa sipas tij ata kanë falsifikuar dokumentet për të përvetësuar shumat. Mbi këtë çështje organi i akuzës ka dërguar denoncuesin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë nën akuzën e veprës penale “kallëzim të rremë”, parashikuar nga neni 305 i Kodit Penal. Nga ana tjetër edhe denoncuesi ka kallëzuar subjektin e rivlerësimit në SPAK, çështje e cila rezultoi e shqyrtuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila, me vendimin datë 11.2.2021, ka vendosur *Mosfillimin e procedimit penal* për kallëzimin penal regjistruar me nr. ***, të shtetasit C. ndaj subjektit të rivlerësimit për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

56.2 Lidhur me sa referohet më sipër, Komisioni i kërkoi subjektin të sqarojë dhe dokumentojë: (i) statusin e procedimit penal trajtuar prej tij, regjistruar me nr. ***, për veprat penale “falsifikim dokumentesh” dhe “mashttrim me pasoja të rënda”, parashikuar nga nenet 143/3 dhe 186 të Kodit Penal, për të cilin është vendosur përfundimi i hetimeve dhe marrja si të pandehur shtetasin S.C; (ii) statusin e çështjes që i përket kërkesës së organit të akuzës ndaj shtetasit C., akuzuar për veprën penale “kallëzimit të rremë”, parashikuar nga neni 305 i Kodit Penal; si dhe (iii) të deklarojë statusin e vendimit datë 11.2.2021 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila ka vendosur *Mosfillimin e procedimit penal* për kallëzimin penal regjistruar me nr. ***, të shtetasit C., ndaj subjektit të rivlerësimit, për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

56.3 Subjekti, në parashtrimet e tij, ka shpjeguar historikun e plotë të ngjarjes së ndodhur midis denoncuesit dhe të kallëzuarve lidhur me regjistrimin e procedimit penal nr. ***, viti 2020, për veprat penale “mashttrim me pasoja të rënda” dhe “falsifikim dokumentesh”, të parashikuara nga nenet 143/3 dhe 186 të Kodit Penal. Subjekti ka shpjeguar se në ndryshim nga pretendimet e denoncuesit ka rezultuar se ai ka qenë i përfshirë në tërheqjet e shumave dhe ka nënshkruar për to. Gjithashtu, ai ka sqaruar se denoncuesi është hetuar si i pandehur për shkak se ka konsumuar veprën penale “kallëzim i rremë”, parashikuar nga neni 305 i Kodit Penal dhe, për pasojë, bazuar në përcaktimet e nenit 287/2 të Kodit të Procedurës Penale, është vendosur ndryshimi i cilësimit juridik të veprave penale nga “mashttrim me pasoja të rënda” dhe “falsifikim dokumentesh”, të parashikuara nga nenet 143/3 dhe 186 të Kodit Penal, në veprën penale “kallëzim të rremë”, parashikuar nga neni 305 i Kodit Penal, në ngarkim të të pandehurit S.C. Subjekti ka konfirmuar se për këtë shtetas, në datën 14.12.2020, është kërkuar dërgimi

¹⁶⁵ Nr. *** prot., datë 19.2.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

në gjyq i çështjes penale nr. ***, me akuzën “kallëzim të rremë”, parashikuar nga neni 305 i Kodit Penal, në dëm të shtetasit A.D. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi ka pranuar kërkesën, duke e dërguar çështjen në gjyq, në përfundim të gjykimit në themel, me vendimin nr. ***, datë 20.9.2021, ka vendosur deklarinim fajtor të të pandehurit S.C dhe dënimin e tij me një muaj burgim, duke e pezulluar ekzekutimin dhe vendosur në provë të pandehurit. Në lidhje me statusin e vendimit nr. 11.2.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila ka vendosur *Mosfillimin e procedimit penal* për kallëzimin penal regjistruar me nr. ***, të shtetasit S.C ndaj tij, subjekti ka depozituar kopjen e vendimit të mosfillimit të procedimit penal, të marrë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

56.4 Trupi gjykues, në analizë të pretendimeve të parashtruara nga denoncuesi, provat e administruara dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, nuk vëren fakte apo rrethana që mund të ndikojnë në vlerësimin e kriterit profesional të subjektit të rivlerësimit.

57. Denoncim¹⁶⁶ i shtetasit V.B

57.1 Denoncuesi ankohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer asnjë veprim lidhur me kallëzimin e bërë prej tij në cilësinë e presidentit të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, ndaj shtetasit S.B, me detyrë *** i këtij Komiteti, sipas të cilit ky i fundit ka shpërdoruar haptazi fondet publike. Denoncuesi ankohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka siguruar dokumentet provuese për këtë kallëzim që administrohen nga ky Komitet, nuk ka shfaqur përgjegjësinë që të ndjekë hetimet dhe të kryejë detyrën. Denoncuesi nuk ka depozituar dokumentacion.

57.2 Për sa pretendohet më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime¹⁶⁷ dhe të argumentojë arsyet e zvarritjes së çështjes sipas pretendimeve të denoncuesit, si dhe të depozitojë çdo dokumentacion të vlerësuar.

57.3 Subjekti ka sqaruar se në këtë çështje nuk ka qenë prokurori, i cili ka ndjekur hetimet, por e ka marrë atë me zëvendësim nga një tjetër prokuror. Ai ka shpjeguar se prej tij, pasi është administruar akti i ekspertimit kontabël, është paraqitur kërkesa për pushimin e çështjes, vendim i cili është miratuar nga gjykata më pas. Subjekti parashtron se nuk rezulton të ketë asnjë zvarritje nga ana e tij në këtë çështje dhe procedim, në të kundërt nga sa pretendon kallëzuesi. Subjekti ka prezantuar një përmbledhje të historikut të çështjes prej regjistrimit të saj, bashkimit me katër procedimet e tjera të kallëzuara po nga denoncuesi mbi disa veprime të kryera nga prokurori i mëparshëm, etj. Subjekti ka sqaruar se akti i ekspertimit kishte qenë voluminoz dhe kishte marrë një kohë të gjatë për auditim nga ana e ekspertëve dhe se pas administrimit të aktit të ekspertimit dhe njohjes me konkluzionet, nga ana e tij ishte çmuar se kjo çështje duhet të pushohej. Subjekti ka shpjeguar se nga analiza e provave dhe e fakteve të hetuara gjatë procedimit penal, nuk rezultoi që nga personat e kallëzuar të jenë konsumuar elementet e veprës penale “vjedhje duke shpërdoruar detyrën”, parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal dhe për këtë shkak del qartë që fakti penal i pretenduar nuk ekziston. Në lidhje me pretendimet e kallëzuesit për veprën penale “vetëgjyqësi”, subjekti ka qartësuar se lidhur me parashikimet e nenit 277 të Kodit Penal del qartë që fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Subjekti, në lidhje me pretendimin për zvarritje të hetimit, ka deklaruar se në rastin konkret nuk ka pasur zvarritje të hetimit, duke marrë në konsideratë faktin se kjo nuk ishte një çështje e ndjekur që në fillimet e saj dhe në dinamikë nga ana e tij, por nga një tjetër prokuror. Për shkak të volumit tepër të madh të fashikujve (mbi 10 fashikuj), si dhe studimit të aktit të ekspertimit voluminoz dhe me shtrirje në një periudhë të gjatë kohore, hetimi është shtrirë në kohë për t’u arritur në konkluzione sa më të sakta, të cilat janë miratuar përfundimisht nga gjykata.

¹⁶⁶ Nr. *** prot., datë 1.11.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

¹⁶⁷ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Subjekti ka konfirmuar se në datën 29.10.2021 i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me kërkesë për pushimin e çështjes. Gjykata, me vendimin nr. *** regj. themeltar, datë 8.3.2022, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe pushimin e çështjes.

57.4 Për sa më sipër, në analizë të pretendimeve të parashtruara nga denoncuesi, provat e administruara dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues nuk vëren fakte apo rrethana që mund të ndikojnë në vlerësimin e kriterit profesional të subjektit të rivlerësimit.

58. Denoncim¹⁶⁸ i shtetasit A.I

Denoncuesi ankohet kryesisht për të tjerë subjekte rivlerësimi, për të cilët pretendon qenien e konfliktit të interesit mes tyre në veprimet administrative të ndërmarra në regjistrimin e procedimit penal nr. ***, datë 15.10.2021 dhe për shkak se ka drejtuar ankesa në institucionet përkatëse për këtë pretendim përmend edhe subjektin e rivlerësimit se ai nuk mund të vendoste mbi procedimin penal për shkak të konfliktit që eprorët e tij kishin pasur. Denoncuesi nuk ankohet për shkelje procedurale konkrete të lidhur me këtë denoncim dhe Komisioni nuk identifikoi *indicie* që ndikojnë në vlerësimin e kriterit profesional të subjektit të rivlerësimit.

59. Denoncim¹⁶⁹ i shtetasit M.L

Denoncuesi ankohet ndaj vendimit të mosfillimit të subjektit të rivlerësimit për një kallëzim penal të bërë në vitin 2021, për një çështje që i përket vitit 2005. Nga dokumentacioni i verifikuar rezultoi se vendimmarrja ka ardhur si rezultat i parashkrimit të afateve për ushtrimin e ndjekjes penale¹⁷⁰.

Lidhur me këtë denoncim, Komisioni nuk vërejtí problematika që mund të ndikojnë në vlerësimin e kriterit profesional të subjektit të rivlerësimit.

60. Denoncim¹⁷¹ i shtetasit E.Ç

Ky denoncues ankohet kryesisht drejt ish-drejtuësës së Prokurorisë së Rrethit Tiranë, me pretendimin se ka ushtruar presion ndaj disa prokurorëve, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit. Denoncuesi ngre dyshime serioze se ajo ka manipuluar shortin e hetuar në konflikt interesi. Denoncuesi nuk ka depozituar dokumentacion.

Nga shqyrtimi i këtij denoncimi Komisioni nuk vërejtí fakte apo rrethana që mund të përbëjnë ndonjë provë në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësisë profesionale për subjektin.

61. Denoncim¹⁷² i shtetasit A.Z

61.1 Denoncuesi në përmbajtje të denoncimit nuk ankohet për çështje konkrete të hetuara nga subjekti i rivlerësimit. Denoncuesi në ankim synon të informojë mbi funksionin e subjektit të rivlerësimit në raport me zotërimin e biznesit, duke e etiketuar këtë të fundit si të ushtruar në kundërshtim me ligjin. Denoncuesi prezanton të dhëna mbi pronësi të përfutuara dhe tjetërsuara nga subjekti, për të cilat nuk depozitoi ndonjë dokumentacion provues. Denoncimi duket se ka synuar të përcjellë nota intimidimi ndaj trupës gjyqësore në vendimarrje.

61.2 Subjekti në prapsime ka deklaruar se përsa shprehet në të nga denoncuesi anonim, është tërësisht e pavërtetë, bazohet në shpifje keqdashëse, me qëllim ndikimin tek trupa gjyqësore, në procesin e tij të

¹⁶⁸ Nr. *** prot., datë 23.11.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

¹⁶⁹ Nr. *** prot., datë 27.1.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

¹⁷⁰ Kjo çështje është trajtuar edhe në kriterin e pasurisë, në pasurinë e blerë nga shoqëria “****” sh.p.k. me administratore V.D.

¹⁷¹ Nr. *** prot., datë 26.3.2021, përcjellë nga ONM-ja.

¹⁷² Përcjellë nga adresa e e-mail ***@gmail.com, me nr. ***, datë 26.04.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

rivlerësimit. Subjekti ka sqaruar se ky “denoncues” nuk rezulton të ketë paraqitur më parë ndonjë denoncim pranë Komisionit dhe e bën për herë të parë këtë veprim, në kushte anonimati dhe pas një emri të rremë. Ai thekson se denoncimi dhe përmbajtja e tij, nuk referojnë tek ndonjë çështje konkrete të ndjekur apo hetuar nga ana e tij në ushtrimin e detyrës dhe për këtë shkak, duke marrë parasysh “faktet” e denoncuar me këtë e-mail, dyshon se është i njëjti trajtim si dhe në rastin e sulmit mediatik të ndërmarrë ndaj tij, pak muaj më parë, konkretisht gjatë muajit Dhjetor 2022, nga media “****”, në televizion dhe në faqen e saj të internetit. Subjekti ka sqaruar se sulmi ka ardhur si pasojë e marrjes së një Vendimi “Për mos fillimin e procedimit penal”, në lidhje me kallëzimin e bërë nga shtetasi Y.N në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për veprën penale të “Ekspertimit të rremë”, parashikuar nga neni 309 i Kodit Penal. Kallëzimi është regjistruar me numër ***, datë 26.04.2022 dhe nga ana e tij, në datën 09.05.2022 është marrë vendimi për të mos filluar këtë procedim. Subjekti ka prezantuar historikun e procedimit penal dhe konkludimin e saj, në kuadër të hetimit pasuror të shtetasit Y.N. Subjekti ka shpjeguar edhe mbi arsyet e denoncimit të cilat kanë ardhur, sipas tij, vetëm pas shfuqizimit të vendimit të mosfillimit të dhënë nga subjekti (pas ankesës së Media “****”, me qëllim që të mos ushtrohej prej këtij të fundit e drejta e ankimit. Subjekti ka theksuar se vetëm pasi prej tij është konfirmuar se do ushtrohej ankim, nga kjo media nëpërmjet pamjeve dhe rubrikave televizive dhe shkrimeve të shkruara në faqen e internetit të saj (www.***news.tv) kanë filluar të shfaqen sulme ndaj tij, që nga procesi i vetingut dhe deri tek aktivitetet e tij private, etj. Subjekti ka konfirmuar se ka ushtruar ankimin përkatës dhe se çështja ndodhet për gjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë. Subjekti ka sqaruar se denoncimi është bërë me qëllim denigrimit e tij dhe ushtrimin e presionit ndaj Komisionerëve, përpara seancës dëgjimore. Subjekti ka depozituar disa prej këtyre “lajmeve” dhe rubrikave, së bashku me link-et¹⁷³ përkatëse ku ato mund të gjenden on-line të publikuara, Vendimin e mosfillimit dhënë prej tij në datë 9.05.2022, si dhe ankimin e ushtruar në Gjykatën e Apelit Tiranë, në datë 9.12.2022, mbi shfuqizimin e vendimit të mosfillimit.

61.3 Trupi gjykues në analizë të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, dokumentacionit të administruar, në raport edhe me përmbajtjen e denoncimit, vëren se kryesisht denoncimi kërkon të përcjellë të dhëna dhe informacione lidhur me jetën profesionale të subjektit dhe aktivitetin e tij në shoqërinë tregtare për të cilën është hetuar dhe konkluduar më sipër në këtë vendimarrje, ndërsa nuk pretendohet për ndonjë çështje konkrete me palë denoncuesin, si dhe nuk jepen të dhëna mbi ndonjë vendimarrje të subjektit nga e cila pala është cënuar. Nisur nga shpjegimi i subjektit dhe konfirmimi i tij për vendimarrjen e Mosfillimit të procedimit penal, trupi gjykues e konsideron këtë moment vetëm në kuadrin e kompetencës që mund të ushtrojë, që në këtë rast në vlerësim të situatës faktike, çmon se, bazuar në nenin E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, kjo çështje nuk mund të jetë objekt rivlerësimi tërësor, pasi deri në fazën e analizuar në këtë vendimarrje ajo rezultoi ende nën shqyrtim nga gjykata.

62. Konkluzion për vlerësimin e kriterit profesional të subjektit të rivlerësimit

Bazuar në përcaktimet e nenit E të Aneksit të Kushtetutës, vlerësimi i kriterit të aftësive profesionale për subjektet që ushtrojnë funksionin e prokurorit, bazohet në aftësitë për të hetuar dhe për të ngritur akuzën publike, aftësinë organizative, etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale, si dhe cilësitë personale. Ndërsa, për burimet dhe procedurën mbi të cilat kryhet ky vlerësim, neni 42, pika 1 e ligjit nr. 84/2016,

¹⁷³ https://www.***news.tv/vendi/pse-vonon-vettingu-i-malajt-prokurori-i-tiranes-me-biznes-ne-import-e-tran-i1068452
https://www.***news.tv/vendi/si-u-rrit-kompania-e-prokurorit-sokol-malaj-e-rriti-kapitalin-ne-1-milione-i1069790
https://www.***news.tv/vendi/historia-e-zhdukjes-se-11-apartamenteve-ne-vlore-te-sokol-malaj-eksperienc-i1068053
https://www.***news.tv/vendi/dy-standarde-me-prokurorin-raportimet-nga-2016-per-pasurite-e-malajt-asnje-i1070736#.Y77g3HKpCnM.facebook

të drejton në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, për atë që ky ligj gjen zbatim, trupi gjykues, gjatë analizimit të çështjeve të trajtuara, si rrjedhojë e denoncimeve të publikut, konstatoi:

- i. çështje për të cilat subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kundërshtim me nenet 73 dhe 74 të ligjit nr. 96/2016, si dhe me akte të miratuara nga Prokurori i Përgjithshëm;
- ii. çështje që i përkasin rasteve të prishjes së vendimeve të mosfillimit dhe/apo pushimit të procedimeve penale nga gjykata (në mënyrë të përsëritur), duke u konstatuar prej saj/gjykatës mungesa e kryerjes së veprimeve hetimore dhe/apo duke u orientuar kryerja e veprimeve hetimore konkrete;
- iii. çështje në të cilat subjekti nuk ka zbatuar detyrat e lëna nga gjykata në hetimin e tyre, arsye për të cilën, pas kërkesës së bërë prej tij për pushimin e çështjes, gjykata ka vendosur kthimin e akteve dhe vazhdimin e hetimeve.

63. Në vlerësimin e trupit gjykues, procedimet e marra në shqyrtim, kryesisht nga denoncimet e shtetasve A.P, A.P dhe D.P përmbajnë të meta të dukshme, mungesë hetimesh dhe mosrespektim të vendimmarrjes së gjykatave, që kanë pasjellë mungesë të efektivitetit të trajtimit të këtyre çështjeve, mangësi këto që duhen vlerësuar në raport me përmbushjen e standardeve të përcaktuara nga nenet 73 dhe 74 të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar. Këto mangësi në vetvete nuk mjaftojnë për ta quajtur subjektin të papërshtatshëm sipas nenit 44, shkronja “c”, porse çmohen të tilla se ato përbëjnë bazë të mjaftueshme edhe për vlerësimin në tërësi të çështjes, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues, sipas parashikimit të germës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016, pasi vlerësoi çështjen në tërësi, bazuar në provat e administruara, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Sokol Malaj:

i. Lidhur me kriterin e pasurisë, rezultoi se subjekti ka paraqitur në mënyrë të pasaktë marrëdhënien e interesit pasuror me vëllain e tij, dhe nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës në lidhje me krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve me burime të ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 dhe 5 e Aneksit të Kushtetutës, duke rezultuar me mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën 10.218.055 lekë, për vitet 2011, 2012 dhe 2016, sipas nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr.84/2016.

ii. Lidhur me pjesëmarrjen e subjektit në veprimtarinë tregtare dhe mbajtjen e aksioneve aktive edhe pas ndalimeve ligjore sipas ligjit nr.96/2016, trupi gjykues çmon se veprimet e subjektit kanë prodhuar mospërputhje thelbësore me funksionin e prokurorit dhe detyrimet në lidhje me etikën. Sjelljet e subjektit kundrejt detyrimeve ligjore, konsiderohen nga trupi gjykues si fakte të çështjes që janë të mjaftueshme, për të arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk mund të gëzojë besimin e publikut për të qëndruar në detyrë, sipas nenit 61/5 të ligjit nr.84/2016.

iii. Lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

iv. Lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, çmon se subjekti arrin nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016. Mangësitë e evidentuara në rastet e denoncimeve të trajtuara në këtë vendim, nuk janë të mjaftueshme për ta konsideruar subjektin të papërshtatshëm sipas nenit 44 germa c, por në raport dhe me gjetjet e

tjera, duhen vlerësuar dhe trajtuar si situata, të cilat ndikojnë në cenimin e besimit të publikut, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

v. Lidhur me vlerësimin tërësor të çështjes, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, në zbatim të neneve 61, pika 5 dhe 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “c” të pikës 1, të nenit 58, dhe pikës 3 dhe 5 të nenit 61 dhe 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Sokol Malaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsytuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 12.5.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Pamela QIRKO
Kryesuese

Brunilda BEKTESHI
Relatore

Roland ILIA
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Albana Plaka